



# STUDIMI PËR ZONËN FUNKSIONALE DIBËR

**Ekonomia  
Shërbimet Publike  
Qeverisja Vendore**

Ky dokument është përgatitur nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp), me mbështetjen financiare të Agjensisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Ky publikim reflekton mendimet e autorëve dhe jo detyrimisht të SDC

Zhvilluar nga: ALCDF

Publikuar nga:  
Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)

**HELVETAS Swiss Intercooperation** | Albania  
Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova",  
Pallati i PLUS, kati i 2-të / Nr. 3. Tiranë | Shqipëri  
[www.dldp.al](http://www.dldp.al) | [www.km.dldp.al](http://www.km.dldp.al)

# Përmbajtja Analiza e Zonës Funktionale Dibrë

<b>1. Hyrje</b> .....	4
<b>2. Përshkrimi i përgjithshëm i Zonës Funktionale</b> .....	7
2.1 Territori I Zonës Funktionale të Dibrës .....	7
2.2 Historia, kultura, tradita, atraksionet kryesore.....	8
2.3 Demografia.....	9
2.4 Tiparet e zonës Funktionale .....	11
<b>3. Ekonomia ne zonën Funktionale</b> .....	13
3.1 Karakteristikat Ekonomike të Zonës Funktionale .....	13
3.2 Të dhëna të përgjithshme për ekonominë në zonën Funktionale .....	15
3.3 Tregu i Punës, struktura e Punësimit / PaPunesisë.....	19
3.4 Edukimi dhe formimi profesional për banorët e zonës Funktionale .....	21
3.5 Ndërveprimi ekonomik në zonën Funktionale .....	22
<b>4. Analiza e thelluar e ekonomisë në zonën Funktionale</b> .....	24
4.1 Karakteristikat ekonomike.....	24
4.2 Analiza e sektorëve kryesorë ekonomikë .....	25
4.3 Analiza e Bujqësisë sektori prioritar ekonomik i Zonës Funktionale ( sektori 1) .....	25
4.4 Analiza e Turizmit (sektori i dyte prioritarë për zonën Funktionale).....	36
<b>5. Harta e Shërbimeve në Zonën Funktionale të Dibrës</b> .....	41
5.1 Uji i Pijshëm dhe Kanalizimet.....	41
5.3 Menaxhimi i Mbetjeve .....	53
<b>6. Organizimi i shërbimeve të qeverisjes lokale në zonë</b> .....	64
6.1 Shërbimet kryesore që ofrohen nga NJQV-të dhe shpërndarja e tyre .....	64
6.2 Organizimi vendor dhe struktura e personelit .....	68
6.3 Buxhetet e Njësive Vendore.....	70
6.4 Strategjitë lokale të zhvillimit .....	71
<b>7. Vizioni i Zonës Funktionale Dibrë</b> .....	72
<b>8. Projektet kryesore për zhvillimin e Zonës Funktionale</b> .....	73
8.1 Projektet me fokus zhvillimin ekonomik të zones funksionale .....	73
8.2 Projektet që promovojnë shërbimet e sektorit publik .....	86
8.3 Projektet e shpejta - Quick start.....	98
<b>9. Analiza dhe rekomandimet për organizimin e Njësive të reja Vendore</b> .....	104
9.1 Organizimi vendor dhe struktura e personelit .....	104
9.2 Menaxhimi i shërbimeve publike në Njësitë Aktuale Vendore.....	106
9.3 Proces konsultimi/diskutimi me administratën e Njësive Vendore kryesore .....	109
9.4 Identifikimi i rekomandimeve për strukturën organizativetë njësisë së re administrative .....	109
9.5 Integrimi i shërbimeve publike kryesore në Njësinë e Re si një nga fushat kryesore të zbatimit të FAP dhe ndikimin që këto kanë në organizimin e Njësisë së re Vendore .....	110
9.6 Rekomandime rreth burimeve njerëzore/specialiteteve të punonjësve që nevojiten për përmbushjen e këtyre funksioneve .....	112

## **Programi I Zonës Funktionale të Dibrës**

### **1. Hyrje**

Studimi për zonën Funktionale të Dibrës, i hartuar nga ALCDF (Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale) është bërë në kuadër të programit DLDP (3). Ky produkt është në vazhden e studimeve dhe aktiviteteve që DLDP ka ndërmarrë për programin e Zhvillimit të Zonave Funktionale dhe që kanë filluar që në vitin 2013.

Programi për Decentralizimin dhe Zhvillim Lokal (DLDP), është një program i financuar nga Qeveria Zvicerane dhe ka punuar nga 2006 në Shqipërinë e Veriut, fillimisht në rajonin e Shkodrës (dhe nga 2009 në rajonet Shkodër dhe Lezhë). Qëllimi kryesor i këtij programi është për të forcuar dhe zhvilluar kapacitetet e njësive të qeverisjes vendore (NJQV-të) për të ofruar shërbime me efikasitet dhe cilësi për qytetarët. Programi ka mbyllur fazën e dytë të aktiviteteve dhe ka filluar (në fillim 2014) fazën e tretë, e cila është një proces konsolidimi i rezultateve të programit dhe një vazhdimësi e punës së tij me njësitë e qeverisjes vendore (NJQV) në rajonet e përmendura më lart, por ka vazhduar të punojë edhe në tre rajone të reja Kukës, Dibër dhe Durrës duke mbuluar kështu të gjithë territorin e Shqipërisë Veriore .

Qeveria e Shqipërisë e ka shprehur qartë vullnetin e saj për një reformë territoriale dhe administrative. Parlamenti shqiptar ka miratuar hartën e ndarjes territoriale dhe po vazhdon puna me diskutime dhe komente nga të gjitha palët e interesuara në procesin dhe rezultatin e kësaj reforme. Procesi i reformës parashikon dhe një rishikim të strategjisë së decentralizimit (dmth decentralizimi fiskal, funksione të përbashkëta, etj), e cila është parashikuar të ndodhë paralel me këtë reformë.

Qëllimi i këtij studimi, është që për zonën funksionale të Dibrës të japë një analizë të hollësishme të situatës aktuale në sektorët ekonomik, të shërbimeve publike, organizimit të qeverisjes vendore, dhe të pragadisë një paketë më projektet prioritare në këto 3 sektorë. Gjithashtu procesi i studimit kërkon të përfshijë një spektër të gjerë të aktorëve kyç lokalë në procesin e analizimit dhe zhvillimit të studimit me qëllim që këto aktorë me strukturat e krijuara gjatë kësaj faze të promovojnë zonën funksionale të Dibrës tek publiku i gjerë dhe të jenë promotorët e zbatimit të këtyre prioriteve dhe projekteve të hartuara në kuadër të këtij programi.

**Koncepti i Zonës Funktionale:** “Zona funksionale” si terminologji i referohet nocionit të kuptimit të një hapësire territoriale, që nga forma e organizimit administrativ mund të jetë një ose më shumë bashki/komuna, rajon a kështu me radhë dhe bazohet në ndërveprimet e ndryshme që ndodhin brenda kësaj hapësire, dhe nuk janë domosdoshmërisht të përcaktuara sipas kufijve administrativë apo historikë. Kjo do të thotë për shembull se si, ku, çfarë mundësish dhe lehtësira ekonomike, shërbime apo gamë shërbimesh përdorin më shumë banorët e kësaj/këtyre zonave, ose në bazë të shpeshtësisë dhe llojeve të bashkëpunimit që ndodhin midis subjekteve të ndryshme qeveritare apo ekonomike. Pra Koncepti i zonës funksionale, në kontekstin e këtij programi, është përdorur për të përcaktuar një hapësirë ku ndodhin ndërveprime më të dendura si në mes banorëve ashtu edhe mes bashkëpunimit midis entiteteve qeveritare dhe ekonomike.

Bazuar në një analizë të detajuar, duke analizuar dhe vlerësuar ndërveprimet mes banorëve të orientuara nga marrëdhëniet ekonomike (punësimi, tregjet, konsumi), shërbimet bazë (shëndetësi, arsim, infrastrukturë rrugore), dhe bashkëpunimet institucionale mes entiteteve të qeverisjes lokale dhe ekonomike (bashkëpunimi ndër-vendor, bashkëpunimi ndër-kufitar) i realizuar gjatë periudhës Shtator-Dhjetor 2013, u përcaktua zona e Dibrës si zonë funksionale që korrespondonte me territorin e rrethit të Dibrës, dhe që përbëhet nga 15 NJQV (një bashki dhe 14 Komuna).

**Studimi i Zonës Funktionale.** Për hartimin e procesit të zhvillimit të programit për zonën funksionale të Dibrës janë ndjekur këto hapa kryesorë.

- Diskutimi i konceptit idesë dhe programit me kryetarët e NJQV dhe aktorët kyç, ku u arrit qartësimi i tyre rreth procesit dhe dakortësia për të qenë pjesë e programit.
- Hartimi i analizës së zonës funksionale;
- Identifikimi dhe përgatitja e paketës me projektet prioritare;
- Përgatitja e rekomandimeve për strukturën dhe zbatimin e Programit të zonës funksionale.
- Përgatitja e projekteve të zonës funksionale të Dibrës për tu prezantuar në panairin kombëtar të zonave funksionale.
- Përgatitja e informimit dhe promovimit të programit të zonës Funksionale tek aktorët dhe publiku i gjerë lokalë.

Për zbatimin e këtyre hapave të procesit të programit të zonave funksionale janë përdorur disa instrumenta kryesorë metodologjik si: takime konsultative me aktorët kyç lokalë, krijim strukturash (forumi i zonës funksionale Dibrë), grumbullim të dhënash dhe konsultim me dokumentet strategjike kryesore lokale-rajonale-kombëtare, intervistim dhe workshope në terren, takime dhe diskutime me grupe të fokusuara tematike, etj.

Element kyç në metodologjinë e hartimit të Programit të Zhvillimit të Zonës Funksionale është krijimi i Forumit të Zonës Funksionale si një strukturë me përbërje nga të gjitha aktorët kyç lokalë si NJQV-të, institucionet e dekoncentruara në rajon, përfaqësues të biznesit, dhe


përfaqësues nga Shoqëria civile. Kjo strukturë ka luajtur një rol të rëndësishëm si në, pjesëmarrjen e tyre në çdo aktivitet dhe proces, me lehtësimin e grumbullimit të informacionit, me dhënien e rekomandimeve dhe opinioneve, me furnizimin me ekspertizë lokale të studimit, me përpunimin e të dhënave, dhe mendojmë që të jetë ura lidhëse për të komunikuar me publikun e gjerë për të promovuar programin dhe si struktura tranzitore e kalimit të programit të NJQV e ardhshme.

Për të përmbushur këtë studim, ALCDF si ofruese e shërbimeve ka ndjekur metodologjinë e hartuar nga ekspertët e DLDP dhe ka angazhuar një grup ekspertësh në fushat e kërkuara në program si; eksperti i zhvillimit ekonomik, eksperti për shërbimet dhe administratën publike, eksperti i GIS, dhe kordinatorin lokal. Përveç konsultimeve me anëtarët e forumit, për sektorin prioritar që është përcaktuar për zonën e Dibrës që është Bujqësia është angazhuar dhe një ekspert në fushën e bujqësisë, për të dhënë një analizë sa më profesionale dhe projektet prioritare të jenë sa më të zbatueshme.

## 2. Përshkrimi i përgjithshëm i Zonës Funktionale

### 2.1 Territori I Zonës Funktionale të Dibrës

Zona Funktionale e Dibrës shtrihet në pjesën veri-lindore të Shqipërisë me një sipërfaqe rreth 1214km<sup>2</sup>, me terren kryesisht malor. Territori i Dibrës përshkohet përgjatë gjithë gjatësisë së tij nga Lumi Drin i Zi (më i gjati në Shqipëri) dhe rrethohet nga të dy anët nga vargmali i Korab-Deshat (më i larti në Shqipëri) që është pjesë e parkut natyror Korab-Korritnik dhe vargmalet e Lurë-Selishtë që janë një pjesë e parkut kombëtar të Lurës dhe karakterizohet nga 23 liqene akullnajore. Zona funksionale e Dibrës kufizohet në veri me fshatrat e rrethit të Kukësit, në jug me fshatrat e rrethit të Matit dhe Mirditës, në jug-lindje me fshatrat e rrethit të Bulqizës dhe në veri-lindje me kufirin shtetëror të Maqedonisë.



Territori i zonës funksionale të Dibrës në masën 90% është zonë rurale dhe vetëm 10% e këtij territori është zonë urbane që shtrihet në qytetin e Peshkopisë. Zona rurale përfaqësohet nga 141 fshatra me një diversitet relievi nga fshatra malorë, kodrinorë dhe fushorë kryesisht në luginën e Drinit të Zi. Këto fshatra kanë qenë pjesë e 14 komunave që ishin njësi të qeverisjes vendore në ndarjet administrative të deritanishme. Territori i

zonës është kryesisht malor me 55% të territorit, kodrinor rreth 30% e territorit dhe 15% i territorit është fushor.

Dibra ka një mjedis të larmishëm në aspektin e biodiversitetit, diversitetit geografik dhe një peisazh piktoresk shumë të bukur. Parku kombëtar i Lurës dhe parku natyror i Korab-Korritnik janë dy zonat kryesore të mbrojtura që shtrihen në dy brigjet e Lumit Drin i Zi që është lumi më i gjatë në Shqipëri. Në Dibër janë rreth 48 monumente të natyrës dhe dy zona të mbrojtura që shquhen për karakteristikat e veçanta të tyre, peisazh natyror të mrekullshëm dhe një florë dhe faunë të pasur. Në Dibër janë dhe shumë monumente hidrike si Ujëvara e Pöcestit, burimi i Bellovës, uji ftohtë i Vleshës, burimet e Setës, Murra dhe më i famshmi ujërat termale të Llixhave të Peshkopisë që janë të njohura për vetitë e tyre kurative.

Dibra si zonë ka akses rrugor kombëtar dhe metropolitan me rrugën Tiranë – Peshkopi me gjatësi 186 km dhe në gjendje jo të mirë, me aksin kryesor të rrugës së kombit Tiranë-Prishtinë rrugë e asfaltuar me gjatësi 72km të rrugës nacionale Peshkopi-Kukës, dhe akses me rrugët e Maqedonisë nëpërmjet pikës kufitare të Bllatës rreth 16km nga qendra urbane e Peshkopisë.

## 2.2 Historia, kultura, tradita, atraksionet kryesore

Zona funksionale e Dibrës shtrihet në territorin e rrethit të Dibrës që është një nga tre zonat e rajonit ekzistues bashkë me Bulqizën dhe Matin. Kjo zonë është tradicionalisht në territorin e Dibrës së poshtme që bashkë me Dibrën e epërme përbënin krahinën e Dibrës që shtrihej nga Lura dhe Kalaja e Dodës, vazhdonte në Mavrovë me krahinën e Rekës, në qytetin e Dibrës së madhe, në krahinën e Gollobordës dhe deri në rrethinat e Ohrit dhe qytetin e Strugës. Kjo zonë në periudhën e mesjetës ishte sanxhak më vete si pjesë e vilajetit të Manastirit.

Emri i Dibrës mendohet që vjen nga fisi Ilir “Deborëve” që jetonte në këtë territor dhe me evolucionin e tij deri në ditët e sotme ka ndryshuar nga “Deborë” në “Dibër”, varianti shkencor. Ekziston dhe një version tjetër më folklorik që lidhet me ndarjen gjeografike të territorit nga lumi Drin në dy brigjet e tij, që në dialekt dibran është Di(y)-Bri dhe ky dualizëm është shumë i përdorur në toponominë dibrane si Dibra Epërme dhe e Poshtme, Sina epërme dhe poshtme, Brest i epërm dhe i poshtëm, Lishan i epërm dhe i poshtëm. Gjithashtu kjo ide lidhet dhe me simbolin e Kastriotëve (përkrenarja me dy brirë) që ishin zotëruesit e krahinës së Dibrës. Lumi Drin është kufiri gjeografik i ndarjes së Dibrës në pjesën e Malësisë (që përfaqësohet me 9 malet) dhe Topalltia, si dhe është kufiri ndarës i katolicizmit (l-latink) në pjesën e malësisë dhe ortodoksisë në pjesën e Topalltisë.

Historia e Dibrës është shumë monumentale me ngjarje, vepra, dhe figura historike. Simboli më i lartë historik i Dibrës lidhet me vendlidjen e heroit kombëtar Gjergj Kastriotit (Skënderbeut) që është fshati Sinë, me 300 kalorësit që e shoqëruan atë dhe që ishin dibranë, dhe 24 betejat e tij u zhvilluan në territorin e Dibrës. Në territorin e Dibrës ndodhen shumë rrënoja arkeologjike që shumë pak janë të zbuluara dhe të eksploruara, të cilat lidhen me qytetërimin Ilir, Bizantin, Kristian dhe Mesjetar. Më e famshmja nga këto janë kalaja e Grezhdanit, Kalaja e Skënderbeut, kishat e Peshkopisë në kodër Shtjefën, qyteza e Bellovës, etj. Feja ka luajtur një rol të rëndësishëm në historinë e Dibrës, ku kleri dhe shërbyesit e feve katolike, ortodokse, myslimanë (e cila përbën 97% të popullsisë) ka luajtur një rol të rëndësishëm në edukimin, kulturën dhe patriotizmin ku më të spikaturit janë 7-të teqet e Dibrës ku më e famshmja është teqeja e “Bilbilit” në Vleshë dhe klerikët e nderuar, Dom Nikollë Kacori (nënkryetari i qeverisë së Ismail Qemalit), Haxhi Vebi Dibra (kryetari i kuvendit të parë të qeverisë 1912), si dhe Rilindasit Josif Bageri, Seit Najdeni dhe Hoxhë Voka.

Dibra trashëgon një kulturë dhe traditë të pasur që nga koha e paganëve dhe deri në ditët tona. Festat, doket dhe zakonet janë ruajtur dhe pasuruar brez pas brezi pa e cënuar këto vlera autentike si festat, ritet, kostumet, vallet, këngët, arkitektura etj. Kështu akoma ruhen dhe vazhdojnë të festohen, dita e Verës, dita e Shën Gjergjit, dita e Shën Nkollit; ritet e dasmës me vallet e grave dhe burrave, kostumet popullore, lojrat popullore ku më e spikatura është “kala dibrançe”, veglat muzikore ku më të lashtat janë fyelli dhe çiftelia, etj. Një pasuri më vete shumë të spikatura janë kullat e Dibrës me gure të gdhendur dhe të punuara më mjeshtëri nga mjeshttrat Dibranë, oda e dibrës me “kryet e vendit” të cilat janë në formë kuvendesh ku spikat mencuria,




dija, rregulli protokollar, dhe alegoria dhe ku cdo gjë është e rregulluar sipas kanunit të Dibrës i bazuar në kanunin e Skënderbeut. Për t'i ruajtur dhe promovuar këto vlera të kulturës dhe traditës dibrane punojnë disa institucione shtetërore në Peshkopi si qendra e Kulturës “Haki Stërmilli”, Instituti i Monumenteve, muzeu i krahinës si dhe një kontribut të madh japin dhe shoqatat jo-qeveritare me fokus kulturën dhe traditën si Shoqata e Historianeve Dibrane, shoqata “Nisma Dibrane”, shoqata “Cidhna”, shoqata “Rinia Dibrane”, Forumi i “Gruas dibrane”, Shoqata “Agritravision” dhe gazeta “Rruga e Arbërit”. Eventi më i rëndësishëm kulturor është festivali folflorik mbarë-kombëtar “Oda Dibrane” që mbahet çdo vit dhe ku marrin pjesë më shumë se 20 grupe artistike nga të gjitha trevat shqipfolëse në Ballkan si dhe “Festa e të Vjelave” që është panairi i produkteve tipike dibrane.

### 2.3 Demografia

Popullsia e Zonës funksionale të Dibrës përbëhet nga 82,668 banorë dhe përbën rreth 45% të popullsisë së përgjithshme të qarkut me 190,000 banorë. Popullsia është e shpërndarë në 15 NJQV-ve - 1 bashki dhe 14 komuna me 141 fshatra. Bashkia e Peshkopisë është qendra urbane e zonës funksionale dhe ka një popullsi prej 20,000 banorësh ndërsa popullsia tjetër banon në zonën rurale të Komunave; Maqellarë, Melan, Tomin, Kastriot, Fushë-Cidhën, Sillovë, Kala e Dodës, Rec, Zall-Dardhë, Arras, Muhurr, Luzni, Selishtë dhe Lurë.

Gjatë dekadës së fundit situata demografike në zonën funksionale të Dibrës ka ndjekur të njëjtën tendencë me zonat e tjera në veri dhe veri-lindje që është e karakterizuar nga një lëvizje e përgjithshme e popullsië drej qendrave metropolitane dhe urbane të rajoneve të tjera dhe migracionit brenda zonës funksionale kryesisht në qytetin e Peshkopisë. Midis 2002 dhe 2013, popullsia është ulur me rreth 16% deri 25% (në varësi të metodës së matjes). Migrimi më i lartë në 11% ka ndodhur gjatë 2004-2006. Që nga viti 2006, ndryshimi është më i vogël, përkatësisht 2,1% dhe 1,6% për periudhat 2006-2008 dhe 2008-2013. Tendenca e lëvizjes ka qenë e pranishme pothuajse në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, më e dukshme në komunat malore në Zall Dardhës 59%, dhe Reç 58%.



Dendësia mesatare e popullsisë në zonën funksionale është 78.2 banorë / km<sup>2</sup>, një shifër shumë më e ulët se niveli kombëtar të 148 banorë / km<sup>2</sup>. Kjo shifër varion midis NJQV-ve, për komuna fushore është 270 banorë / km dhe për komunat malorë 50 banorë / km<sup>2</sup>. Dendësinë më të madhe e ka Bashkia e Peshkopisë 1,008 banorë/km dhe që përbën 25% të popullsisë së zonës, ndërsa dendësinë më të ulët e ka komuna e

Zall-Dardhës, Rec dhe Lurë që variojnë tek 11-24 banorë/km<sup>2</sup>.

Shifra e popullsisë urbane ka qenë pak a shumë e qëndrueshme gjatë 2002-2013. Aktualisht popullsia urbane përbën 25% të totalit të popullsisë.

Nr	NJQV	2001	2012	2013	2014	Sipër. km <sup>2</sup>	Dendësia banorë/ 2013 km <sup>2</sup>
1	Peshkopi		19377	18856	18950	18.6	1018
2	Maqellarë		14018	13535	13632	100.69	135
3	Melan	6250	4516	4451	4415	71.65	62
4	Tomin		9200	8503	8489	66.58	128
5	Muhurr	4677	3535	3505	3516	61.52	57
6	Kastriot	9817	7939	7394	7323	62.52	117
7	F.Çidhën	4631	3964	3637	3611	21.83	165
8	Sillovë	5349	3346	3211	3184	86.99	37
9	Kala e Dodës	4611	3375	3028	3014	82.97	36
10	Zall Dardhë	3778	1343	2353	2346	43.68	24.6
11	ZallReç	3050	1075			50.49	
12	Lurë	2185	1545	1464	1482	140.19	11
13	Arras	5828	4304	3875	3841	53.93	71
14	Selishtë	4344	2089	1959	1961	96.3	20
15	Luzni	4905	3176	3173	3176	43.57	73
<b>RRETHI DIBËR</b>		<b>59425</b>	<b>82802</b>	<b>78944</b>	<b>78940</b>	<b>1001.51</b>	<b>78.82</b>

Bazuar në analizën e zhvillimeve demografike dhe hapësinore Dibra si zonë funksionale karakterizohet me karakteristikat e mëposhtme mbizotëruese:

Zona funksionale e Dibrës ka një popullsi relativisht të re. Megjithatë, kjo zonë vazhdon të përjetojë lëvizjen e popullsisë nga pjesët me më pak mundësi që janë pjesët malore të zonës drejt bregut perëndimor, veçanërisht në pjesën qendrore në Tiranë dhe Durrës. Kjo do të ketë pasoja të rëndësishme për zhvillimin e zonës pasi bashkë me lëvizjen demografike lëvizin dhe kapitalet financiare dhe njerëzore, duke krijuar zona të boshatisura;

Karakteristikat gjeografike (relievi i thyer dhe largësia mes qendrave të banuara) ndikojnë në aksesin e zonave periferike që janë kryesisht malore me qendrën administrative dhe shërbimet bazë, duke paraqitur sfida të rëndësishme socio-ekonomike dhe administrative. Kjo është një karakteristikë që duhet të merret parasysh në menaxhimin e ardhshëm të NJQV-së;


## 2.4 Tiparet e zonës Funksionale

“Zona funksionale” si terminologji i referohet nocionit të kuptimit të një hapësire territoriale, që nga forma e organizimit administrativ mund të jetë një ose më shumë bashki/komuna, rajon e kështu me radhë, dhe bazohet në ndërveprimet e ndryshme që ndodhin brenda kësaj hapësire, dhe nuk janë domosdoshmërisht të përcaktuara sipas kufijve administrativë apo historikë. Kjo do të thotë për shembull se si, ku, çfarë mundësish dhe lehtësira ekonomike, shërbime apo gamë shërbimesh përdorin më shumë banorët e kësaj/këtyre zonave, ose në bazë të shpeshtësisë dhe llojeve të bashkëpunimit që ndodhin midis subjekteve të ndryshme qeveritare apo ekonomike.

Bazuar në këtë koncept Dibra është zgjedhur si zonë funksionale bazuar në një analizë të bërë gjatë muajve Shator-Dhjetor 2013 nga DLDP për qarkun e Dibrës dhe ku për kritere referente u morën ndërveprimi në sektorin ekonomik, sektorin e shërbimeve dhe bashkëpunimit ndër-vendor dhe ndër-kufitar.

Bazuar në të dhënat dhe intervistat me shumë aktorë lokalë dhe në të dhënat e marra nga dokumentet e ndryshme, u konkludua që njerëzit në zonën e Dibrës kanë dëndësi më të madhe të ndërveprimit më shumë në Peshkopi për këto çështje kryesore;

Ndërveprimi në treg (ku njerëzit blejnë), pothuajse të gjithë banorët e NJQV-së në Dibër janë të përqëndruar në tregun e Peshkopsië, ku janë të vendosura dhë numri më i madh i pikave të shumicës dhe pakicës, si dhe tregjet javore.



Ndërveprimi në lidhje me punësimin,




në

pjesa më e madhe e të punësuarve sektorin e shërbimeve, ndërtimtari dhe në adminsitradën publike janë të përqëndruara në qytetin e Peshkopsië dhe tendenca e lëvizjes është nga qendrat e NJQV drejt Peshkopsië.

Ndërveprimi në lidhje me shërbimet bazë të arsimit, edhe në këtë rats kemi tendencën drejt Peshkopisë ku janë shkollat më të mira të mesme (gjimnazi dhe profesionale), si dhe dega e Universitetit “Aleksandër Mojsiu”.

Ndërveprimi në shërbimin e kujdesit shëndetësor, është përqëndruar në Peshkopi ku është qendra spitalore rajonale dhe ku janë qendrat më të mëdha të klinikave dentare, farmacive dhe shërbimeve të tjera shëndetësore. E njëjta situatë është edhe për zonë e Bulqizës dhe të Burrelit, që janë dhe qendrat më të mëdha urbane në zonë.



Ndërveprimi të bashkëpunimit ndër-vendor dhe ndërkufitarë, megjithëse nuk është shumë i dukshëm por për çështjet që lidhen me Ujin e Pijshëm dhe menaxhimin e mbetjeve mes disa njësisve vendore më Bashkinë e Peshkopisë, si dhe një sërë projektsh të përbashkëta ndërkufitare me Dibrën e madhe.

Bazuar në të gjithë këtë analizë, u përcaktua që Qarku i Dibrës ka tre zona Funktionale që përputhen me kufijtë e vjetër të rretheve të Dibrës, Matit dhe Bulqizës.



Harta e ndarjes së qarkut Dibër në 3 zona Funktionale

### 3. Ekonomia ne zonën Funktionale

#### 3.1 Karakteristikat Ekonomike të Zonës Funktionale

Zona funksionale e Dibrës ka profil bazë ekonomik si një zonë bujqësore që siguron pjesën më të lartë të punësimit në zonë dhe prodhimin kryesor për treg, si dhe sektori i shërbimeve ku ofrojnë shërbimet për popullsinë lokale, por ka një tendencë që ky sektor të orientohet dhe drejt turizmit kryesisht atij kurativ në ujërat termale të Llixhave të Peshkopisë.

Në kushtet e zhvillimit ekonomik, zona e Dibrës është e pozicionuar nga zonat e fundit (58%) në krahasim me GDP mesatare kombëtare (indeksuar në 100). GDP për zonën e Dibrës është 177.111 Lek për frymë kurse në nivel nacional është 305.229ALL. Sektorët që kontribuojnë më shumë janë Bujqësia, Pylltaria, Turizmi dhe Hidro-Energjia.


Nga të dhënat e Drejtorisë së tatimeve numri i ndërmarjeve të rregjistruara në vitet e fundit (2014) nuk janë ndërmarrje të sapo krijuara por të rregjistruara si pasojë e politikave kundër informalitetit dhe formalizimit të ekonomisë.

Si një tregues negativ për zhvillimin ekonomik në zonën e Dibrës mund të jetë mungesa e investimeve të huaja, të cilat kanë pasur interes vetëm për pasuritë natyrore të gipseve, kromit dhe hidro-energjisë, por akoma nuk kemi ndonjë investim të huaj në zonë. Rritja e numrit të bankave dhe agjencive të kreditimit është rritur që nga viti 2002. Në vitin 2013 numërohen deri në 10 agjenci të tilla në krahasim me vetëm 2 në vitin 2002. Realiteti është se këto banka dhe agjenci janë të gjitha të vendosura në zonat urbane Peshkopi (10) dhe jo në zonat rurale (vetëm në Maqellarë kemi 1).

Në zonën e Dibrës karakteristika e të qenit qendër administrative dhe jo me shumë pasuri minerare (vetëm në territorin e komunës Selishtë ku ka krom) ka aktualisht 61 biznese të mëdha që kanë të punësuar rreth 423 punonjës, dhe ku sektori më i rëndësishëm është ai i shërbimeve, tregtisë, transportit dhe ndërtimit, dhe kjo krahasuar me zonat fqinje që kanë tregues më të lartë pasi kanë më shumë profil minerar sidomos Bulqiza. Numri i ndërmarrjeve aktive jo-bujqësore që veprojnë në zonë është 1381 biznese. Në aspektin e llojit të aktivitetit shumica e ndërmarrjeve jo-aktive veprojnë në sektorin e shërbimeve (74%) dhe janë të vendosura kryesisht në bashkinë e Peshkopisë, dhe ku shumica e këtyre ndërmarrjeve kanë të punësuar vetëm një person.

Në tabelën e mëposhtme jepen bizneset të rregjistruara sipas njësive vendore. (burimi QKR)

	Peshkopi	Tomina	Maqellarë	Melan	Kastriot	F.Cidhen	Silove	Kala e Dodes	rec	Dardhe	Lure	Arras	Muhurr	Selishte	Luzni
Biznese aktive	1018	45	180	27	36	7	7	5	5	0	7	16	17	8	3



Siç shihet dhe nga tabela numri më i madh i bizneseve është i përqëndruar në njësitë vendore më të mëdha, si në Peshkopi (74%) dhe Maqellarë (13%) e bizneseve. Kjo ka bërë që në të dy këto zona qendra urbane të jenë nën presionin e ndërtimeve, duke zënë hapësirat publike dhe krijuar problem me pamjen dhe urbanistikën. Ndërsa në njësitë e tjera vendore bizneset janë shumë të vogla sa që në komunat e Zall-Dardhës nuk kemi asnjë biznes të rregjistruar, dhe në 7 komuna nuk e kalojnë numrin e (7) bizneseve të rregjistruara, dhe këto janë kryesisht Njësitë vendore më të largëta me Peshkopinë dhe më maloret.

### 3.2 Të dhëna të përgjithshme për ekonominë në zonën Funksionale


Dibra është një zonë ku dallohen qartasi ekonomia në zonën rurale dhe ekonomia në zonën urbane. Ekonomia e zonës urbane bazohet kryesisht në sektorin e shërbimeve, të tregtisë, hoteleri turizëm, përpunim, dhe ndërtimtari. Ndërsa zona rurale ka karakteristikë të qartë bujqësore e bazuar në ekonominë familjare të fermave të vogla bujqësore dhe blektorale me një tendencë në rritje, dhe të disa shërbimeve bazë dhe biznese tregtare (më e përqëndruar dhe dalluese në zonën e Maqellarës). Këto vitet e fundit ka një fillim të investimeve në përpunimin e produkteve bujqësore kryesisht të qumështit (rreth 18 baxho), të frutave (punishte për lëng futash, pije alkalike, komposto/reçelna, jufka etj). Shumica e këtyre bizneseve në sektorin bujqësor janë të pa-rregjistruara në zyrën e tatim taksave por të identifikuar dhe njohura nga zyrat e njësive të qeverisjes vendore.

Numri i ndërmarrjeve aktive në zonën funksionale të Dibrës në 2014 është 1381 biznese të cilat janë të përqëndruara kryesisht në qytetin e Peshkopisë (1018). Në zonat rurale, numri më i lartë është në komunën e Maqellarës (180) biznese dhe më pak në komunën e Zall-Dardhës që nuk ka fare dhe në Luzni (3) biznese.

Në tabelën e mëposhtme jepet rregjistrimi i bizneseve sipas njësive vendore, të ndara sipas sektorëve. (Burimi i të dhënave QKR)

NjQV	Bujqësi gjueti	Restorant hotele	Miniera	Indu. perpunimi	Ndertim gaz	Qera	Sherbi	traspo	tregti
Arras	1	2	2	0	0	0	1	6	4
Fushe Cidhen	0	0	0	0	1	0	0	2	4
Kala Dodes	2	0	0	0	0	0	0	2	1
Kastriot	3	2	0	2	0	0	0	19	8
Lure	1	0	2	0	0	0	0	1	0
Luzni	0	0	0	0	0	0	0	3	0
Maqellare	1	28	1	17	4	7	12	33	69
Melan	0	4	0	1	1	1	0	9	10
Muhurr	1	0	1	2	4	1	0	4	2
Peshkopi	7	174	4	56	24	37	60	135	391
Selishte	0	0	1	0	1	0	0	4	1
Silove	1	0	0	0	1	0	0	4	1
Tomin	2	6	0	2	4	1	1	12	14
Zall Dardhe	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Zall Rec	0	0	0	0	1		0	3	1
<b>Totali</b>	<b>19</b>	<b>216</b>	<b>11</b>	<b>80</b>	<b>40</b>	<b>47</b>	<b>74</b>	<b>234</b>	<b>505</b>

Tabela me të dhënat e biznesit për çdo NJQV (Burimi QKR)



Për të theksuar në mjedisin e biznesit të zonës së Dibrës është se bizneset që kanë peshë më të madhe në ekonominë e përgjithshme në lidhje me të ardhurat janë Tregtia (505) ose 41% e bizneseve që lidhet si me shitjet me shumicë dhe

shitjet me pakicë dhe janë të shpërndara në çdo njësi vendore. Edhe në Zall-Dardhë, Lurë, Luzni që figurojnë që nuk kemi asnjë biznes nuk është shifër reale pasi pothuajse për cdo fshat është nga një pikë shitje.

Trasporti dhe Hotel+Restorante, që në krahasim me punësimin kanë një peshë më të ulët pasi kanë të punësuar kryesisht poseduesit e biznesit. Janë gjithsej 216 Hotele dhe Restorante, që tregojnë dhe orientimin e investimeve drejt fitimit të shpejtë, vetë-punësimit familjar dhe një orientimi turistik të zonës së Dibrës, sidomos të turizmit kurativ në luginën e Llixhave ose “luginë e Shërimit”. Ndërsa transporti është kryesisht transport udhëtarësh dhe kryhet me mikro-buz.

Sektor interesant është Bujqësi-Gjueti-Silvikulturë, dhe Industria e përpunimit që kanë një numër të konsiderueshëm bizneseve respektivisht 19 dhe 80 por që janë kryesisht në zonën rurale dhe janë investimet në baxho apo rezervate. Kjo ka një tendencë për tu rritur në të ardhmen.

#### **Numri i firmave dhe të punësuarve për çdo sektorë.**

Në zonën e Dibrës shumica e bizneseve janë biznese të vogla ku të punësuar janë 1-deri në 5 persona, por zyrtarisht të deklaruar nga një person. Numri më i madh i sipërmarrjeve janë në sektorin e shërbimeve dhe të tregtisë, kryesisht e përqëndruar në qytetin e Peshkopisë. Karakteristikë është që këto biznese janë kryesisht për tregun dhe konsumatorin lokal, kështu që kanë më shumë karakter familjar dhe biznese të vogla.

#### **Firmat dhe bizneset e mëdha për nga numri i punonjësve dhe prodhimi.**

Biznese të mëdha në Dibër janë 61 biznese kryesisht në sektorin e ndërtimitarisë, nxjerrjes së mineraleve, gazit dhe tregtisë. Sektorët e industrisë dhe sektori i fasonëve që kanë shumë të punësuar nuk ekziston fare në zonën e Dibrës, pasi megjithesë ka një fuqi punëtore infastruktura e dobët dhe e largët nga portet dhe metropoli nuk e favorizojnë zhvillimin e sektorëve të tillë, që punësojnë një numër të madh punonjësish.



## Identifikimi i grupimeve më të rëndësishëm ekonomik.

Zona e Dibrës ka disa biznese që janë të grumbulluara sipas llojit të produktit dhe pozicionit gjeografik, por nuk mund të themi se kemi një ndërveprim të strukturuar mes tyre. Më tipike janë bizneset e përqëndruara në Turizmin kurativ të Llixhave të Peshkopisë, ku Bashkia ka në zotërim kompleksin balnear ku menaxhon burimin ujqor, ambientet e kompleksit, shërbimin mjekësor dhe promovon këtë biznes të përqëndruar në një ndërmarje ekonomike e bashkisë. Shumë biznese hotelerie dhe shtëpi pritëse që ushtrojnë aktivitetin e tyre turistik në këtë zonë duke kompletuar (spontanisht) shërbimin turistik për pushuesit që frekuentojnë këtë zonë, e përqëndruar kryesisht në luginën e përroit të Llixhave, ose siç njihet ndryshe si “luginë e Shërimit”. Bizneset turistike paguajnë tarifën për ujën dhe lehtësirat e tjera që afrohen nga qendra balneare, e cila është në funksion të tyre.


## Numri i bizneseve të reja, tipi, sektori, aktiviteti dhe eksporti

Nuk kemi ndonjë të dhënë të saktë për biznese të reja por biznese që janë rregjistruar në 7 vitet e fundit (2007-2014) për çdo sektorë është si më poshtë.

NjQV	Bujqësi gjueti	Restorant hotele	Miniera	Indu. perpunimi	Ndertim gaz	Qera	Sherbi	traspo	tregti
Arras	1	1	0	0	0	0	0	0	2
Fushe Cidhen	0	0	0	1	1	0	0	1	3
Kala Dodes	2	0	0	0	0	1	0	1	3
Kastriot	7	1	0	1	1	0	0	11	5
Lure	1	0	2	0	0	0	0	1	1
Luzni	0	0	0	0	0	0	0	3	0
Maqellare	2	15	1	10	1	3	11	15	31
Melan	0	1	0	0	1	1	0	6	5
Muhurr	3	0	1	2	4	1	0	1	1
Peshkopi	6	97	1	28	14	38	34	49	159
Selishte	0	0	1	0	2	0	0	4	0
Sillove	3	0	0	2	1	0	0	1	1
Tomin	4	0	0	5	2	1	1	4	8
Zall Dardhe	0	0	0	0	1	0	0	0	1
Zall Rec	0	0	0	0	2		0	0	1
Totali	29	115	6	49	30	45	46	97	221

Pra siç shihet numri i bizneseve të reja të rregjistruara (sepse nuk mund të jenë biznese të reja) është 638 biznese ose 46% e bizneseve të regjistruara nga 2007 deri në 2014. Duke u nisur nga sektorët pothuajse kemi të njëjtin trend dhe rritja është e njëjtë, më shumë kemi biznese të reja që janë rregjistruar në hoteleri, ndërtim (30 me 40 sipërmarrje) dhe qera ambientesh dhe pasuri të

paluajtshme (45 me 47 subjekte të rregjistruara). Kjo ka ardhur dhe si shkak i ndërtimeve të shumta që janë realizuar gjatë këtyre viteve.



### Investimet vendase dhe të huaja

Investimet e mëdha në zonën e Dibrës janë kryesisht në sektorin e Energjisë me investime vendase dhe të huaja. Janë 4 HEC të ndërtuara në Lurë dhe 2 HEC në ndërtim në komunën Selishtë dhe Muhurr. Në këtë sektor janë disa koncesione dhe kërkesa koncesionare që mendohen të thithin investime të konsiderueshme për ndërtimin e 11 HEC-eve të tjera. Në sektorin mineralar më i rëndësishmi investim do të jetë në shfrytëzimin e Gipsit, investim që ka filluar dhe është aprovuar leja e shfrytëzimit duke bërë që së shpejti të fillojë puna. Investime nga investitorë lokalë më të rëndësishëm janë ndërtimi i 2 qendrave tregtare, 2 hotele qyteti me kapacitet 100 shtreter secili dhe ndërtimi i linjës së prodhimit të lëngjeve të frutave.

Investimet e mesme dhe të vogla kryesisht janë në sektorin e ndërtimit për shtëpi banimi, dyqane dhe shërbime të tjera. Kjo ka bërë që të rritet presioni i ndërtimit në zonën urbane ku dhe këto investime janë përqëndruar duke krijuar një situatë problematike në menaxhimin urban të hapësirës së terrorit të qytetit (të dhena nga bashkia për ndërtimet leje dhe legalizime). Ka një tendencë për të investuar dhe në sektorin e agro-përpunimit kryesisht në linja të vogla dhe të mesme në përpunimin e frutave, përpunimin e qumështit dhe magazinave frigoriferike.

### 3.3 Tregu i Punës, struktura e Punësimit / PaPunesisë.

Zona funksionale e Dibrës është nga zonat më të varfëra dhe me numrin më të lartë të papunësisë në Shqipëri. Shumica e popullsisë kryesisht në zonën rurale dhe atë urbane trajtohen me ndihmë ekonomike. Megjithëse me kriteret e qarta menaxhimi i kësaj mbështetje nuk është shumë korekt dhe që shkon tek përfituesi real. (së shpejti pasurohet me tregues real për cdo NJQV)

Zona e Dibrës ka një popullsi të aftë për punë në treguesin e moshës është në 53% të popullsisë së përgjithshme në zonë. Për periudhën 2002-2014 popullsia e aftë në moshë për punë ka qenë mjaft i qëndrueshëm (norma e rritjes vetëm ka qenë 46%). Shkalla e popullsisë në moshë për punë në zonat urbane është 45% dhe në ato rurale është 52.5%.


Nr.	Bashki/Komuna	Popullsia	Famillje	M	F	Moshë (0-14)		Moshë (15-59)		Mbi 60	
						M	F	M	F	M	F
1	Peshkopi	18,950	5,045	9,692	9,258	2036	1797	6688	6442	963	1029
2	Arras	3,841	1,133	1,958	1,883	454	426	1274	1212	230	241
3	FushëÇidhën	3,611	1,013	1,903	1,708	416	332	1285	1118	194	245
4	Muhur	3,516	1,021	1,840	1,676	388	359	1249	1097	202	209
5	Kala e Dodës	3,014	801	1,582	1,432	377	312	966	910	240	210
6	Kastriot	7,323	2,007	3,804	3,519	850	781	2558	2291	396	457
7	Lurë	1,482	480	734	748	165	147	458	489	108	107
8	Luzni	3,176	924	1,621	1,555	411	370	1054	986	159	202
9	Maqellarë	13,632	3,414	6,998	6,634	1659	1579	4611	4201	737	863

10	Melan	4,415	1,107	2,268	2,147	506	467	1489	1369	271	310
11	Tomin	8,489	2,219	4,367	4,122	947	858	2905	2652	515	597
12	Selishtë	1,961	540	1,017	944	257	235	640	581	129	137
13	Sllovë	3,184	994	1,615	1,569	350	337	1064	990	191	228
14	ZallDardhë	2,346	683	1,225	1,119	287	270	798	744	156	125
15	ZallReç										

Në vitin 2012 punësimi i përgjithshëm në rajon ishte vetëm 3,4% më i lartë se në 2008, dhe për të gjithë periudhën 2002-2010 ndryshimi ka qenë 23,3%.

Në zonën e Dibrës struktura e punësimit bazohet në sektorin e bujqësisë dhe sektori privat janë sektorët kryesorë që mbajnë peshën e punësimit në vitet e fundit, dhe punësimi në këtë sektor vazhdon të dominojë. Të dhënat tregojnë se numrin më të lartë të të punësuarve e kemi në sektorin bujqësor (56%) dhe sektorin privat jo-bujqësor (45%), ndërsa punësimi në sektorin shtetëror ka rënë me 24% në periudhën 2002-2012.

	2002	2006	2008	2010	2012
Sektori Publik	38.9	37.6	28.3	27.3	23.9
Sektori privat jobujqësorë	14.8	14.6	11.6	18.1	17.4
Sektori bujqësorë	46.3	47.8	60.1	54.7	58.6
Total	100	100	100	100	100



Popullsia ekonomikisht aktive në zonën e Dibrës (forca e punës) është rritur 50% në periudhën 2002-2012 dhe në vitin 2012 ajo përbën 27% të të gjithë popullsisë së Zonës Funktionale të Dibrës dhe

vetëm 54% të përgjithshëm të popullsisë në moshë pune, duke treguar një shkallë të lartë pasiviteti të popullsisë në këtë zonë. Struktura gjinore e krahut të punës sipas 2012, është 13% femra dhe 87% meshkuj. Gjatë 2002-2012 norma e pjesëmarrjes së femrës si fuqi punëtore ka rënë me 70%, ndërsa norma e pjesëmarrjes së mashkullit si fuqi punëtore është rritur me 37%. Norma e rregjistruar e papunësisë për zonën e Dibrës është i lartë (16%). Dinamika e papunësisë në zonë është në rënie me 43% krahasuar me vitin 2002 (28%).

Siç shihet edhe nga harta dhe treguesit, pjesa më e madhe e punësimit është e përqëndruar në zonën e Peshkopisë ku janë tregtia, shërbimet, ndërtimi por edhe në zonën e Maqellarës dhe të Tominit ku janë përqëndruar një sërë shërbimesh dhe disa investime në agropërpunim.

### 3.4 Edukimi dhe formimi profesional për banorët e zonës Funktionale

Banorët e zonës së Dibrës kanë traditë për karakterin e tyre punëtore dhe zotësi profesionale në administrim, ndërtimtari, bujqësi, etj. Një shprehje e vjetër popullore thotë “nëse digjet Stambolli, Dibranët e ndërtojnë, por nëse digjet Dibra, Stambolli nuk e ndërton dot”. Në sistemin arsimor dibran kanë qenë disa shkolla profesionale si shkolla e bujqësore, shkolla artistike, shkolla e ndërtimit dhe disa qendra të formit profesional.

Aktualisht është një shkollë e mesme profesionale që aftëson nxënësit në disa degë kryesore si mekanike, elektrike, tekstile, pedagogjike, ekonomike, etj. Megjithëse janë rreth 417 nxënës që ndjekin shkollën e mesme profesionale, kërkesat për degë të tjera që t’i përgjigjen tregut të punës janë të shumta dhe si më emergjentet janë ato që lidhen me bujqësinë, turizmin malor, ndërtimin etj.


Kërkesa të shumta janë dhe për qendra të formit profesional me kurse të shkurta dhe të gjata që të rrisin aftësitë në profesione të lira. Në zonën e Dibrës e përfundojnë shkollën 9-vjecare rreth 1200 nxënës dhe ndjekin shkollën e mesme vetëm 1000 nxënës, pra janë rreth 200 të tjerë që nuk ndjekin shkollën mesme. Pra nevoja për kurse të formimit profesional është shumë e lartë pasi janë 17% që nuk ndjekin ansjë shkollë.



Pra siç shikohet është një numër i madh nxënësish që kanë mundësi të ndjekin shkollat profesionale ose një potencial për kurse profesionale.

### 3.5 Ndërveprimi ekonomik në zonën Funktionale

Zona e Dibrës ka një diversitet territorial dhe social-ekonomik. Ndërveprimi ekonomik më i madh është në aspektin e punësimit, në tendencën se ku njerëzit blejnë dhe konsumojnë.



Peshkopia është qendra më e madhe e ndërveprimit në aspektin e punësimit. Shumica e të punësuarve në sektorin publik janë në Peshkopi pasi në qytet janë të përqëndruara të gjitha institucionet administrative rajonale, institucionet arsimore, shëndetësore, bankat, telekomunikacioni, etj. Në qytet janë dhe numri më i madh i bizneseve në shërbime, tregti, ndërtim që siguron dhe punësimin më të madh të banorëve. Në Peshkopi janë 1240

të punësuar në sektorin publik dhe 3150 biznese. Ndërsa zona tjetër që ka një aktivitet më të lartë është Maqëllara por ku ndërveprimi është më i lartë mes banorëve të vetë kësaj komune më shumë.

	Peshkopi	Tomina	Maqëllarë	Melan	Kastriot	F. Cidhen	Sillove	Kala e Dodes	rec	Dardhe	Lure	Arras	Muhurr	Selishte	Luzni
Biznese aktive	1018	45	180	27	36	7	7	5	5	0	7	16	17	8	3

Shumica e banorëve të Dibrës shërbimet bazë publike i arrin në Peshkopi. Spitali rajonal i Peshkopisë me 10 pavione, 340 infermiere, 23 doktorë është qendra më e madhe që mbulon gjithë zonën. Gjithashtu filiali i Universitetit “Aleksandër Mojsiu” dhe 2 shkollat e mesme (e përgjithshme dhe profesionale) që janë në Peshkopi e bëjnë qytetin qendrën arsimore të zonës së Dibrës. Qendra kulturore, sport klub Korabi dhe qendrat fetare janë të vendosura në Peshkopi, që u shërbejnë dhe të gjithave komunave përreth.

Peshkopia është edhe tregu më i madh për gjithë zonën e Dibrës. Janë rreth 20 pika shumice që ofrojnë furnizimin e gjithë popullatës së Dibrës, janë rreth 1300 dyqane, 8 pika grumbullimi të produkteve bujqësore dhe blektorale që dërgohen në tregun e Tiranës dhe Durrësit. Gjithashtu në Peshkopi mbahet dhe tregu javor (çdo të diel) ku nga e gjitha zona e Dibrës dalin në treg si shitës ose si blerës. Nga komunat e tjera vetëm në zonën e Maqëllarës janë 5 pika shumice, 15 dyqane

që janë vendosur në qendër të komunës dhe përgjatë aksit nacional të doganës së Bllatës, por kryesisht për banorët e fshatrave përreth.

Një ndërveprim që ka efekt në zonën e Dibrës është ndërveprimi ndërkufitar me Dibrën e madhe. Ka një tendencë më të madhe që blerës dhe vizitorë më shumë nga zona e Dibrës blejnë dhe marrin shërbime në Dibër të madhe pasi çmimet janë më të ulta dhe cilësia është më e mirë, kryesisht (ushqime, fruta, dhe disa shërbime mekanike, etj). Në numrin më të vogël (përkrah dhe të numrit më të vogël të popullsisë 1/6) ka një tendencë të blerjes dhe nga Dibra e madhe në Peshkopi si materiale hidro-sanitare, fruta, dhe shërbim dentar etj.

### **Konsumi, tregjet kryesore dhe tendenca e ndërveprimit.**

Në zonën e Dibrës qendra më e madhë tregtare është Peshkopia. Në Peshkopi janë pikat kryesore të mëdha tregtare nga të cilat furnizohen pikat e vogla në nivel fshati dhe pjesa më e madhe e banorëve. Në tabelën e mëposhtme janë dhënë nr I sektorëve kryesorë në zonën e Dibrës.

NjQV	Bujqësi gjueti	Restorant hotele	miniera	Indu. perpunimi	Ndertim gaz	Qera	Sherbi	traspo	tregti
Arras	1	1	0	0	0	0	0	0	2
Fushe Cidhen	0	0	0	1	1	0	0	1	3
Kala Dodes	2	0	0	0	0	1	0	1	3
Kastriot	7	1	0	1	1	0	0	11	5
Lure	1	0	2	0	0	0	0	1	1
Luzni	0	0	0	0	0	0	0	3	0
Maqellare	2	15	1	10	1	3	11	15	31
Melan	0	1	0	0	1	1	0	6	5
Muhurr	3	0	1	2	4	1	0	1	1
Peshkopi	6	97	1	28	14	38	34	49	159
Selishte	0	0	1	0	2	0	0	4	0
Sllove	3	0	0	2	1	0	0	1	1
Tomin	4	0	0	5	2	1	1	4	8
Zall Dardhe	0	0	0	0	1	0	0	0	1
Zall Rec	0	0	0	0	2		0	0	1
<b>Totali</b>	<b>29</b>	<b>115</b>	<b>6</b>	<b>49</b>	<b>30</b>	<b>45</b>	<b>46</b>	<b>97</b>	<b>221</b>

Siç shikohet dhe nga tabela numri më i madh i qendrave dhe pikave tregtare është në Peshkopi 159 dhe në Maqellarë që janë 31 qendra tregtare. Në Peshkopi është edhe tregu javor me prodhime bujqësore dhe artizanale ku vijnë banorë nga e gjitha zona e dibrës dhe më gjerë.

Ka një tendencë lëvizje edhe drejt Dibrës së Madhe, pasi çmimet dhe larmia e një sërë produktesh është më e lirë. Kohët e fundit lëvizja është më e madhe me makina për shkak se cmimi i naftës është më i ulët.

## 4. Analiza e thelluar e ekonomisë në zonën Funktionale

### 4.1 Karakteristikat ekonomike

Dibra është një qendër e hershme historike me profil agrar-bujqësor dhe e njohur për aftësitë profesionale të një numri të madh të popullsisë (ose zanatçinj) që shquheshin për punimin e gurit, rrobaqepës, orëndreqës, guzhinierë, etj. Gjithashtu ajo është dhe qendër administrative. Peshkopia është qendra urbane dhe administrative me 25% të popullsisë që banon në këtë qytet dhe është përmendur që në kohët e lashta si qendër Peshkopësh, me një lagje të vjetër, por që nuk ka luajtur një rol strategjik në zhvillimin ekonomik të zonës por me shumë si vlerë historike e saj. Kjo zonë ka potencial për rritjen dhe rigjenerimin e vlerave historike të saj, për të mundur shfrytëzimin e tyre për vlera të turizmit historik duke vënë në funksion të plotë shtëpitë dhe rrugicat e vjetra. Kjo kërkon përfshirjen e plotë të banorëve në këtë sipërmarrje duke e bërë qendrën urbane të Peshkopisë destinacion turistik për vizitorët.

Zona e Dibrës siç tregohet nga regjistri i popullsisë është 71,8% të popullsisë janë të moshës 16-64 vjeç, që është mosha ekonomisht aktive për të punuar, duke bërë që kjo zonë të ketë një fuqi punëtore të aftë për të kontribuar në zhvillimin e zonës. Shkalla e papunësisë në zonën e Dibrës është 33% dhe e krahasuar me nivelin kombëtar është më e lartë. Kjo shpjegon dhe arsyen se pse një pjesë e madhe e popullsisë kanë tentuar lëvizjen drejt qendrave urbane dhe metropolitane për të gjetur punë.

Sektorët dominues në ekonominë e Dibrës janë Bujqësia, Shërbimet, Tregtia, dhe sektori publik që kanë numrin më të madh të të punësuarve me rreth 61% në Bujqësi, 24% në Shërbime, 15% në sektorin Publik. Parë siç shihet Bujqësia është sektori më prioritar që influencon më shumë në punësimin dhe të ardhurat e familjeve dibrane. Gjithashtu sektor tjetër që ndikon në të ardhurat e familjeve dibrane është edhe turizmi kurativ i llixhave ku pushojnë mbi 12000 pushues dhe sjellin afërisht 3 milion euro në vit.

Ndërveprimi më i lartë ekonomik është i përqëndruar në qytetin e Peshkopisë ku popullsia nga fshatrat e komunave përreth e kanë si qendër ku është përqëndruar punësimi, shërbimet, dhe tregjet. Në Peshkopi ndodhen 3 qendra tregtare, 17 pika të shitjes me shumicë, rreth 1300 dyqane të shitjes me pakicë, dhe një treg javor për prodhimet bujqësore. Maqellara është një qendër tjetër ku ndodh një ndërveprim ekonomik, por kryesisht për banorët e saj dhe banorëve të Dibrës së Madhe, ku më shumë ndodh që banorët e Maqellarës më shumë shkojnë dhe blejnë apo marrin shërbime në Dibër sesa e anasjellta. Ndërveprimi ndër-kufitar me Dibrën e Madhe është karakteristikë për gjithë zonën e Dibrës në përgjithësi.



#### **4.2 Analiza e sektorëve kryesorë ekonomikë**

Në zonën funksionale të Dibrës sektorët kryesorë të ekonomisë janë bujqësia, shërbimet dhe tregtia. Shërbimet dhe tregtia sikur plotësojnë njëri tjetrin, por më e rëndësishme në sektorin e shërbimeve me potenciale të larta është turizmi kurativ që shfrytëzon burimet ujore termale të Llixhave në Peshkopi dhe ku pushojnë mbi 12,000 pushues nga e gjithë Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia.

Bujqësia është sektori kryesor në zonën e Dibrës, kjo për faktin sepse lidhet me traditën dhe ku numri më i madh i popullsisë është i përqëndruar dhe i punësuar. Dibra është një zonë e shquar për sasinë dhe cilësinë e prodhimeve të saj. Kështu ajo është kampione në prodhimin e mollës, qershisë, patates, arrave dhe fasules si dhe prodhimeve blektorale sidomos të djathit dhe mishit. Më shumë se 75% e popullsisë jeton në zona rurale dhe mbi 56% e të punësuarve janë në këtë sektorë.

Turizmi është sektori i dytë prioritar në Dibër, kjo për disa mundësi që i ofrojnë burimet natyrore dhe burimet kulturo-historike. Më e famshme Dibra njihet për turizmin kurativ, ku aktualisht pushojnë rreth 12,000 pushues në vit dhe janë bërë shumë investime në hoteleri dhe shtëpi pritëse. Gjithashtu Dibra ka shumë mundësi për të shfrytëzuar Turizmin malor pasi në të ndodhet Mali i Korabit (mali më i lartë në Shqipëri), parku i Lurës (me liqenet akullnajore), shumë burime dhe monumente natyrore, si dhe është një vlerë e madhe e kulturës dhe historisë kombëtare si vendlindja e Skënderbeut, kufiri i katolicizmit me ortodoksinë, etj.

#### **4.3 Analiza e Bujqësisë sektori prioritar ekonomik i Zonës Funksionale ( sektori 1)**

Bujqësia është sektori më i rëndësishëm që e karakterizon profilin e zonës së Dibrës. Ky sektor kontribon më shumë në punësimin e popullsisë rreth 61% dhe në prodhimtarinë për tregun lokal dhe atë kombëtar. Zinxhirët kryesorë të sektorit të bujqësisë në Dibër janë drithërat e Bukës, Pemtaria, Patatja, Blektoria, dhe Agro-Përpunimi.

#### **Struktura e Tokës Bujqësore:**


Në Dibër sipërfaqja më e madhe e tokës bujqësore mbillet me drithëra (misër, grurë, thekër) dhe foragjere (jonxhë, tërfil) kryesisht për ushqim për blektorinë. Pemtaria është një nga zinxhirët tradicionalë të bujqësisë në Dibër kryesisht me mollë, qershi, kumbull dhe pak sipërfaqe me vreshtari. Plantacionet me pemë frutore kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ekonominë e dibranëve si para 1990 ku sipërfaqet e mbjella pothuajse mbulonin të gjithë sipërfaqen kodrinore të Dibrës, por që u dëmtuan në fillim të viteve 1990 dhe tani së fundi kemi një tendencë të krijimit të plantacioneve të reja bazuar në përvojën tradicionale dhe në përvojën e re marrë nga Greqia dhe Italia, përvojë e sjellë nga emigrantët. Sipërfaqja e madhe me kullota ka krijuar kushte të përshtatshme për mbarështrimin e Blektorisë, kryesisht të deleve, dhive në zonat malore të Kalase së Dodës, Recit, Zall-Dardhës, Selishtës, Arrasit dhe një pjesë e fshatrave malorë të Kastriotit, Tominit, Melanit dhe Maqëllarës. Zona fushore merret me mbarështrimin e gjedhit për qumësht dhe për mish. Perimet dhe patatet janë një kulturë tjetër bujqësore me rëndësi në Dibër, kryesisht perime për nevojat e familjeve por fasulja dhe patatja kanë

prodhimtari të lartë dhe luajnë rol të rëndësishëm në ekonomitë e familjarëve të shumë zonave të Dibrës. Me patate më shumë shquhet zona e fshtrave të Melanit (Katundet e Epra) dhe Tominit.

Tabela e strukturës së tokës së mbjellë (të dhënat nga Drejtoria e Bujqësisë)

Nr	Sip. Gjith.	Tokë arë	Pemë Frutore	Vresh ta	Pyje	Kullota	Tokë e papërdorur	Tokë e refuzuar
1	66209	18436	1165	51	34193	12898	1805	5726

zë



e

Sic shihet dhe nga tabela, toka bujqësore në Dibër një sipërfaqe prej 66209 ha dhe për momentin punohet dhe mbillet reth 38234 ha ose 57.7% dhe ka akoma toka të papunuara prej 42.3% cila vjen kryesisht për shkak të


mungesës së ujit për vaditje dhe konfliktit (ose paqartësisë) së pronësisë 7531 ha ose 11.5% (e refuzuar). Kjo sipërfaqe e pa mbjellë është shumë e përshtatshme për t'u mbjellë me arrore pasi dhe rendimenti është i lartë dhe toka e përshtatshme. Mungesa e ujit për vaditje më e dukshme është për sipërfaqet e tokës në Maqellarë dhe në Kastriot, ndërsa tokat me problematikë pronësie lidhen më shumë me ato sipërfaqe që janë pronësi e fshatrave (që quhen vakufe). Siç shikohet dhe nga figura, sipërfaqja pyjore zë pjesën më të madhe të tokës 46% dhe kullotat 18%, kjo është një mundësi për shtimin e numrit të blektorisë dhe shfrytëzimin racional të kësaj sipërfaqe duke i dhënë jetë ekonomisë pyjore, me prodhimet e dyta të pyllit, bimët mjekësore dhe turizmi malor.

### Blektoria:

Sipërfaqja më e madhe e tokës mbillet me drithërat e bukës, pemëtari, foragjere dhe perime + patate. Blektoria është një sektor prioritar dhe jetik për zhvillimin e zonës rurale dhe ekonomisë në zonën e Dibrës. Ajo nuk ndahet nga zhvillimi i bujqësisë dhe është pjesë integrale e zhvillimit të këtij sektori. Blektoria luan një rol të rëndësishëm dhe kryesisht mbarështrahet për qumësht, mish dhe këto vite pak për lesh. Ka një tendencë për mbarështrimin e bletarisë dhe pak të pularive. Tabela e mëposhtme jep strukturën e mbjelljes së tokës me kulturat bujqësore.

Nr	Drithëra buke	Foragjere	Pemtari	Vreshtari	Perime	Patate	Gjithsej
1	3660	5804	1165	50	355	520	11554

Tabela: Struktura e mbjelljeve (të dhëna nga Drejtoria e Bujqësisë)




Siç shihet dhe nga tabela, lidhja e bujqësisë me blektorinë është e pandalshme, prandaj dhe sipërfaqja më e madhe e tokës mbillet me foragjere për ushqim për bagëtitë reth 50% e sipërfaqes. Më pak mbillet vreshtari,

kjo për shkak dhe të klimës e cila nuk është shumë e përshtatshme për këtë varietet dhe nuk ka njohuri për lloje vreshti që përshtatet me klimën. Pemtari është akoma në sipërfaqe të vogël, vetëm 10% të sipërfaqes e cila duhet të shtohet. Bazuar ne traditën e gjithë sipërfaqe e mbjellë më Foragjere shumë mirë mund të mbillet me pemtari, duke stimuluar një ekonomi integrale bujqësore për zonën e Dibrës mes pemtarisë dhe blektorisë.

*Numri i krerëve:* Blektoria është sektor shumë i rëndësishëm, dhe kryesisht në zonën e Dibrës mbarështrihen gjedhët, dhitë, delet dhe ka një tendencë për pula dhe bletë. Tabela më poshtë jep numrin e krerëve për zonën e Dibrës.

Nr	Gjedhë	Dele	Dhitë	Shpendë	Bletë
	16500	49280	18500	170000	8600

Tabela: Numri I krereve (të dhëna nga Drejtoria e Bujësisë Dibrë)



Karakteristikë është që pjesa fushore (fshatrat e Tominit, Maqellarës, Kastriotit, Fushë-Cidhnës) merret më shumë mbarështrimin e gjedhit, ndërsa pjesa malore në zonën ku ka kullota alpine më shumë merren me mbarështrimin e deleve ndërsa pjesa e zonës së

pyjeve të larta dhe të ulta më shumë me dhinë. Zona malore e Kalasë së Dodës, Sillovës, Kastriotit, Tominit, Melanit dhe Maqellarës merren me shumë me mbarështrimin e deleve, ndërsa pjesa malore e Reçit, Dardhës, Lurës, Selishtës, Muhurrit, Arrasit merren me shumë me mbarështrimin e dhisë. *Rekomandohet*, sipas mendimit të specialistëve numri i krerëve në blektori

mund të shtohet (deri në 80%-100%) pasi janë mundësitë dhe pa e humbur racën autoktone duhet të shtohen përpjekjet për përmirësimin racor si tek gjedhët dhe sidomos tek dhitë.

*Prodhimi blektoral* nuk është në rendimente të larta kjo për shumë arsye, por më kryesorja është që tregu i produkteve blektorale është i vogël, racat nuk janë të shquara për prodhimtari të lartë. Megjithatë zona e Dibrës ka një prodhim të konsiderueshëm blektoral. Në tabelën e mëposhtme jepet prodhimtaria për zonën e Dibrës. Sic shikohet dhe nga tabela prodhimi i qumështit është më i lartë, por rendimenti dhe përfitimi nuk është është shumë i lartë nga qumështi.

*Rekomandohet* që të shtohen përpjekjet për rritjen e numrit të krerëve dhe të formalizimit të fermave blektorale me raca të zgjedhura dhe të profilizuara për qumësht dhe mish.

<b>Prodhimet</b>	qumesht	mish	veze	mjalte
<b>Prodhimi në Ton</b>	36960	3075	23250	86


Tabela: Prodhimtaria në Blektori (të dhëna nga Drejtoria e Bujqësisë)

*Përpunimi* i prodhimeve blektorale, kryesisht i qumështit është në formën tradicionale dhe bëhet nga çdo familje dibrane, ku merren kosi, gjalpi, gjiza dhe djathi, kryesisht për nevojat familjare dhe pak për treg. Vitet e fundit ka filluar dhe përpunimi i qumështit dhe ku janë ngritur rreth 19 baxho për përpunimin e qumështit duke prodhuar lloje të ndryshme djathi, si në Kala të Dodës, në Gramë, Rec, Muhurr, Arras, Peshkopi dhe Maqellarë. *Rekomandohet*; Megjithëse ka një tendencë në rritje për përpunimin, kërkohet më shumë mbështetje nga skemat e subvencioneve për linja përpunimi, dhe për mbrotjen e prodhimit vendas nga konkurrenca e pandershme e mallin që vjen nga importi, ku kostoja e prodhimit të 1kg djath është 350-450 leke, dhe shitet në treg po me këtë çmim, ose më poshtë.

*Tregu i prodhimeve blektorale* është një treg i vështirë. Sasia më e madhe e prodhimit blektoral përdoret për nevojat familjare, një pjesë ikën për tregun lokal në Peshkopi, dhe një pjesë tjetër shkon në tregun kombëtar, kryesisht në Tiranë. Imazhi pozitiv i prodhimeve dibrane, nuk është shoqëruar me një markë apo me një zinxhir të plotë dyqanesh për prodhimet dibrane. Kjo ka bërë që shumë produkte të zonave të tjera të shiten si produkte dibrane, dhe të dëmtohet imazhi tek konsumatori. Prodhimi për treg për zonën e Dibrës është:

<b>Prodhimet</b>	qumesht	mish	veze	mjalte
<b>Prodhimi në Ton</b>	36960	3075	23250	86
<b>Sasia për treg</b>	2300	2500	6700	60
<b>% në treg</b>	6%	81%	29%	70%

Tabela e prodhimit për treg (të dhëna nga Studimi I SNV për tregun e prodhimeve bujqesore)



Siç shikohet dhe nga grafiku mishi dhe mjalti janë prodhimet më të kërkuara në treg respektivisht me 81% e mishit dhe 70% e mjaltit, kjo kryesisht për tregun lokal dhe atë kombëtar. Niveli i ulët i qumështit për treg lidhet pasi ai tregtohet i pa-

përpunuar dhe vetëm bulmetrat tradicionale shtëpiake që dalin në treg. Çmimi i bumetit është jo shumë i kënaqshëm për prodhuesin, ky është dhe një fakt tjetër se përse mishi dhe mjalti që kanë një çmim të leverdishëm kanë një orientim të fermerëve më shumë nga tregu që variojnë 700-1000 lekë/kg për mish, dhe për mjaltin 1000-1300 leke/kg mjalti.

*Rekomandohet* që të krijohet një markë për prodhimet Dibrane, dhe të ketë kënde të posaçme tek pikat e shitjes me produkte dibrane dhe që të kenë markën dhe paketimin e duhur.

*Analiza e kostos së prodhimit blektoral:* duke u bazuar në analizat sipas standarteve teknike të specialistëve të blektorisë kryesisht në raport me prodhimin e qumështit (pa u futur tek djathi/përpunimi) dhe të mishit kemi këto tregues bazë, që jepen në tabelë.

Kulturat blektorale	Rendimenti/ha	Vlera shitje 1kv	Të ardhura bruto për 1ha	Shpenzime në lekë	Të ardhura neto për 1 ha
Qumesht	80	5000	400,000	100,000	300,000
Mish	7	50000	350,000	100,000	250,000

Tabela e analizës së kostos (të dhëna nga studimi I SNV për tregun bujqësor)

Sic shihet dhe nga tabela nuk ka ndonjë ndryshim të madh mes produkteve për sa i përket fitimit për 1ha mes qumështit dhe mishit, por favori për momentin është tek kërkesa e madhe në treg për mish, dhe kërkesa e vogël për qumështin dhe produktet e tij. Nëse do të rekomandohet për ferma të integruara për qumësht dhe mish, shtojnë të ardhurat në fermat blektorale.


## Bujqësia:

Sektori bujqësor është më i rëndësishmi dhe tradicionali për zonën e Dibrës, e cila shquhet si për prodhimtarinë dhe cilësinë e prodhimeve të saj. Prodhimtaria për produktet bujqësore është në varësi të sipërfaqes së mbjellë. Pjesa më e madhe e prodhimit konsumohet nga vetë familjet dhe pjesa tjetër shkon për treg. Karakteristikë kryesore e bujqësisë në Dibër është që ekonomitë janë të organizuara në bazë familje, si ato ekonomitë e vogla dhe ato ekonomi që janë pak më të mëdha apo më të strukturuar.

*Prodhimi bujqësor*, sipas të dhënave që kemi nga Drejtoria e Bujqësisë por dhe nga diskutimet me NJQV, në zonën e Dibrës mbillen kryesisht prodhimet tipike tradicionale bujqësore si drithërat e bukës, perimet, fasule, foragjere, patate dhe frutat ku peshën më të madhe e zënë molla, kumbulla, qershia etj. Në tabelën e mëposhtme jepet sasi e prodhimit për produktet kryesore.

Prodhimet	Mollë	Kumbull	Qershia	Patate	Fasule	Drithëra buke	Perime	Qepë	Farrë jonxhe
Prodhimi në Ton	1700	1250	640	14000	1330	18800	10300	2000	80

Tabela e prodhimeve bujqësore (të dhëna të marra nga Drejtoria e Bujqësisë)




Siç shikohet dhe nga tabela dhe nga grafiku prodhimet më të larta janë ato tradicionale drithërat e bukës, patate dhe perime. Pak prodhime janë nga frutat dhe fara e jonxhës që janë produkte me orientim më shumë drejt tregut. Pra familjet mendojnë

më shumë për nevojat e tyre familjare se sa për tregun. *Rekomandohet*, që familjet dibrane të mendojnë më shumë për një strukturë të re të ekonomisë familjare të orientuar më shumë drejt tregut.

*Tregu i prodhimeve bujqësore*: pjesa më e madhe e prodhimit bujqësor destinohet për nevojat e vete familjeve dhe pjesa tjetër për tregun lokal në Peshkopi dhe tregun kombëtar kryesisht në

Tiranë. Sasia e prodhimit për treg është e vogël. Në tabelën e mëposhtme jepet sasia e produkteve bujqësore për treg.

Prodhimet	Mollë	Kumbull	Qersh	Patate	Fasule	Drithëra buke	Perime	Qepë	Farrë jonxhe
<b>Prodhimi në Ton</b>	1700	1250	640	14000	1330	18800	10300	2000	80
<b>Sasia për treg</b>	1100	900	500	8000	600	5000	6000	1100	40
<b>%</b>	65	65	78	57	45	27	58	55	50




Siç shihet nga grafiku, orientimin më të lartë në treg e kanë frutat të cilat janë më të kërkuarat si qershia me 78% dhe molla dhe kumbulla me 65%. Më pak produkte për treg janë drithërat e bukës me 27%, kjo do të thotë që duhet të mendojmë

ndryshe për këto dy prodhime duke shtuar prodhimin e pemëve frutore, pra duke shtuar sipërfaqen e mbjellë me mollë, qersh, kumbull dhe duke zvogëluar sipërfaqen me drithëra buke, pasi janë më pak të kërkuara në treg. Tregu i produkteve bujqësore të dibrës akoma nuk është formalizuar në cilësinë e dëshiruar pasi mungon marka e produkteve, çertifikimi, pikat e grumbullimit dhe pikat e shitjes. *Rekomandohet*, të shtohet sasia e prodhimit për treg, të orientohet fermeri për të mbjellë sipërfaqe më të madhe me pemë frutore që janë më të kërkuarat për tregun, dhe të krijohet një linjë e shitjeve të prodhimeve dibrane me produkte të çertifikuara të origjinës, markën, paketimin dhe pika shitjeje në Tiranë.

Analiza e kostos: Prodhimet për nga rendimenti, kostoja e prodhimit dhe çmimi në treg janë shumë të ndryshme dhe në shumë kohë ata janë pothuajse të pandryshueshme në treg. Tabela e mëposhtme jep këto të dhën për secilin produkt.

Kulturat bujqësore	Rendimenti/ha	Vlera shitje 1kv	Të ardhura bruto për 1ha	Shpenzime në lekë	Të ardhura neto për 1 ha
Drithëra buke	40	2500	100,000	60,000	40,000
Faragjere	50	1500	75,000	35,000	40,000
Pemtari	400	5000	2,000,000	400,000	1,600,000
Vreshtari	250	6000	1,500,000	500,000	1,000,000
Perime	400	4000	1,600,000	800,000	800,000
Patate	400	3000	1,200,000	600,000	600,000

Tabela me analizën e kostos (të dhëna nga studimi I SNV per tregun bujqësor)



Siç shihet nga tabela rendimenti më i lartë është në pemtari, perime dhe patate që e kalojnë 400kv/ha si dhe fitimi neto më i lartë është po tek këto kultura që variojnë tek 1.6 milion lekë për pentarinë (mollë, qershi dhe kumbull) dhe tek perimet dhe

patate që shkon në 600 ose 800 mijë. Kulturat e drithërave të bukës dhe foragjeret kanë shumë pak fitim ose aspak, dhe kultivimi i tyre bëhet për shkak të traditës dhe përdoret për nevojat e familjes dhe foragjeret për blektorinë.

Agro-përpunimi ka filluar të intensifikohet këto vitet e fundit. Investitorët dhe fermerët Dibranë kanë investuar në linja të vogla, të mesme dhe të mëdha për përpunimin agrobujqësor sidomos për përpunimin e qumështit (baxho), të frutave (lëngje dhe pije alkolike), dhoma frigoriferike për fruta, dhe të prodhimeve artizanale të recelnave, turshive, kompostove dhe Jufkafë që janë prodhime tipike dibrane. Siç shikohet dhe nga tabela e mëposhte më shumë janë investuar dhe dnërtuar linja të përpunimit të qumështit dhe në magazina frigoriferike për fruta, kjo në varësi dhe të prodhimit dhe lëndës së parë.

Infrastruktura bujqësore në zonën e Dibrës është nën standartin e kërkuar. Infrastruktura lidhet me sistemin vaditës, mekanikën bujqësore, dhe qendrat/pikat e furnizimit bujqësore.



Sistemi i vaditjes: Për 53% të tokës bujqësore mungon sistemi vaditës, duke bërë që nga 19117ha sipërfaqe toke të vaditet 10594 ha dhe realisht nga këto ujiten 7542 ha, pasi pjesa tjetër ka probleme me kanalet vaditëse ose burimin e ujit.

Mekanika Bujqësore: Edhe mekanika bujqësore lë për të dëshiruar janë gjithsej 432 makina bujqësore në Dibër, afërsisht 0,02 makina për ha, duke bërë që afërsisht 10473 ha e tokës të punohet me krahë, 4969 ha të punohen me kafshë dhe 12870 ha të punohen me traktorë, tregues që tregon akoma primitivitetin e punës në bujqësi.

Infrastruktura rrugore: Fragmentarizimi i madh ku për një familje kemi afërsisht 1.03 ha tokë e cila është e copëtuar edhe në ngastra më të vogla, krijon problem edhe me infrastrukturën rrugore. Rrugët e ngushta, kanë sjellë dhe probleme sociale pasi tokat dhe ngastrat janë ndarë sipas periudhës së 1900, dhe ky sistem rrugor pengon mekanizimin dhe modernizimin e bujqësisë në Dibër.

Pikat e furnizimit bujqësor: Pikat e këshillimit dhe të furnizimit me farëra, pesticide, fidane dhe të tjera lëndë ndihmëse janë të vogla dhe jo të kompletuara, ku pjesa më e madhe të përqëndruara në Peshkopi (7 pika) dhe në Maqellarë (2 pika). Këto qendra janë inisiativa private, dhe mungojnë pikat e formalizuara të cilat të kenë asistencën e duhur teknike, labororet, kontrollin, dhe shërbime të tjera duke bërë që edhe kur përdoren farrërat, fidanet apo pesdicidet të mos jenë brenda standarteve teknike dhe cilësisë së duhur.

## **Analiza SWOT**

<p><u>Pikat e Forta:</u>  80% e popullsisë është në zonë rurale,  Tradita familjare në mbarështrimin e bujqësisë dhe blektorisë, ku aktualisht janë 46% e punësimit janë në këtë sektorë,  Përbërja e tokës dhe klima në Dibër janë të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë,  Prania e institucioneve Bujqësore të këshillimit, ekstensionit dhe specialistëve të Drejtorisë së Bujqësisë në zonën e Dibrës,  Eksperienca e përfituar në vite, e pasuruar me modele suksesi nga vendet fqinje dhe përvoja e sjelle nga emigrantët,  Imazhi i mirë i produkteve bujqësore dhe blektorale të Dibrës,  Fuqi e lirë dhe aftë për të punuar në sektorin bujqësorë,  OJF lokale që punojnë për zhvillimin e sektorit dhe individëve të pranishëm në Dibër.</p>	<p><u>Pikat e dobëta:</u>  Fragmentarizimi i lartë i tokës bujqësore në ngastra të vogla që nuk krijon mundësi për efencë në prodhim,  Fermat e vogla, që janë më shumë familjare,  Rendimenti i ulët i prodhimit dhe kosto e ulët e fitimit për dynim (150\$),  Mungesë e infrastrukturës së përshtatshme bujqësore,  Mungesa e pikave të grumbullimit të prodhimeve bujqësore, duke bërë që fermeri të ketë problem me shitjet e prodhimit,  Mungesë e aksesit në tregun lokal dhe kombëtar, ku largësia e prodhuesve me këto tregje rrit koston dhe zvogëlon mundësitë me dalë në treg,  Kostoja e lartë e prodhimit,  Numri i ulët i specialistëve të bujqësisë si këshillues për numër të fermerit ose fermës,  Mungesa e kapaciteteve bashkëkohore të formalizuar për njohuritë e fermerëve,  Mungesa e teknologjive të reja bujqësore dhe</p>
---	--

	<p>teknikave të reja,  Ngurtësia dhe mungesa e aftësisë në përdorimin e inovacioneve teknike dhe teknologjike nga fermerët,  Mungesa e shkollës profesionale me profil bujqësor,  Mungesa e kulturës së bashkëpunimit mes fermerëve, duke mos krijuar shoqëri dhe ko-operime,  Investime të vogla në bujqësi,  Mungesa e lobingut për të përfituar nga programet, skemat qeveritare,  Mungesa e promovimit të produkteve bujqësore dhe blektorale.</p>
<p><u>Mundësitë:</u>  Skema e subvencionit nga ministria e Bujqësisë,  Prania e donatorëve me fokus të punës sektorin bujqësorë,  Përvoja e sukseshme rajonale (Maqedoni, Kosovë, Itali dhe Greqi),  Kërkesa e tregut për produkte nga Dibra,  Universiteti Bujqësor i Kamzës dhe rritja e interesit për të ndjekur këtë universitet,  Programi qeverisës ku e ka cilësuar bujqësinë si sektor prioritar,  Kriza globale, ka bërë të kthehen sytë nga bujqësia dhe kthimi i emigrantëve ka shtuar investimin dhe përmirësuar cilësinë e ndërhyrjes në bujqësi.</p>	<p><u>Kërcënimet:</u>  Kosto e ulët e prodhimit bujqësorë në rajon, duke konkuruar prodhimin lokalë,  Përdorimi i helmeve dhe pesticideve kanë penguar aksesin e prodhimeve lokale në tregjet ndërkombëtare sidomos për eksport,  Fatkeqësitë natyrore të cilat po mbeten të pa-parashikuara sipasojë e ndryshimeve klimaterike dhe mungesës së teknologjive dhe stacioneve të parashikimit të motit,  Sëmundjet dhe viruset (kanceri i gështenjës, kroma e qershisë, bluceroza, etj)  Politika të gabuara dhe spontane të pa-bazuara në zgjidhjen e problemve reale të bujqësisë (hapa të mëdha pa kaluar në hapa të vegjël)  Pronësia e paqartë,  Korrupsioni.</p>

### Gjetjet:

Sfidat më të mëdha që përballet bujqësia në Dibër sipas diskutimeve me grupe fokus dhe me intervistave individuale me aktorët kyç të bujqësisë janë:

- Frangmentarizimi i madh i tokës e cila rrit koston e shërbimeve, ul fitimin, dëmton cilësinë dhe sasinë e prodhimit, vështirëson aksesin e prodhuesve në treg dhe pengon investimet në këtë sektor.
- Mungesa e studimeve dhe orientimeve të fermerëve për të kaluar nga bujqësia tradicionale dhe primitive në bujqësinë intensive dhe të integruar;
- Mungesa e kapaciteteve dhe specialistëve për numër të fermerëve dhe apatia e njohjes dhe adaptimit të njohurive, teknikave të reja në bujqësi. Kjo reflektohet dhe në mungesën

e aftësive për të hartuar plane dhe dosjen e aplikimeve për të thithur investimet në skemën e subvencioneve dhe programeve të tjera që kanë në fokus bujqësinë.

- Mungesa e strukturave të kooperativave dhe aftësisë për të bashkëpunuar dhe kooperuar mes fermerëve. Ekziston ligji për Shoqëritë e Përbashkëta Bujqësore, i cili ndihmon në formalizimin e kooperimit mes fermerëve por që nuk është punuar dhe nuk ka një fushatë ndërgjegjësimi të fermerëve për hapat, modelet dhe përfitimet që vijnë nga ky lloj bashkëpunimi, formalizimi i strukturës së kooperativës.
- Mungesa e një zinxhiri të plotë tregu, ku të përfshihen marka, pikat e grumbullimit, dyqanet e shitjeve, kontrolli, promovimi që produktet bujqësore dibrane të kenë markën dhe linjën e tyre të tregut.
- Diversifikimi i lartë i produkteve, duke bërë që familjet fermere dhe grupet prodhuese të merren me kultivimin e shumë kulturave që nuk japin rendimet dhe norma e fitimit është e vogël.

### **Rekomandime:**

- Zona e Dibrës duhet të bëjë hartën rajonale (plani i menaxhimit të tokës) për kulturat bujqësore më të përshtatshme me klimën dhe përbërjen e tokës,
- Kulturat më prioritare dhe me fitim më të madh që duhet të fokusohen janë Pemtaria (mollë, qershi, kumbull), Blektoria (Dele në kullotat alpine dhe dhi në pjesën e pyjeve të ulta dhe të larta) si dhe shtimi i numrit të fermave (familjare nga 500-2000 krere) me shpendë, dhe bletarisë.
- Krijimi i kooperativave ose ndërmarrjeve të bashkëpunimit bujqësorë si alternativa më e mirë për uljen e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave.
- Shtimi i investimeve në sektorin e agro-përpunimit (kryesisht në linja të vogla artizanale) të përshtatshme me kapacitetin prodhues të zonës, dhe cilësi të lartë të prodhimit.
- Shtimi i numrit të specialistëve të bujqësisë si në drejtorinë e Bujqësisë por dhe në pushtetin lokal, duke shtuar këshillimin për fermerët.
- Krijimi i qendrave të grumbullimit bujqësorë që nga magazinimi, tregu, kontrolli i cilësisë deri tek shërbimet bujqësore (mekanike, pesticidet, këshillimi etj).
- Hapja e qendrave të formimit profesional dhe kurse (formale dhe informale “mësojmë duke punuar”) për fermerët e rinj, menaxhim dhe për teknologjitë e reja bujqësore.
- Projekte Investimesh në infatsrukturën bujqësore për vaditje (kanale, ujëmbledhës), rrugë etj. Pushteti lokal duhet të hartojë projekte prioritare për veprat të mëdha që ju shërbejnë një grupi të madh fermerësh.
- Ngritja e qendrave të specializuara teknike që merren me kontrollin e cilësisë (laboratore)dhe parashikimin e kushteve të motit.
- Zhvillimi i zinxhirit të vlerës për produktet bujqësore të dibrës duke krijuar markën lokale dhe rrjetin e dyqaneve në tregun vendas, sidomos në metropol.
- Pushteti lokal të aplikojë për projekte dhe kredi që nxisin zhvillimin duke zhvilluar zinxhirin e nën/produktit dhe produktit bujqësor. (psh për mollën, të fillojë nga fidanishtja deri tek përpunimi).

#### 4.4 Analiza e Turizmit (sektori i dytë prioritarë për zonën Funktionale)

Turizmi është sektori i dytë prioritar dhe me shumë mundësi për zhvillimin e zonës Funktionale të Dibrës. Potencialet e larta turistike me burimet e shumta natyrore, vlerat e mëdha kulturore dhe historike, kulinaria tradicionale e pasur, janë potenciale të pashfrytëzuara për turizmin. Potencialet më të larta janë për zhvillimin e turizmit kurativ, malor, historik dhe kulturor.

##### Turizmi kurativ:

Zona e Dibrës është e njohur për turizmin kurativ, që shfrytëzon burimet termale të Llixhave të Peshkopisë, dhe ku pushojnë rreth 12,000 pushues në vit nga të gjitha trevat e Shqipërisë dhe Kosova dhe Maqedonia.

Në luginën e përroit të Llixhave ose siç njihet “Lugina e Shërimit” nga popullsia lokale, është burimi i famshëm termal i Llixhave, që kanë një temperaturë rreth 40 °C, me përmbajtje kripërash dhe gazrash të tretura në to. Në këtë territor ndodhet dhe kompleksi balnear i Llixhave që është pronë e bashkisë Peshkopi, dhe ku afrohen të gjitha shërbimet e nevojshme duke filluar nga pishina, vaska, masazhi, balta dhe shërbimi mjekësor. Cilësia e ujit të Llixhave të Peshkopisë është nga më të mirat në Europë.

Natyra e këtij turizmi është kurative, kryesisht për kurimin e dhimbjeve reumatizmale dhe frekuentohen nga një shtresë e gjerë e popullsisë. Numri më i madh i pushuesve janë të moshës nga 45-70 vjec dhe janë më shumë pushues që vijnë nga pjesa e Shqipërisë Veriore, Tirana, Durrësi, Kosova, dhe Maqedonia. Ky turizm është sezonal dhe frekuentohet kryesisht në vjeshtë (Shator-Nëntor) dhe në periudhën e pranverës në sezonin (Mars-Qershor).

Akomodimi dhe shërbimi turistik, është në gjendje të kënaqshme dhe ofrohet nga një numër i konsiderueshëm hotelesh dhe shtëpi pritëse. Në zonën e përroit të Peshkopisë janë të ndërtura rreth 300 shtëpi pritëse (të madhësive të ndryshme) dhe 7 hotele me afro 60 shtretër që u shërbejnë pushuesve. Në këto ambjente shërbimi ofrohet i plotë ditor (duke përfshirë fjetje, ushqim, dhe terapinë e ujit të ngrohtë). Kostoja e shërbimit nuk është e lartë, që i përgjigjet mundësive të klientelës duke variuar nga 10-13 Euro në ditë, për një paketë 10-ditore pra 100-130 Euro për person me të gjitha të përfshira.

<b>Objekte akomodimi</b>	<b>Hotele</b>	<b>Shtëpi pritëse &gt;15 shtretër</b>	<b>Shtëpi pritëse 10 -15 shtretër</b>	<b>Shtëpi pritëse &lt;10</b>
<b>Nr shtretërve</b>	7	30	50	170

Tabela e familjeve pritëse dhe hoteleve në zonën e Llixhave (të dhëna nga bashkia)




Figura e akomodimit turistik.

*Rekomandime:* Potenciali turistik kurativ në zonën e Dibrës ka mundësi të zhvillohet edhe më shumë duke rritur numrin e vizitorëve nëpërmjet shtimit të sezonit të pushimit edhe gjatë muajve të verës (Qershor-Gusht) si dhe gjatë muajit të dimrit për një numër më të vogël, por më elitare. Shfrytëzimi i ujit të Llixhave dhe nga hotelet private gjatë kohës që në kompleksin balnearë nuk ka pushues, do të shtonte numrin e pushuesve dhe investimin nga sektori privat.

Në kompleksin balnearë të Llixhave ka mundësi të krijohen ambjente më cilësore për vizitorët, duke investuar në krijimin e një pishine dhe në ambjente të tjera shërbime për fizioterapi, kurim, dhe ambjente sociale, duke u bazuar dhe në eksperiencën e qendrave balneare të Dibrës së Madhe (Kosovrast dhe Banisht).

Në lagjen e Llixhave, e cila përkon dhe me parkun e qytetit të Peshkopisë të investohet për krijimin e parkut rekreativ me ambjente të gjelbërta, rrugë këmbësore, stola, ambjente sportive, për ti dhënë zonës një pamje dhe ambjent të bukur piktoresk dhe atraksion turistik.

Të komunikohet me banorët e lagjes së Llixhave që të sistemohen muret rrethuese dhe fasadat e shtëpive me një stil që të përshatet me turizmin e zonës dhe arkitekturën tradicionale.

#### Turizmi malor dhe rural:

Zona e Dibrës ka potenciale të shumta për zhvillimin e Turizmit malor dhe rural. Peizazhi piktoresk i zonës së Dibrës përshkohet në të gjithë gjatësinë e tij nga Lumi Drin i Zi, dhe njihet dhe si lugina e Drinit (lumi më i gjatë në Shqipëri). Lugina e Dibrës rrethohet nga dy anët nga vargmali Deshat-Korab që është dhe mali më i lartë në Shqipëri, dhe vargmalet e Lurë-Selishtë që janë dhe 21 liqenet akullnajore. I gjithë territori dallohet për monumente të shumta natyre qofshin këto gjeo-monumente, hidro-monumente apo bio-monumente (41 monumente natyrore), të cilat për vlerat e tyre të veçanta historike, estetike, turistike, biologjike janë një numër i madh

objektsh dhe pejzashesh si monumente natyre, që janë pjesë e parkut natyror Korab-Korritnik dhe parkut kombëtar të Lurës. Në këtë territor ka një florë dhe faunë shumë të pasur ku gjenden më shumë se 138 lloje të rralla bimësh (bima e rralë autoktone tulipani i Korabit) dhe kafshë të rralla si Tigri i Ballkanit, Dhia e Egër, gjeli I egër dhe shumë shpendë të tjera të egër më e famshmia është shqiponja e Korabit.

Krahasimisht me rajonët fqinje të Kukësit, Tropojës, Lezhës, Shkodrës, Korcës, Permetit dhe zonën ndër-kufitare të Dibrës së Madhe dhe Rostushë-Mavrovë, turizmi malorë dhe ruralë në Dibër është më pak e zhvilluar se këto rajone. Më zonën e Dibrës ky turizëm është në hapat e para dhe shumë pak I promovuar dhe I mbështetur nga skemat e subvencioneve. Një ndikim negativ në mos-zhvillimin e turizmit ka luajtur dhe infrastruktura e dobët rrugore me Tiranën.

Vizitorët e paktë që vizitojnë janë turistët e huaj që vijnë kryesisht nga Evropa Perendimore dhe Qendrore si dhe Amerika e Veriut për periudha të shkurta prej 1-5 ditë. Një numër i konsiderueshëm i vizitorëve, sidomos ata një-ditorë, vijnë nga Tirana dhe Durrësi.

Nga bizneset vendase janë në fillesat e para investimet në ngritjen shtëpive pritëse për turistët dhe disa hotele të vogla.

	Tomin	Maqellarë	Melan	Kastriot	Silove	Kala e Dodës	Lurë	Arras	Muhurr	Selishte
Shpi pritëse	3	3	7	1	3	3	7	1	2	2

Tabela e shtëpive pritëse ne Turizmin malor (të dhëna nga këshilli i qarkut Dibër)

Vetëm në Lurë janë 2 hotele të rregulluara, ndërsa në komunat e tjera janë thjesht disa shtëpi pritëse, të cilat në të shumtën e rasteve janë të iniciuara nga agjensia lokale turistike KTT (Korabi Tracking Tour) që punon me agjensi turistike të huaja, kryesisht me turistë adhurues të zonës malore, studiues të florës dhe faunës, dhe turizmit të aventurës.

Promocioni për turizmin është në hapat e para, ku më seriozi është guida turistike, strategjia për vargamlin e Deshatit, dhe grupi i veprimt lokal “Dibra Turistike” që po promovojnë zhvillimin e turizmit malor dhe rural në Dibër. Faqja e internetit dhe shumë faqe sociale janë hapur nga organizata, institucione dhe individë që promovojnë vazhdimisht bukuritë dhe resurset e Dibrës.

*Rekomandimet:* Turizmi malor dhe rural në Dibër ka shumë mundësi për t’u zhvilluar, ku shumë shpejt mund të hapen rreth 500 shtëpi pritëse në gjithë territorin e Dibrës. Janë disa fshatra malorë që mund të kthehen në fshatra me profil turistik si në Maqellarë, Melan, Tomin, Kastriot, Silovë, Kala e Dodës, Lurë, Reç, Dardhë, Arras, Muhurr dhe Selishtë.

*Turizmi Historik dhe kulturor:* Dibra është një trevë shumë e njohur dhe e pasur për historinë dhe kulturën. Dibra është kufiri ndarës i katolicizmit dhe ortodoksisë, si dhe shumë rrënojave arkeologjike pak të zbuluara ku me e madhja është kalaja e Grezhdanit, e cila vetëm një pjesë

është e zbuluar nga gërmimet arkeologjike. Në zonën e Dibrës janë disa rrënoja arkeologjike që duhet të studiohen si të periudhës Ilire të fiseve të Deborëve dhe Penestëve, të periudhës së bizantit me shumë rrënoja kishash dhe manastiresh, dhe të periudhës së mesjetës otome me xhami, teqe dhe oxhaqe. Më i rëndësishmi potencial për zhvillimin e turizmit historik është vendlidja e heroit kombëtar Gjergj Kastrioti/Skënderbeu në Sinë, ku është kalaja e Kastriotëve dhe shumë vende dhe toponime që lidhen me periudhën e Skënderbeut.

Kultura dhe tradita e pasur e zonës së Dibrës krijojnë mundësi për Zhvillimin e turizmit Kulturor. doket, zakonet, kostumografia, lojrat popullore dhe ritet festive pagane dhe religjioze janë një thesar për Zhvillimin e Turizmit Kulturor. Oda Dibrane dhe alegoria e dibrës, kanuni i Dibrës që njihet si kanuni i Skënderbeut, kullat dhe shtëpitë e gurit, dasma dibrane, kostumet popullore janë disa nga elementët atraktivë për Turizmin Kulturor. Këtë turizëm e pasurojnë edhe më shumë monumentet e kulturës që janë në Dibër, muzeu historik në Peshkopi dhe muzeu i Kastriotëve në Sinë, pallati i kulturës “Haki Stërmilli”, dhe disa evente dhe festa të rëndësishme si “Oda Dibrane” që është një festival kombëtar folklorik që mbahet çdo vit, Festa e Shën Gjergjit (ditëlindja e Skënderbeut), dita e verës, festa e shën-kollit për Lurën dhe Selishtën, Festa e të Vjelave dita e panairit), Festa e Drinit, dhe shumë festa të tjera lokale dhe fetare, që mund të shfrytëzohen për pasurim të eventeve turistike të zonës së Dibrës.

Aktualisht mund të thuhet se vetëm festivali folklorik “Oda Dibrane” është një event më i rëndësishmi që promovon Turizmin Kulturor të zonës së Dibrës, dhe Festa e të Vjelave që promovon prodhimet tipike Dibrane.

*Rekomandohet:* Të identifikohen të gjitha vendet arkeologjike dhe të shënohen në sinjalistikën turistike të zonës. Të hartohet programi i festave dhe eventeve kryesore turistike vjetor për gjithë zonën e Dibrës. Të rehabilitohen muzeu i Peshkopisë dhe muzeu i Kastriotëve në Sinë, dhe të stimulohen ndërtimet e muzeve të tjerë si ai i etnografisë, dhe muze të tjerë lokalë.

**Anlaiza SWOT:**

<p><u>Pikat e Forta:</u>          Burimet e shumta Natyrore,          Ujërat termale të Llixhave;          Korabi (Mali më i lartë në Shqipëri)          Vargmali i Lurës me 23 liqene akullnajore;          24 monumentet e natyrës;           Vlerat e pasura historike,          Vendlindja e Skënderbeut;          Zbulimet arkeologjike në kalanë e Grezhdanit,          Kishat e Peshkopisë, Kalaja e Cetushit,          zbulimet arkeologjike në Cidhën,          Muzeu i Peshkopisë dhe i Sinës.          Tradita e pasur me doket dhe zakonet e lashta,          Oda Dibrane (folk festival dhe tarditë)</p>	<p><u>Pikat e dobëta:</u>          Infrastruktura rrugore dhe turistike e dobët dhe e largët me qendrat metropolitane,          Mungesa e shërbimeve turistike,          Mungesa e operatorëve turistike,          Kapacitete të ulëta njerëzore për shërbime turistike,          Cilësi e dobët e shërbimeve,          Mungesa e Investimeve në sektorin e turizmit (investime modeste) .          Dëmtimi i burimeve natyrore, mos-kujdesi për zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës,          Dëmtimi i monumenteve të kulturës, mos-kujdesi për zonat e historike dhe monumentet e kulturës,</p>
---	---

<p>Alegoria Dibrane Kanuni i 9-të Maleve, (Skënderbeut) Vallet dhe këngët popullore, (kala dibrance)</p> <p>Mikpritja dhe kulinaria dibrane, “mikut i takon kryet e vendit”, Guzhina e pasur (jufka me pulë, pula me arra, llallangia, fli me renda, sheqerpare, hallva me arra, etj)</p>	<p>Mungesa e promovimit turistik të zonës,</p>
<p><u>Mundësitë:</u> Turizmi si prioritet i politikave qeveritare, Prania e donatorëve me fokus të punës sektorin e turizmit, Përvoja e suksesshme rajonale (Alpet e Shqipërisë, Korca, Maqedoni, Kosovë), Orientimi i tregut për turizmin, Emigrantët dhe të larguarit dibranë që e vizitojnë Dibrën,</p>	<p><u>Kërcënimet:</u> Konkurrenca rajonale dhe e territoreve fqinje që kanë infrastrukturë më të mirë, Politika të gabuara dhe spontane të pa-bazuara në zgjidhjen e problemeve reale të turizmit (hapa të mëdha pa kaluar në hapa të vegjël) Pronësia e paqartë për pyjet, natyrën, dhe monumentet e natyrës, Korrupsioni.</p>

### **Rekomandimet:**

- Mbështetja dhe nxitja e zhvillimit të turizmit malor duke stimuluar hapjen e shtëpive pritëse, ku ekziston një kapacitet për 400-500 shtëpi pritëse në zonën e Dibrës.
- Stimulimi i pregaditjeve të paketave turistike, duke e bërë zonën një destinacion turistik, pjesë e paketave dhe tureve kombëtare dhe atyre rajonale (ndërkufitarë).
- Rritja e kapaciteteve të shërbimit turistik, me hapjen e kurseve profesionale (formale dhe informale) për guidat, guzhiniere, kamarriere dhe për personat që kanë shpëritëse.
- Promovimi i vlerave turistike të Dibrës, nëpërmjet krijimit dhe promovimit të programit të festave dhe eventeve si: Oda Dibrane, dita e Verës, Shën-Gjergji, Shën-Kolli, Festa e të Vjelave, etj.



## 5. Harta e Shërbimeve në Zonën Funktionale të Dibrës

### *Përshkrimi i përgjithshëm:*

Shërbimet publike në nivel lokal janë elementi më i rëndësishëm që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetesës së komuniteteve lokale dhe në mundësitë e zhvillimit social-ekonomik të zonës. Në zonën e Dibrës, pjesa më e madhe e shërbimeve ofrohet nga pushteti lokal (një bashki dhe 14 komunat) si dhe nga qeverisja qendrore nëpërmjet strukturave të saj rajonale në Dibër. Shërbimet bazë që janë dhe më jetike për qytetarët e Dibrës, dhe që ne po analizojmë në këtë studim janë: Uji i Pijshëm dhe sistemi i ujrave të ndotura, Rrugët, Menaxhimi i mbetjeve, Urbanistika dhe menaxhimi i tokës.

### **5.1 Uji i Pijshëm dhe Kanalizimet**

Spektori i Ujësijellës Kanalizime në Zonën Funktionale të Dibrës është një sektor shumë i rëndësishëm përmes të cilit sigurohet furnizimi me ujë të pijshëm dhe procesi i largimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura.

*Burimet Ujore:* Aktualisht sot prodhohet për furnizimin me ujë të pijshëm vetëm **12-15 m<sup>3</sup> /sek** ose afro 80 m<sup>3</sup> për person në vit në nivel kombëtar dhe ruhet dhe në zonën e Dibrës. Furnizimi me ujë bëhet kryesisht nëpërmjet përdorimit të ujrave të burimeve sipërfaqësore pa trajtim të veçantë për arsye se cilësia e tyre është brenda kushteve higjieno-sanitare të përcaktuara nga standartet e cilësisë së ujit të pijshëm, me karakteristikat fiziko-kimike të lejuara. Burimet kryesore të ujit të pijshëm që shfrytëzohen në zonën e Dibrës janë Burimi i Preshit dhe i Bjeshkës së Shehit në Korab, Sopanika në Arras, Lashkiza në Zall-Dardhë, Gura e Muhurit, Gura e Meres në Luzni, Burimet e Selishtës, Hinoska në Melan, burimet e Kërcinit në Maqellarë.

*Struktura menaxhuese:* Njësitë e Pushtetit Lokal janë Aktorët kryesorë në sektorin e Furnizimit me ujë dhe largimit e trajtimit të ujrave të ndotura, duke përbushur dhe detyrimin funksional sipas ligjit 8652 mbi organizimin dhe funksionet e Pushtetit Lokal. Të gjitha komunat dhe bashkitë e mbulojnë këtë shërbim nëpërmjet operatorit të UK, që është e vendosur në zyrën e shërbimeve në komuna dhe nga Ndërmarrja e Ujësijellës dhe Kanalizimeve të Peshkopisë që është SHA dhe administrohet nga Këshilli mbikqyrës i përbërë prej (6 Njësi vendore; Peshkopi, Kalaja e Dodes, Sllovë, Fushë Cidhen, Kastriot dhe Tomin, e cila siguron shërbimin për ujin e pijshëm për afro 48,000 banorët e këtyre NJQV-ve. Ndërmarrja e UK Peshkopi ka një personel prej 28 personash, që përbëhet nga stafi teknik i prodhimit, stafi i faturimit/shitjeve dhe administrata. Kompania ka asete me vlerë prej 53,454,000 Lekë, ku përfshihen 25km linjë e tubacionit kryesor, zyrat, makineri dhe pajisje, dhe një xhiro vjetore prej 25.000.000 leke buxhet vjetor, etj

Të dhëna të përgjithshme:

Tabela e mëposhtme jep të dhënat bazë të furnizimit dhe menaxhimit me ujë për secilën komunë, duke dhënë mbulimin e banorëve me këtë shërbim, llojin e linjës, tarifimin, % e arkëtuar dhe mbulimin me orë në ditë të shërbimit për banorë.


Njesia vendore	Mbulimi me ujë të pijshëm / Banorë	Mbulimi me ujë të pijshëm/Banorë	Lloji i linjës	Tarifa	% e mbledhur	Orë me ujë	Tipi i KUZ	% e mbulimit	%-mbulimit
Peshkopi	100%	0	UK I Korabit UK Luzninsë	27/85/65 leke/m3	80%	4-8	KZ	97	3
Maqëllarë	52%	48%	UK kërcinit Linja në nivel fshati Cezma publike	35 leke/m3	0	12	KZ + GS	46	54
Melan	100%	0	UK Hinorskës. Linja në nivel fshati Cezma publike	27 leke/m3	70%	16 24	KZ + GS	56	44
Tomin	51%	49%	UK Korabit UK i Luzninsë Linja fshati	27 leke/m3	60%	4-8 0 8-16	KZ + GS	30	70
Kastriot	78%	22%	UK Sopanikës UK korabit Linja fshati Cezma Publike	27 leke/m3	60%	12	GS	0	100
F.Cidhen	100	0	UK Sopanikës UK korabit	300 leke/familje/ muaj	0	16	GS	0	100
Sillove	87%	13%	UK korabit Linja fshati	27 leke/m3	0	4-8	GS	0	100
Kala e Dodës	70%	30%	UK I Kalasë Linja fshati		0	24	GS	0	100
Rec	0	100%	Linja fshati Cezma publike		0		GS	0	100
Lurë	0	100%	Linja fshati Cezma publike		0		GS	0	100
Arras	77%	13%	UK Sopanikës Linja fshati	28 leke/m3	15%	18	GS	19	81
Zall-Dardhe	30%	70%	Linja fshati	300 leke/familje/ muaj	0	24	GS	0	100
Muhurr	70%	30%	UK Muhurrit Linja fshati Cezma publike	300 leke/familje/ muaj	50%	18	GS	0	100
Selishte	100%	0	Linja fshati	27 leke/m3	60%	24	GS	0	100
Luzni	0	100%	UK Luznisë		0		GS	0	100
	61%	39%						16.5 %	83.5 %

Tabela me të dhënat për ujin e pijshëm për NJQV (burimi i të dhënave Këshilli I Qarkut)



Muhurrit, Arrasit kanë një % të konsiderushme të fshatrave që nuk kanë Ujësjellës.

	Peshkopi	Tomnin	Maqellarë	Melan	Kastriot	F. Cidhen	Sillove	Kala e Dodes	rec	Dardhe	Lure	Arras	Muhurr	Selishte	Luzni
% Mbulimi I territorit me FU	100	51	52	100	78	100	87	70	0	30	0	77	70	100	0



*Cilesia e ulët e Sherbimit te furnizimit me ujë të konsumatoreve;* Cilesia e Sherbimit te furnizimit me uje te konsumatoreve vazhdon te jete e dobet. Kjo konsiston ne mosfurnizimin e vazhdueshem te klienteve me uje te pijshem, ne mos sigurimin e presionit te duhur te ujit prane konsumatoreve, ne vonesat e riparimeve te difekteve te konstatuara, etj. Shumë pak linja ujësjellësish ofrojnë furnizim me ujë pa ndërprerje drejt konsumatorëve. Te tilla jane Selishta, Melani, Maqellara, kryesisht

disa linja të vogla në nivel lagje apo fshati, të cilat u sigurojnë banorëve të tyre 16-24 orë ujë. Ujësjellësat që rezultojnë më keq në këtë drejtim janë Ujësjellësi i Peshkopisë, i cili për momentin furnizon me pak se 4-8 ore ne ditë. Me investimin e bërë në burimin e Bjeshkës së Shehit në Korab dhe me investimin që ka nisur të bëhet nga KFW Gjermane mendohet që brenda 2 viteve, të ketë ujë nga 18-24 orë.

	Peshkopi	Tomnin	Maqellarë	Melan	Kastriot	F. Cidhen	Sillove	Kala e Dodes	rec	Dardhe	Lure	Arras	Muhurr	Selishte	Luzni
Koha e FU	4	4	12	18	12	16	8	24	0	24	0	18	18	24	0

*Performancë e dobët në administrimin dhe menaxhimin e ujit të pijshëm:* Në këtë gjendje ndikojnë një sërë faktorësh si ekonomik, teknik, social dhe menaxheriale. Por kryesisht po permendim disa me kryesorët që lidhen me performancën e administrimit sic jane: *Mungesa e planeve të menaxhimit të ujit të pijshëm dhe KUZ* ka ndikuar në performancën e ulët të ndërmarrjeve dhe sektorëve të ujësjellësve në menaxhimin e tyre pa kriter, jashtë standarteve tekniko-financiare dhe në rentabilitetin e strukturave menaxheriale. Mos kontrolli i burimeve të ujrave dhe *mungesa e një sistemi të klorifikimit* është rrezik për shëndetin e banorëve të Dibrës,

ku vetem 20% e sasisë së ujit i nënshtrohet testit të kontrollit të kushteve bakteoro-kimike të ujit në burim dhe pas klorifikimit të tij. *Nivel të ulët të arkëtimeve* kjo për shkak të mos faturimit si duhet të sasisë së ujit që harxhohet, dhe mungesës së një sistemi modern dhe të besueshëm faturimi dhe arkëtimi. Në të gjitha NJQV kemi mungesa të matësve në shumicën e lidhjeve dhe dëmtimi i atyre matësve në pikat që janë vendosur. *Kostoja e lartë e prodhimit dhe shërbimit të ujit të pijshëm* si mungesë e efikasitetit në menaxhimin dhe administrimin e këtij shërbimi, si pasojë e shpenzimeve të shumta dhe borxheve që I kanë ndërmarrjes së ujësjellësit klientët sidomos ato shtetërorë . E lartë është kostoja që zënë shpenzimet e personelit, të energjisë dhe amortizimit kanë peshën specifike më të lartë, kjo tregon që nuk ka racionalitet dhe efikasitet në menaxhimin e këtij shërbimi. Në ndërmarrjen e ujësjellësit të Peshkopisë janë 28 punonjës për 4000 lidhje, pra afërsisht 10 punonjës për 1000 lidhje. Edhe kostoja e amortizimit është e lartë, sidomos për Ujësjellësin e Peshkopisë që përdor linjat e vjetra të Ujësjellësit të viteve 80. Kjo ka bërë që shërbimi të bëhet me kosto të lartë. Kjo kosto e lartë ka bërë që ndërmarja e Ujësjellësit të jetë në vështirësi ekonomike, dhe të kërkojë subvencion nga qeveria qendrore apo donatore të tjerë. *Mungesa e Investimeve, apo investime të gabuara* ka bërë që të kemi zona që nuk kanë ujësjellës, ose të shkojmë në zgjidhje komunitare me linja ujësjellësish në bazë lagje dhe fshati pa përdorur kriteret teknike. Ka pasur raste të investimeve të gabuara si pasojë e zgjidhjeve teknike dhe menaxheriale të gabuara sic është rasti I ujësjellësit të Peshkopisë me burimet ujore nga lumi Drin dhe I ujësjellësit të Maqellarës me sistem pompimi po nga Lumi Drin, investime të cilat dështuan.

*Konfliktet sociale për çështjet e pronësisë,* e cila është bërë pengesë për investime dhe për realizimin e disa ujësjellësve, ku më i madhi është mos-funksionimi i ujësjellësit të Luznisë (i ndërtuar më 1997-1998) që është 15km dhe u shërben banorëve të 3 NJQV. Mungesa e aftësisë për zgjidhjen e konflikteve sociale, ligjore dhe të pronësisë ka bërë që shumë projekte apo investime të dështojnë apo mos fillojnë, sin ë Maqëllarë, Rabdisht, Erebarë, Kala e Dodës, etj.

### **Gjetjet:**

- Sistemi i ujit të pijshëm dhe KUZ është problematik në Dibër pasi ky shërbim nuk mbulon një pjesë të konsiderueshme të popullsisë 83.5 për KUZ dhe 39% me ujin e pijshëm.
- Cilësi e dobët e shërbimit, si në kohën e furnizimit më ujë ashtu dhe në shërbimin ndaj klientit. Mesatarisht në Dibër nuk ka më shumë se 4-8 orë ujë në ditë.
- Humbje të larta në rrjet, për shkak të amortizimit të tubacione, cilësisë së dobët së mirëmbajtjes, sistemit të gabuar të menaxhimin-shpërndarjes, dhe ndërhyrjeve ilegale në rrjet sidomos në periudhën e verës.
- Nivel i ulët i arkëtimeve kjo për shkak të mos faturimit si duhet të sasisë së ujit që harxhohet, dhe mungesës së një sistemi modern dhe të besueshëm faturimi dhe arkëtimi.
- Mungesa e matësve në shumicën e lidhjeve dhe dëmtimi I atyre matësve në pikat që janë vendosur, tregon për një keq-administrim të këtij procesi nga strukturat e NJQV dhe Ndërmarrjes së ujësjellësit në Peshkopi.
- Kostoja e lartë e prodhimit dhe shërbimit të ujit të pijshëm si mungesë e efikasitetit në menaxhimin dhe administrimin e këtij shërbimi, si pasojë e shpenzimeve të shumta dhe borxheve që I kanë ndërmarrjes së ujësjellësit klientët sidomos ato shtetërorë.

- Mungesa e Investimeve, apo investime të gabuara ka bërë që të kemi zona që nuk kanë ujësjellës, ose të shkojmë në zgjidhje komunitare me linja ujësjellësish në baze lagje dhe fshati pa përdorur kriteret teknike. Ka pasur raste të investimeve të gabuara si pasojë e zgjidhjeve teknike dhe menaxheriale të gabuara sic është rasti i ujësjellësit të Peshkopisë me burimet ujore nga lumi Drin dhe i ujësjellësit të Maqellarës me sistem pommi po nga Lumi Drin, investime të cilat dështuan.
- Konfliktualiteti i lartë social dhe për pronësinë është bërë pengesë për investime dhe për realizimin e disa ujësjellësve, ku më i madhi është mos-funksionimi i ujësjellësit të Luznisë (i ndërtuar më 1997-1998) që është 15km dhe u shërben banorëve të 3 NJQV. Mungesa e aftësisë për zgjidhjen e konflikteve sociale, ligjore dhe të pronësisë ka bërë që shumë projekte apo investime të dështojnë apo mos fillojnë.
- Mos kontrolli i burimeve të ujrave dhe mungesa e një sistemi të klorifikimit është rrezik për shëndetin e banorëve të Dibrës, ku vetëm 20% e sasisë së ujit i nënshtrohet testit të kontrollit të kushteve bakterio-kimike të ujit në burim dhe klorifikimit.
- Mungesa e planeve të menaxhimit të ujit të pijshëm dhe KUZ ka ndikuar në performancën e ulët të ndërmrjeve dhe sektorëve të ujësjellësve në menxhimit të tyre pa kriter, jashtë stantarteve tekniko-financiare dhe në rentabilitetin e e strukturave menaxheriale.

**Rekomandohet** që NJQV e ardhshme për zonën Funksionale të Dibrës të ndërmarrë një sërë masash si:

- Kryerja e një studimi fizibiliteti për sistemin e ujit të pijshëm dhe KUZ për gjithë territorin e Dibrës, dhe
- Hartimi i një plan-investimi afatshkurtër, afat-mesëm dhe afat-gjatë;
- Ndërhyrje emergjente me klorifikim dhe me kontrollin e përhershëm të kushteve bio-kimike të ujit të pijshëm për çdo ujësjellës, linjë ujësjellësi dhe çezma publike; Shtimi i investimeve për të ndërtuar linja ujësjellësi dhe KUZ në të gjitha zonat që mungon ky shërbim, dhe investime të tjera për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ujësjellësve ekzistues. Më prioritare janë investimet që duhet të bëhen në zonën e Luznisë, Reçit, Lurës që nuk mbulohen fare, si dhe në zonat e Tominit, Maqellarës dhe Slllovës që kanë sasi të pakta uji të pijshëm; Ngritja e një komiteti ndërmjetësues me përfaqësuesit e autoriteteve vendore (NJQV, Prokurori, Polici, Komunitet, etj) për zgjidhjen e konflikteve që lidhen me procesin e ujit të pijshëm dhe në veçanti për zgjidhjen e problemit të Ujësjellësit të Luznisë;
- Shfrytëzimi me efektivitet dhe efikasitet të investimit të KFW në ujësjellësin e Peshkopisë në aspektin teknik por dhe në aspektin e forcimit të strukturës menaxheriale me plane biznesi, manuale operimi-mirëmbajtje, sistemit modern të faturimit dhe arkëtimit, etj., model që duhet të jetë për menaxhimin e ujit të pijshëm dhe KUZ për zonën e Dibrës si njësi e ardhshme e Pushtetit Lokal;
- Inventarizimi dhe Dixhitalizimi i sistemit të ujësjellësve për gjithë zonën Funksionale të Dibrës; dhe
- Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese me publikun për të rritur ndërgjegjësimin në menaxhimin me efikasitet të ujit të pijshëm dhe pagesës së tarifave të ujit të pijshëm.


## 5.2 Rrugët dhe Transporti Publik

Sistemi rrugor për zonën funksionale të Dibrës, funksionon mbi bazën e tre kategorive kryesore rrugore që janë; Rrugë Kombetare, Rruge rajonale dhe rrugët lokale.

### 5.2.1 Aksesit për në zonën Funksionale të Dibrës.

**Rrugët kombëtare** janë arteriet kryesore që lidhin zonën funksionale të Dibrës me sistemin kombëtar të rrugëve. Këto rrugë janë:

*Rruga Tiranë-Peshkopi* ose më saktë itinerari, 186km që kalon nga Tirana, Milot, Burrel, Bulqizë, Maqellarë dhe Peshkopi, e cila është rruga/itinerari kryesore që lidh Peshkopinë me metropolin, Ajroportin “Nënë Terreza”, portin e Durrësit dhe me pikën kufitare të Bllatës me Maqedoninë 20km. Kjo rrugë është e asfaltuar, në kushte të këqija teknike, e ndërtuar në vitet 1950, jashtë standarteve teknike, në terren të vështirë dhe të rrezikshëm me ngjitje të lartë, kthesa dhe rrëshqitje, e mirëmbajtur keq, dhe ku kalojnë shumë makina të tonazheve të mëdha me krom të cilat nuk janë parashikuar për kapacitetin e kësaj rruge duke e dëmtuar rregullisht atë. Ky itinerar është më i keqi në Shqipëri, që zgjat më shumë se 5 orë udhëtim. Kjo gjendje e vështirë e aksesit të zonës përbën një vështirësi të madhe për shfrytëzimin e potencialeve dhe zhvillimin e zonës në përgjithësi për shkak të kostove shumë të larta të transportit.



Në foto:  
Me vizë të verdhë dhe pika të zeza (sipas shigjetës së verdhë) është aksi i Rrugës së Arbrit, sipas një posteri fillestar të shoqatës "Nisma Dibrane", 1996.  
Shigjeta blu tregon rrugën aktuale.

Ndërtimi i rrugës së Arbrit, një projekt që vijon prej vitesh nga Qeveria Shqiptare nga njëra anë shkurton ndjeshëm gjatësinë e rrugës, e rrjedhimisht kohën e koston e udhëtimit nga ZF për në Kryeqytet , Aeroport dhe Portin e Durrësit dhe nga ana tjetër për shkak të itinerarit më të shkurtër e të përshtatshëm do të intensifikojë lidhjet me Maqedoninë duke krijuar një korridor transporti ndërkombëtar me ndikimin përkatës në zhvillimin e zonës.

*Rruga Peshkopi – Kukës* me gjatësi 72 km që kalon nga Peshkopia, Kastriot, Kala e Dodës, Kukës duke e lidhur me aksin e “Rrugës së Kombit” dhe pikën kufitare të Morinit të Kosovës, ku


(36km janë në territorin e Dibrës), është e asfaltuar, në gjendje të mirë teknike, në terren të vështirë malor dhe me kthesa, që paraqet vështirësi kalimi në kohë me rreshje dëbore.

*Rruga Peshkopi –Kukës* më gjatësi 67 km (49 km ne territorin e Dibrës) që kalon nga Peshkopia, Muhurr, Rec, Kukës, është e pa-asfaltuar, në gjendje te keqe teknike, e mirëmbajtur keq, e vështirë për të kaluar, dhe pa mundur të kalohet me mjete të vogla.

Këto rrugë janë në inventarin e Ndërmarrjes Rajonale të Rrugëve, e cila është përgjegjëse për investimet, mirëmbatjen, pastrimin nga dherat dhe bora, etj. Ndërmarrja ka personelin e saj prej 30 administradë dhe 100 punëtorë, makineritë dhe ka kontraktuar 3 kompani (nga një për secilën rrugë) për mirëmbatjen dhe pastrimin e tyre.

Rrugët rajonale janë rrugët që lidhin më shumë se dy komuna ose disa fshatra. Këto rrugë janë në innvetarin e Ndërmarrjes së Rrugëve Rajonale që është në varësi të Këshillit të Qarku Dibër.

### 5.2.2. Transporti brenda ZF.



Zona Funktionale e Dibrës sipas studimit të mëhershëm të dldp është një zonë me tipare të forta koncentrike çka do të thotë se në përgjithësi ndërveprimet janë mes komunave aktuale dhe Peshkopisë, pak mes komunave me njëra-tjetrën i rëndësishëm është edhe komunikimi me zonën ndërkufitare të Maqedonisë. Peshkopia ka një komunikim intensive me zonat rurale me popullsi më të dendur rrotull saj si Tomin, Melan, Kastriot e Maqëllarë.

**Aksesi me Rrugët nacionale:** Shumica e qendrave te banuara lidhen me akset kryesore te rrugëve nacionale Peshkopi- Tirane ku janë komunat Maqëllarë, Melan që është aks rrugor i asfaltuar me gjatësi 23 km. Aksi rrugor Peshkopi – Kukës ku aksesohen komunat Tomin, Kastriot, Fushë-Cidhën, Slllove dhe Kala e Dodës, me gjatësi 36 km, i asfaltuar, dhe në gjendje të mirë. Aksi rrugor Peshkopi – Kukës, 49 km i pa-asfaltuar, në gjendje të vështirë dhe ku kanë akses komunat Tomin, Muhurr, Arras, Zall-Dardhë, dhe Rec.



	Tomini	Maqëllarë	Melan	Kastriot	F.Cidhen	Sillove	Kala e Dodes	Rec	Dardhe	Arras	Muhurr	Tipi RR	Gjedja
RR. Peshkopi - Tirane		24 km										Asf	OK
RR Peshkopi - Kukes				36 km								Asf	Mire
RR Peshkopi - Kukes								49 km				P-Asf	Keqe

**Akses me Rrugët rajonale** në zonën e Dibrës janë rrugët që lidhin qendrat e banuara në më shumë se dy komuna, por jo-gjithmonë ky kriter është i zbatuar. Gjerdja e rrugëve është e kalueshme, jo e mirë, kryesisht të shtruara me zhavorr dhe paraqesin vështirësi për kalim në Dimër. Rrugët rajonale në Zonën Funktionale të Dibrës janë:

Akset Rrugore	Gjatësia / Km	Tipi I rruges	Gjedja
Urta e Muhurrit-Urta Varoshit	29	Zhavor	E kalushme
Arras - Lurë	25	Zhavor	E keqe
Lure – Merkur/Perlat	12	Zhavor	E kalushme
Arras – Sete	3	Zhavor	E Kalushme
Rashnapoje - Brezhdan	3	Asfalt	E Mire
<b>Totali</b>	<b>72 km</b>		

Të dhëna nga Këshilli I Qarkut Dibër.

Rruga më e rëndësishme është aksi Rrugor Arras – Lurë e cila lidh Peshkopinë me parkun kombëtarë të Lurës, dhe ka një rëndësi për zhvillimin e turizmit malor, por është në gjendje jo të mirë.

Për këto rrugë kujdeset ndërmarrja e Rrugëve Rajonale të Qarkut Dibër, e cila ka një personel prej 30 personash administrate, makineritë dhe kontraktin për investime dhe mirëmatje kompani të liçensuara për këtë aktivitet.

**Akses me Rrugët lokale** janë rrugët që lidhin lagjet, fshatrat dhe bulevardet brenda territorit të NJQV-së. një pjesë e këtyre rrugëve janë të asfaltuara dhe një pjesë e tyre janë të pa-asfaltuara. Me të detajuara jepen në tabelë, për rrugët lokale inventari është më shumë sepse ato maten me qendrën e komunës, por në realitet në lidhje janë shumë herë më pak.

	Peshkopi	Tomini	Maqëllarë	Melan	Kastriot	F.Cidhen	Sillove	Kala e Dodes	Rec	Dardhe	Lure	Arras	Muhurr	Selishte	Luzni	Totali
RR.Asfal	17	14	18	10	20	3										82
Rr, P-asfaltuar	5	12	29	32	40	25	37	26	32	32	59	37	51	35	34	486
Rr	22	59	69	77	65	10	51	42	69	37	35	65	33	59	37	730



fikse ku pothuajse në cdo 20 minuta niset një furgon me orare që fillojnë nga ora 5:30 e mëngjesit deri në orën 15:00 të mbasdites.

#### 5.2.4 Menaxhimi dhe financimi i rrugëve/transportit

Rrugët nacionale janë në inventarin dhe në përgjegjësinë e Ndërmarrjes Rajonale të Rrugëve. Për tre akset rrugore në zonën e Dibrës janë kontraktuar 3 kompani për mirëmbajtjen e këtij aksi. Rrugët rajonale nacionale në zonën e Dibrës janë 109 km , nga të cilat 60 të asfaltuara dhe 49 të pa-asfaltuara. Këto rrugë janë në inventarin e Ndërmarrjes Rajonale të Rrugëve, e cila është përgjegjëse për investimet, mirëmbajtjen, pastrimin nga dherat dhe bora, etj.

Rrugët rajonale janë në inventarin e Ndërmarrjes së Rrugëve Rurale që është në varësi të Këshillit të Qarku Dibër. Në varësi të kësaj ndërmarrje për zonën e Dibrës janë gjithsej 72 km nga të cilat 3 km të asfaltuara dhe 69 km të pa-asfaltuara. Ndërmarrja e Rrugëve për zonën e Dibrës ka një buxhet prej 7.2 milion Leke, (afersisht 100 mijë leke per km) dhe janë të punësuar 36 punëtorë (1 punëtorë për 2km). Mbikqyren nga një supervizor i cili mbikqyrur 30 punëtorë. Mirëmbajtja është përgjithësisht e nivelit të mbajtjes së rrugëve të hapura në gjendja të kalueshme. Gjithashtu zhvillohet edhe mirëmbajtje periodike (p.sh riveshje e shtresave , riparime në vepra arti, apo vetëm pastrim kanalesh , tombinosh , hedhje cakulli) etj.

	Të asfaltuara/Km	Pa-asfaltuara/Km	Buxheti ne vit
Rrugë Nacionale	60	49	40,000,000
Rrugë Rajonale	3	69	7,200,000
Rruge lokale	82	486	12,000,000

Rrugët lokale janë në varësi të pushtetit lokal të cilat përgjigjen për mirëmbajtjen e tyre. Zakonisht vendoset një buxhet për mirëmbajtjen e rrugëve, por përdoren dhe fondet për emergjencat si shpenzimet për pastrimin e rrugëve gjatë dimrit. Këto zëra janë nën pjesën e investimeve në buxhetin e NJQV. Sipas NJQV ky është shpenzim për mirëmbajtjen e rrugëve.

NJQV	Peshkopi	Maqëllar	Melan	Tomina	Kastriot	FCidhen	Sillov	Kala	Rec	Dardh	Lur	Aras	Muhurr	Selishtë	Luzni	Totali
buxheti	2	1.4	750	1.4	1.4	680	600	400	600	580	780	1	900	1	500	12

Të dhëna nga NJQV (shifrat janë në milion dhe mijë)

Siç shihet dhe nga tabela, ka një shpërndarje të investimeve për mirëmbajtje të rrugëve tek të gjitha NJQV. Ai varet më shumë në fondet që kanë në dispozicion se në një përlllogaritje sipas normave teknike. Në të gjitha NJQV e zonës së Dibrës harxhohen 11,900,000 Leke për mirëmbajtjen e rrugëve lokale. Për 568 km rrugë lokale, mesatarisht harxhohet rreth 19,368 Lekë për km.

## **Gjetjet:**


- Zona e Dibrës ka një akses të vështirë e të kufizuar në rrjetet infrastrukturore kryesore të vendit përfshirë Kryeqytetin, Portet e Aeroportin. Megjithëse jo shumë km për të udhëtuar për në Dibër të duhen jo më pak se 5 orë udhëtim për të arritur në Peshkopi. Mungojnë investimet serioze në këtë aks rrugor, segmentet rrugore që kanë filluar ose përfunduar janë jo të projektuara mirë dhe jo në standarte teknike. Projekti në vijim i ndërtimit të rrugës së Arbrit i hap një mundësi shumë të rëndësishme zhvillimit të zonës në lidhje me aksesin shumë të shpejtë në tregjet kombëtare dhe rajonale.
- Pjesa qendrore e ZF Dibër (Peshkopia dhe komunat përreth) komunikojnë me një rrjet rrugor të asfaltuar së fundmi dhe relativisht në gjendje të mirë. Ky rrjet i shërben edhe prodhimtarisë bujqësore në zonë e transportit të produkteve. Asfaltimi i rrugës drejt Kukësit hap edhe perspektivën e zhvillimit të turizmit malor rreth malit të Korabit.
- Rrugët rajonale dhe lokale rurale (nga 25-40km) nuk janë në nivelin e duhur, sidomos rrugët që lidhin Peshkopinë me zonën turistike të Lurës, Recit, Selishtës, Zall-Dardhës, Arrasit duke krijuar kështu zona periferike të largëta, të pazhvilluara, të vështira për tu mbuluar me shërbime dhe të pa-kontrolluara nga dëmtuesit e pyjeve dhe florës e faunës në përgjithësi.
- Kapaciteti teknik dhe financiar për mirëmbajtje dhe investim në sistemin e rrugëve lokale është i dobët dhe i pa-përballueshëm nga buxhetet e Njësiqe Qeverisjes Vendore, kjo ndikon në gjendjen e keqe të këtyre rrugëve.
- Transporti publik në zonën e Dibrës me Tiranën bëhet vetëm me furgonë, sistem i rregulluar sipas standarteve, kushteve dhe procedurave të vendosura në Ministria e Linjës. Në çdo orar nga ora 5:30 deri në orën 15:00 mund të lëvizësh në këtë itinerar.
- Kushtet e transportit publik janë të pranueshme, por për transportin brenda zonës funksionale të Dibres paraqitet vështirësi në lëvizjen në Lurë që mungon fare (Lurë-Tiranë lëviz nga Kurbneshi), dhe ke mundësi lëvizje dy herë në ditë (vetëm 1 here vajtje – ardhje) për komunat Rec, Zall-Dardhë, Kala e Dodës, Sillovë, Selishtë, Arras.

## **Rekomandimet:**

- Ndërtimi I rrugës së “Arbrit” është I vetmi aks rrugor nacional që do të rregullonte infrastrukturën rrugore për zonën e Dibrës.
- Me zonën e re funksionale të Dibrës, duhet të krijohet një sektor i veçantë që të merret me mirëmbajtjen e rrugëve në gjithë territorin, ku janë përcaktuar standartet dhe normativat e duhura për mirëmbajtjen.
- Asfaltimi i rrugës Lurë-Arras-Kastriot-Peshkopi, do të nxiste zhvillimin e turizmit malor dhe historik pasi kalon në vendlindjen e Skënderbeut dhe parkun e Lurës.
- Hartimi i projekteve dhe gjetja e investimeve për Asfaltimin e rrugëve që lidhin fshatrat/qendrat e banuara me rrugët kryesore.
- Nxitja e sektorit privat të transportit për të shtuar orët e lëvizjes edhe pasdite në zonat periferike.

### 5.3 Menaxhimi i Mbetjeve

Menaxhimi I mbetjeve është një shërbim që ofrohet nga Njësitë e Qeverisjes vendore të cilat sipas ligjit 8652 për “Organizimin dhe Funkcionimin e Pushtetit lokal” janë përgjegjëse për ofrimin e një shërbimi të tillë. Mënyra e menaxhimit të mbetjeve në zonën e Dibrës ka ndryshime të dukshme mes sistemit të menaxhimit në zonat rurale që menaxhohen nga 14 Komuna dhe në qendrën urbane të Peshkopisë që menaxhohet nga Bashkia Peshkopi.



Në zonat rurale që janë nën-juridksionin administrativ të komunave ky shërbim pothuajse mungon fare, vetem disa komuna si Maqëllara, Melani, Tomini, Selishta, Muhurri kanë marrë disa masa elementare për menaxhimin e mbetjeve, por që nuk kanë një sistem menaxhimi por vetëm disa elementë të kujdesit të grumbullimit të mbetjeve. Shumica e mbetjeve në zonat rurale hidhen nga vetë banorët buzë përrenjve dhe lumenjve

duke ndotur mjedisin dhe rritur rrezikun që vjen nga ndotja e ujerave për mjedisin dhe ajrin.

Në tabelën e mëposhtme jepen të dhënat bazë të ciklit të menaxhimit të mbetjeve në zonën e Dibrës.

Njesia vendore	Mbetjet urbane (T)	Mbetjet inerte T	Sasite e mbetjeve te kompostuara / vit	% shtepive, tek te cilat ofrohet sherbimi	Numri i bizneseve tek te cilat ofrohet sherbimi	Numri i koshave;	Nr makineriv e/kamione	Vend depozitimi
Peshkopi	6300	2000	8300	100%	430	160	5 kamione, 1 traktore	Fushe depozitimi
Maqëllarë	2000	650	750	52%	80	nuk ka	1	Perroi Maqëllarës
Melan	530	60	325	70%	10	0	1	FD-Peshkopi
Tomini	1500	220	820	36%	34	0	1	FD-Peshkopi
Kastriot	1200	MI	0	0%	0	0	0	NA
F.Cidhen	400	MI	0	0%	0	0	0	NA
Sillove	350	MI	0	0%	6	0	1 traktore	Vend I percaktuar

Kala e Dodës	290	MI	0	0	0	0	0	Vend I percaktuar
Rec	110	MI	0	0	0	0	0	NA
Lurë	210	MI	0		0	0	0	NA
Arras	420	6	0	0	5	35	1 kamion-cine	FD-Peshkopi
Zall-Dardhe	150	MI	0	0	0	0	0	NA
Muhurr	380	MI	0	80%	6	2	1	Vend I percaktuar
Selishte	210	MI	0	57%	3	0	1	NA
Luzni	220	40	0	0	0	0	0	NA
	14160	2976	10195	26.3	574	197	8	


Tabela e ciklit te menaxhimit te mbetjeve (Burimi I të dhenave keshilli I Qarkut Diber)



*Mbulimi me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve*, Siç shikohet dhe nga tabela, vetem 26.3% e familjeve ne nivel te zonës funksionale mbulohe me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Këtu vetëm Bashkia Peshkopi që mbulon të gjitha familjet ndërsa komunat e tjera që kanë një % të lartë nuk është edhe shumë e sigurtë si

per shembull në komunën Muhurr dhe Selishtë.

*Sasia e mbetjeve* në zonën funksionale të Dibrës mendohet se janë rreth 17,136 ton mbetje ne vit, nga të cilat vetëm në Bashkinë e Peshkopisë janë 8,300 Ton në vit ose 49% e gjithë sasisë në nivel zone. Në nivel zone janë 47 ton mbeturina në ditë të cilat gjenerohen afërsisht 06kg mbeturina në ditë nga cdo person, ose 215 kg mbeturina për person në vit. Kjo shifër në bashki është më e lartë ajo varion tek 415kg mbeturina ne vit për cdo banorë. Po të shtohet që gjatë ditës në Peshkopi vijnë dhe shumë banorë nga zonat përreth dhe mbetjet që prodhohen nga bizneset dhe institucionet, qyteti i Peshkopisë shtohet sasia e mbetjeve me afer 30% me shumë në ditë, duke krijuar një situatë jo të mirë të pastërtisë në qytet. Shih ne figurën poshtë.



Vend depozitimi i mbetjeve, sic shikohet dhe nga tabela pjesa më e madhe e Njërive vendore nuk kanë pika për depozitimin e mbetjeve nga 15 NJQV 8 prej tyre nuk e ofrojnë këtë shërbim, dhe 3 Njësitë e tjera që e Ofrojnë përdorin fushën e depozitimit në Peshkopi, siç janë komunat Tomin, Melan dhe Arras, megjithëse nuk ka një marveshje të qartë dhe të saktë institucionale për këtë aksion (më shumë është leje gojore e drejtuesve). Komunat e tjera si e Maqellares, Selishtës, Sllovës dhe Muhurrit kanë një pikë depozitimi buzë lumit dhe përrrenjve, jashtë cdo kushti dhe standarti teknik. Fusha e depozitimit në Peshkopi është e ndërtuar në vitin 2003, është 2 km nga qyteti dhe është planifikuar të jetë për një periudhë 25-vjecare me një kapacitet deri në 1000 ton në muaj (33 ton në ditë), dhe nuk i përmbush kushtet e një landfill, duke pasur një kapacitet prej 40% më pak të planifikuar se realiteti. Djegia dhe filtrimi i ujërave nën-tokësore janë një burim i madh ndotjesh për banorët e zonës afër fushës së depozitimit dhe ujërat e përroit të Dohoshishtit.

Mbledhja dhe transporti i mbetjeve: Në zonat rurale të komunës Maqëllarë, Tomin, Melan, Arras, Selishtë, Muhurr dhe Sllovë nuk ka një proces të qartë të mbledhjes dhe grumbullimit të mbeturinave të cilat nuk kanë kosha ose pika grumbullimi por bëhet derë më derë në ditë të caktuar. Këto NJQV për transportin e mbeturinave kanë në pronësi të tyre nga një kamion (vetëm komuna Sllovë ka traktor) që bëjnë transportimin dhe 1 punëtor të punësuar për këtë shërbim.

Bashkia e Peshkopisë këtë proces si dhe të gjithë shërbimin e pastrimit e ofron nëpërmjet brigadës së pastrimit që është e vendosur pranë zyrës së shërbimit. Në qytet janë pikat e grumbullimit të mbetjeve të cilat janë vendosur në blloqe pallatesh gjithsej janë 160 kazana, ku hidhen mbetjet shtëpiake, mbetjet tregtare, dhe mbetjet industriale. Mbetjet spitalore kanë koshat e tyre pranë spitalit rajonal të Peshkopisë. Transporti i mbetjeve bëhet nga 5 makinat që janë pronë e bashkisë (4 janë në gjendje të mirë dhe 1 jashtë shërbimit) si dhe 1 traktor me zinxhir që është në fushën e depozitimit. Sipas të dhënave të ofruara nga personeli i Bashkisë Peshkopi, shërbimi i mbledhjes së mbeturinave i ofrohet të gjithë qytetarëve të saj. Pra Bashkia, me brigadën e pastrimit i ofron shërbimin bazë të mbledhjes dhe largimit të mbeturinave urbane 100% të banorëve të saj (të llogaritur si 5.000 familje me një total prej afërsisht 20.000 banorë) si

dhe 100% të bizneseve të rregjistruara (të deklaruara me një numër total prej 430 biznese por që në realitet janë 3 ose 4 here më shumë). Ky shërbim bëhet çdo ditë në oraret e mëngjesit.

Fshirja e rrugëve dhe gjelbërimi: ky shërbim ofrohet vetëm në Qytetin e Peshkopisë nga Bashkia. Ky proces shërbimi përmban fshirjen e rrugëve dhe rugicave të qytetit, mbledhjen e mbeturinave në sipërfaqen publike të qytetit, pastrimin e pusetave, mbledhjen e mbeturinave inerte, kujdesin për sipërfaqet e gjelbërta të lulishteve me punim-mbjellje-prerje dhe sistemin. Gjithashtu edhe ky shërbim është detyrë e brigadës së pastrim-gjelbërimit të bashkisë e cila ka të punësuar rreth 23 persona (fshirje dhe 14 për gjelbërim), si dhe ka detyrë edhe kujdesin për dekorin e qytetit.

Rickilimi: nuk kemi një proces të formalizuar të ricklimit të mbetjeve në zonën e Dibrës, si për mbetjet që janë organike dhe për mbetjet jo-organike. Në zonën e Dibrës si dhe në zonat e tjera kemi në mënyrë informale të mbledhjes së mbeturinave të riciklueshme (kryesisht kanace, plastikat, mbetjet e hekurit, kartonit dhe deri diku ato të qelqit) kryesisht nga ana e popullsisë rome ose egjiptiane.


Menaxhimi në aspektin e administrimit, planifikimit dhe financave: tabela e mëposhtme jep të detajuar procesin e menaxhimit njerëzor dhe financiarë të këtij shërbimi në Dibër.

Njesia vendore	Buxheti në ALL	Kap. arkëtues	Tarifa	% arkëtimi	Personeli	Plani menaxhimit	Bashkëpunimi
Peshkopi	19,128,000.00	6,200,000.00	1200/8000/10000/20000/50000	92%	51	Jo	Po (Melan, Tomin, Arras)
Maqëllarë	1,800,000.00	1,000,000.00	800/5000/7500/10000/12000	35%	2	Jo	Jo
Melan	1,500,000	260,000.00	700/3000	70%	1	Jo	Po
Tomin	900,000.00	-	-	0	1	Jo	PO
Kastriot	0	-	-	0		Jo	JO
Lurë	0	-	-	0		Jo	JO
Luzni	0	-	-	0		Jo	JO
Muhurr	820,000.00	588,240.00	1200 ne vit	60%	1	Jo	JO
Selishtë	360,000.00	157,800.00	200.00	0	1	Jo	JO
Sllovë	144,000.00	-	-	0	1	Jo	JO
Kala e Dodës	-	-	-	0		Jo	JO
Zall Dardhë				0		Jo	JO



	-	-	-				
Zall Reç	-	-	-	0		Jo	JO
Fushe Cidhen	-	-	-	0		Jo	JO
Arras	720,000.00		1200 leke ne vit per familje	0		Jo	PO
	25,392,000	8,206,040			58		

**Buxheti.** I vënë në dispozicion nga NJQV është 25,392,000 Leke dhe arkëtimi nga tarifat e pastrimit 8,206,040 Lekë ose 32.3 % e buxhetit që harxhohet për shërbimin e pastrimit dhe grumbullimit të mbetjeve.



Këto të ardhura kryesisht NJQV i grumbullojnë nga të ardhurat e tyre, kështu më shumë se 67.7% mbulohet nga buxheti I NJQV, I cili mund të ishte planifikuar për shërbime të tjera në territorin e NJQV-së. Në bashkinë Peshkopi harxhohet rreth 956 Leke për

banorë për këtë shërbim, ndërsa në zonën e Dibrës 317 leke për banorë në vit.

**Tarifa dhe arkëtimi:** me vendime të këshillave vendore janë përcaktuar tarifat për pastrimin. Bashkia Peshkopi ka lloje të ndryshme tarifash përsa i përket natyrës, si për familjarët, bizneset, firmat e mëdha etj., si dhe Komunat e Maqëllarës dhe Melanit. Ndërsa njësitë vendore të tjera kanë vetëm për familjarët e cila varion tek 1200 leke vit për familje. Norma e arkëtimit është e lartë në Peshkopi që arrin tek 92% kjo për arsye që bashkia përdor zyrat dhe shërbimet e tjera në bashki për vjeljen e kësaj tarife. Më e ulët është kjo në Arras e cila nuk e arkëton këtë tarifë dhe në Maqëllarë që është 35%, pasi administrata e komunës nuk përdor forma dhe mënyra të tjera për mbledhjen e tarifës. Të arkëtuara janë 32.3% e sasisë së buxhetit që harxhohet për këtë shërbim.

**Personeli dhe administrimi:** Në të gjitha NjQV-të menaxhimi i mbetjeve bëhet nga zyra e shërbimeve e cila është e ngarkuar për të ofruar këtë shërbim. Në 8 Komunat që ofrojnë këtë shërbim është i punësuar vetëm 1 person, i cili është përgjegjës për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve. Në bashkinë Peshkopi është një brigadë e posacme që merret me këtë proces. Janë gjithsej 61 të punësuar nga të cilët 10 janë në administratë, 6 për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve, 4 janë në fushën e depozitimit, 22 janë në pastrimin dhe fshirjen e rrugëve, 14 janë në gjelbërim dhe dekor. Pra sic shikohet janë 51 persona të punësuar për 20,000 banorë.

Planifikimi dhe bashkëpunimi ndërvendor: asnjë nga NJQV-të nuk ka plane menaxhimi për mbetjet në zonën e Dibrës. Edhe bashkia e Peshkopisë nuk ka një plan menaxhimi por ka një udhëzues e cila është vënë në dispozicion nga Ministria e Transportit dhe Punëve Publike, tek të cilat referohen për të mbajtur disa norma dhe standarte në procesin e planifikimit të buxhetit dhe organizimit të punës. Plane dhe rregullore të mirefillta për menaxhimin e mbetjeve nuk ka. Edhe për çështjen e bashkëpunimit vendor ndërmjet njësisë ekziston bashkëpunimi në realitet midis Bashkisë së Peshkopisë dhe komunave të Melanit, Tominit dhe Arrasit për të lejuar depozitim të mbetjeve të tyre në fushën e Bashkisë së Peshkopisë, por nuk është një marrëveshje e formalizuar dhe me bazë të saktë ligjore apo kuadër të qëndrueshëm institucionalë. Ky bashkëpunim është më shumë si pasojë e frymës dhe interesit të bashkëpunimit mes drejtuesve të NJQV-së sesa me bazë institucionale. Mungojnë fare aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe të bashkëpunimit me të për të përmirësuar cilësinë e këtij shërbimi.

### **Gjetjet:**

- Menaxhimi i mbetjeve në zonën e Dibrës kryhet në 8 NJQV por menaxhimin e mirëfilltë e kryen vetëm në Bashkinë e Peshkopisë, dhe ku një numër i konsiderueshëm i familjeve në Dibër nuk e marrin këtë shërbim, vetëm 23.6% e familjeve kanë akses në mbledhjen e mbeturinave.
- Sasia e mbeturinave në zonën e Dibrës është 14160 Ton mbetje urbane dhe 2976 Ton mbetje inerte, ose 2.4 kg mbeturina në ditë për çdo familje.
- Cilësia e ulët e nivelit të shërbimit të pastrimit në Dibër është për faktin që mungojnë koshat në shumë pika, cilësi e dobët e koshave dhe në ato pika që janë, dhe makineritë që përdoren për transport nuk janë për këte shërbim. Janë gjithsej 197 kosha/pika grumbullimi (1m3) dhe 8 kamione dhe 2 traktore për transportin e mbetjeve.
- Depozitimi i mbeturinave është një problem i madh pasi nuk ka vende të posaçme dhe me standarte për fushat e depozitimit të mbetjeve, ku vetëm bashkia e Peshkopisë ka një Fushe depozitimi jo me kritere teknike dhe ku depozitohen dhe mbeturinat e 3 njësisë të tjera, dhe ku mbeturinat digjen duke ndotur ajrin dhe ujërat që dalin nga kjo fushë ndotin përroit e Dohoshishtit. Në komunat e tjera ato hidhen buzë përrenjve dhe lumenjve, jashtë çdo standarti dhe kriteri. Fusha e depozitimit është ndërtuar në 2003 dhe ka qenë planifikuar për një kapacitet mujor prej 33Ton mbeturina dhe aktualisht depozitohen më shumë se 50 ton (45 ton vetëm Peshkopia) mbeturina në muaj.
- Menaxhimi i mbetjeve bëhet nga vetë NJQV të cilat kanë angazhuar brigadatat dhe personel që janë në strukturën e NJQV dhe janë gjithsej 58 persona.
- Kostoja e mbledhur nga tarifa e pastrimit mbulon vetëm 32.3% të buxhetit që harxhohet nga NJQV-të për këtë shërbim. Të gjitha NJQV harxhojnë pjesën më të madhe nga të ardhurat e tyre për të mbuluar këtë shërbim. Buxheti i harxhuar është 25,392,000 ALL dhe arkëtimi nga tarifa është 8,206,040 ALL.
- Kostoja e shpenzimit për një banorë është rreth 1587 ALL për çdo familje dhe arkëtohet nga çdo familje 513 ALL në vit. Ndërsa në bashkinë Peshkopi që mbulon 100% të familjeve kostoja është 3925 ALL.

- Mungojnë planet e menaxhimit të mbetjeve në të gjitha NJQV-të, të cilat për matjen e kostove dhe për të vendosur standarte u referohen modeleve të NJQV-ve tjera dhe udhëzuesve të Ministrisë.
- Bashkëpunimi mes NJQV-ve është prezent por jo i formalizuar dhe i institucionalizuar me kuadër ligjor dhe me standarte teknike të detajuara.
- Ndërgjegjësimi i publikut dhe bashkëpunimi me të është në nivele të ulta, dhe mungojnë hapat konkretë të nxitjes së këtij bashkëpunimi dhe ndërgjegjësimi.

### Rekomandime:

- Të hartohet plani I detajuar për menaxhimin e mbetjeve për zonen funksionale, I cili të parashikojë standartet e duhura teknike dhe të nxjerrë kostot reale të mbulimit të këtij shërbimi.
- Të rritet investimet për blerjen e koshave dhe makinave transportuese, me standarte teknike të pranueshme.
- Të rriten përpjekjet për ndërgjegjësimin e komunitetit, për të kontribuar në pastërtinë e zonës dhe në grumbullimin e mbetjeve në mënyrë të diferencuar.
- Të shtohen përpjekjet për të filluar me ndarjen dhe ricklimin e mbetjeve që tek qytetari deri tek fusha e depozitimit.
- Të ndërtohet një landfill I ri, sipas standareve teknike të duhura për gjithë zonën e Dibrës.
- Të përmirësohet menaxhimi i mbetjeve në fushën ekzistuese të depozitimit, duke eliminuar djegien e mbeturinave dhe një kujdes për ujërat që dalin nga kjo fushë, si dhe duke e rrethuar atë për të mos lejuar bagëtitë të shkojnë të ushqehen afër kësaj fushe.
- Të hartohen projekte teknike të vogla, të mesme dhe të mëdha për këtë sektorë që ti paraprijnë një fushatë studimi dhe njohje të situatës aktuale dhe mobilizimit të fondeve për zbatimin e tyre nga donatorë të dnryshëm.

### Skenari i mundshëm:



*Skenari 1:* Ndërtimi i një Fushe grumbullimi mbetjesh në zonën e Dibrës, në përroin e Kabe, afër Kubenit me një distancë prej 6 km nga qyteti I Peshkopisë. Kjo pikë do të ndërtohet sipas standarteve teknike dhe do të shërbeje për bahskinë e peshkopisë dhe 12 Njësi të tjera aktuale. Në të nuk janë përfshirë komunat e Lurës dhe të Selishtës që janë shumë larg dhe në një territor të shpërndarë. Për këto mendohet të ndërtohen pika stacionare.

#### 5.4 Planifikimi Urban; Menaxhimi i tokës

Zona e Dibrës ashtu si e gjithë Shqipëria pas vitit 1990 u përball më një lëvizje të madhe demografike e cila përfitoi nga lëvizja e lirë e lëvizjes për të udhëtuar jashtë vendit dhe në territore të tjera brenda vendit, duke ju larguar krizave ekonomike dhe politike. Kjo bëri që të kemi një migrim dhe emigrim të madh të popullsisë nga zona e Dibrës, me një popullsi prej 99,368 banorë në 1989 në 82,000 banorë në 2013, afërsisht një lëvizje prej 20.7%.

Dallga e migracionit, në dukje kaotike dhe spontane, ka reflektuar kundërveprimin e natyrshëm dhe praktik të popullsisë drejt gjeografisë së re të mundësive, duke u larguar nga zonat rurale drejt qendrave urbane dhe metropllitane, ku mundësitë ekonomike (sipërmarrje, vende pune, shkëmbime tregtare, tregje, etj) ishin më të larta dhe cilësia e shërbimeve bazë (arsim, shëndetësi, transport, informim, etj) është më e mirë. Shumica e Dibranëve lëvizën për në Tiranë dhe Durrës, por një pjesë e madhe ka lëvizë edhe drejt qendrës urbane të Peshkopisë, e cila në vitin 1989 kishte një popullsi prej 10,000 banorësh dhe sot ka afro 20,000 banorë.

Përpos këtyre avantazheve që përmendëm më sipër, kjo lëvizje u shoqërua dhe më një sërë disavantazhesh ekonomike më të zakonshme në zona me përqëndrim të madh urban, si psh. trafiku rrugor i rënduar, çmimi i lartë i tokës, ndotja e mjedisit, krimi dhe humbja e hapësirave të gjelbërta (karakteristikë për qytetin e Peshkopisë), nuk janë parë të paevitueshme, sepse shpesh vërtetohet se ato janë pasojë e neglizhencës së politikave dhe investimeve të duhura. Me gjithë këto problem, sot e gjykojmë më mirë që kjo lëvizje nuk mund të bëhej me asnjë program, pasi do të ishte e dështuar dhe e vonuar.

Zgjerimi i gjeografisë së mundësive ekonomike, pas procesit epik të urbanizimit qëndron një transformim i plotë strukturor i ekonomisë, duke ju larguar marredhënieve ekonomike dhe industriale tradicionale, dhe i orientuar drejt sektorëve më tepër produktivë. Kështu aktivitetet tregtare dhe shërbimet, lulëzuan si pasojë e grumbullimeve urbane në Qytetin e Peshkopisë, dhe buzë rrugëve nacionale (zona e Maqëllarës, Melanit dhe Tomini) por që u shoqërua me ndërtime të shumta në sipërfaqet e lira në qytet dhe perreth tij. Kjo u shoqërua me ndërtime të reja për banim në zonat që më parë ishin industriale, ushtarake dhe ndërmarrje bujqësore, si dhe në zonën përreth kompleksit të llixhave, të cilat u përshtatën dhe për biznes në fushën e turizmit kurativ. Gjithashtu mungesa e sipërfaqeve të banimit 5m<sup>2</sup> për banorë, ose 42m<sup>2</sup> për një apartament, bëri që në qytetin e Peshkopisë të kishim shumë kërkesa për zgjerimin e sipërfaqeve të apartamenteve ekzistuese duke bërë që të kishim shumë shtesa pallatesh. Kjo mënyrë ndërtimi ishte e pa-planifikuar por ndikoi pozitivisht në Zhvillimin e sektorit të ndërtimit, në numrin e madh të ndërtesave të reja, në rritjen e vlerës së pronësisë dhe në shtimin e sipërfaqeve të banimit dhe kushteve të jetesës.

Procesi i Urbanizimit në Dibër ka kaluar nëpër tre faza të ndryshme që prej rënies së komunizmit. Faza e parë u dominua nga sektori informal. Faza e dytë u karakterizua nga konsolidimi I sektorit informal dhe shfaqja e sektorit formal. Faza e tretë dhe ekzistuese konsiston në forcimin e sektorit formal dhe rregullimin e zhvillimeve informale. Objektivi

kryesor i qeverisë gjatë fazës së tretë do të ishte legalizimi dhe integrimi i tregut të pasurive të patundshme.

Qeveritë Vendore kanë qenë autoriteti përgjegjës për rregullimin e territorit dhe planifikimin urban. Ndryshimet e shumta ligjore mbi urbanistikën kanë bërë që të krijohen pa-qartësi në zbatimin e ligjit dhe të kopetencave. Të 15 Njësite Vendore në zonën e Dibrës nuk kanë plane urbane të hartuara dhe të aprovuara. Ka pasur studime pjesore për zona të caktuara për plan urban të mirefilltë nuk ka pasur asnjë njësi vendore. Vetëm më bashkinë e Peshkopisë ka pasur një përpjekje e financuar nga SNV në vitin 2001 për të hartuar një plan urban, por ai nuk u finalizua dhe nuk u miratua pasi ndryshuan dhe baza dhe kriteret ligjore, ku kërkohej mbrotja dhe miratimi i tij në KRTRSH.

Struktura përgjegjëse për planifikim urban janë zyrat e urbanistikës në Njësitë vendore të cilat kanë mundësitë të kenë një zyrë të tillë. Në shumë Njësi vendore për mungesë të kapaciteteve kjo kopetencë ka qenë e deleguar në këshillin e Qarkut e cila ka zyrën e Urbanistikës që ka për qëllim ndjekë zbatimin e aprovimet e lejeve të ndërtimit në përmbushje me standartet dhe kriteret ligjore dhe teknike të miratuara me ligj dhe amendamente. Gjithsej 13 NJQV e kanë deleguar këtë kompetence në qark, vetëm kalja e Dodës ka pasur KRT e saj. Bashkia e Peshkopisë ka zyrën e saj të urbanistikës dhe këshillin e Rregullimit të territorit. Bashkia po punon dhe për hartimin e planit urban të territorit të saj.

Procesi i legalizimit ka vazhduar dhe në zonën e Dibrës. Akoma nuk kemi shifra të sakta por vetëm për bashkinë e Peshkopisë janë 2932 kërkesa dhe janë aprovuar 122 leje nga ALUIZMI në Dibër. AUIZMI ka dhe hartën në GIS për gjithë territorin e qendrave urbane të zonës së Dibrës, dhe po vazhdon punën për inventarizmin e saktë të ndërtimeve informale, dhe procesin e legalizimit të tyre.

Menaxhimi i tokës është një tjetër çështje e rëndësishme në zonën e Dibrës, ku përvec qendrave të banuara në 141 fshtat dhe në qytetin e Peshkopisë që janë brenda vijës së verdhë dhe quhen troje, pjesa tjetër është tokë arrë fushë, kodrina që kryesisht janë më pemtore, pyjet dhe kullotat. Në Dibër janë dy parqet kryesore, parku Kombëtarë I Lurës me sipërfaqe 1200 ha që është në kategorinë e dytë sipas IUCN, dhe parku natyrorë I Korab-Korritnik me sipërfaqe 20 663 ha që është në kategorinë V (pese) sipas IUNCN, e cila quhet pejsazh natyror I mbrojtur, dhe është I ndarë në 3 nënzona. I) *Nënzona qendrore*, në zonën e Dibrës 1 621.0 (një mijë e gjashtëqind e njëzet e një) ha, që përfshin habitatet kryesore pyjore dhe përcaktohet si zonë me vlera të larta për trashëgiminë natyrore e biodiversitetin dhe në të zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, që siguron një territor të pashqetësuar. Në këtë nënzona lejohen kërkimi shkencor, zhvillimi i veprimtarive eko-turistike të lira në natyrë si dhe kullotja sezonale. Ii) *Nënzona e përdorimit tradicional*, me sipërfaqe në zonën e Dibrës 17,734.5 (shtatëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër pikë pesë) ha, që tërësisht tokat bujqësore, pyjet e kullotat, ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive tradicionale, si bujqësi, pyje, kullotja, grumbullimi i bimëve mjekësore e aromatike, me përdorim të balancuar të tyre dhe nuk lejohen ndërtimet e veprimtaritë që shkaktojnë ndryshimin e gjendjes natyrore të ekosistemit. Iii) *Nënzona e zhvillimit të*

*qëndrueshëm*, me sipërfaqe 1572.0 (një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy pikë zero) ha, nga të cilat në zonën e Dibrës 1 307.9 (një mijë e treqind e shtatë pikë nëntë) ha, që përfshin territoret urbane dhe trojet e përziera me tokë bujqësore e pyjore pranë qendrave të banuara dhe veprimtaritë përgjatë lumenjve, përfshirë edhe ujërat termale. Në zona mundëson vazhdimin e veprimtarive ekonomike, sociale e të agrobiznesit të qëndrueshëm dhe përdorim të balancuar të peizazhit e të burimeve natyrore, si dhe shtimin e drurëve arrorë, lajthive, gështenjave e të bimëve mjekësore dhe aromatike. Në territorin e zonës së Dibrës dallohet për monumente të shumta natyre (48 monumente) qofshin këto gjeo-monumente, hidro-monumente apo bio-monumente. Për vlerat e tyre të veçanta historike, estetike, turistike, biologjike janë një numër I madh objektesh dhe peisazhesh të shpallura si monumente natyre. Megjithëse janë këto zona të mbrojtura akom nuk kemi struktura të posacme për menaxhimin dhe administrimin e tyre, dhe ku roli I pushtetit lokal është I pa-qartë dhe pa asnjë influencë. Këto zona të mbrojtura akoma janë në varësi të drejtorive të pyjeve e cila nuk është në gjendje të menaxhojë dhe administrojë siç duhet këto zona.

Energjia është një nga çështjet e tjera influencuese në zonën e Dibrës. Energjia elektrike është burimi kryesorë që përdoret për ndricim dhe gatim për pjesën 7 mujore të vitit. Për ngrohje dhe gatim për pjesën 4 ose 5 mujore përdoren drutë e zjarrit që sigurohen nga pyjet e lartë dhe ato komunale. Mungesa e efencës në përdorim pa kriter të energjisë ngrohëse ka bërë që të harxhohet shumë energji dhe përfitimi të jetë i vogël. Kështu çdo familje harxhon 8-12m<sup>3</sup> dru zjarri në vit, e cila shkon për ngrohjen e një hapësire banimi prej 60m<sup>3</sup>, kur vëllimi e një banese është 240m<sup>3</sup> pra për të njëjtën njësi harxhohet me shumë se 4 herë më shumë. Gjithashtu dhe teknologjia e ndërtimit të banesave nuk ka qene teknikisht në favor të kursimit të energjisë.

#### **Gjetjet:**

- Mungesa e planeve urbane në të gjitha NJQV e zonës së Dibrës, dhe të planeve rajonale urbane.
- Procesi i legalizimit po vazhdon me ngadalësi, dhe akoma qytetarët nuk e kanë të qartë dhe të besueshëm këtë proces, pasi akoma nuk ka vazhduar procesi i dhënies së certifikatave.
- Pushteti lokal nuk ka një proces të qartë dhe të vazhdueshëm për monitorimin e cmimit të pasurive të paluajtshme (tokës, trojeve dhe banesave) dhe forcën e duhur mbi kontrollin, ndërhyrjen dhe menaxhimin sic duhet të territorit.
- Kapacitetet njerëzore dhe teknike nuk janë në nivelin e duhur që tu përgjigjen me cilësi kërkesave të qytetarëve dhe standarteve të lejuara teknike.
- Zonat e mbrojtura janë në letra, por mungojnë strukturat, kompetencat, procedurat dhe masat koordinuese për mbrojtjen, administrimin e tyre, ku qeveria lokale ka një rol kryesor.
- Nuk ekzistojnë programe, projekte dhe fushata sensibilizuese për përdorim me efencë të energjisë.

## **Rekomandimet:**

- Të përshejtohet procesi i legalizimit, me moton cdo ndërtim i ri të jetë i formalizuar, dhe ku pronarët të marrin titujt e pronësisë.
- Të hartohet plani rregullator (plani i përdorimit të tokës) duke përfshirë dhe planin e ndarjes së zonave, i cili të jetë një dokument i thjeshtë i përgaditur me diskutim të gjerë publik, me standarte teknike, i thjeshtë t'u kuptuar dhe të jetë i zbatueshëm.
- Plani rregullues të hartohet i thjeshtë dhe i zbatueshëm duke mos u bazuar në modelin e prishjes së objekteve të ndërtuara, por të jetë një proces stimulus i dinamikës së ndërtimit duke përmbushur nevojat dhe dëshirat e qytetarëve.
- Njësia e ardhshme e pushtetit lokal duhet të kontrollojë dhe monitorojë rregullisht çmimet e tokës dhe banesave duke krijuar një proces të qartë të regjistrimit dhe shitje-blejeve të aseteve dhe pasurive.
- Të punohet për kualifikimin e specialistëve që punojnë në sektorin e administradës publike për çështjet urbane, duke i trajnuar dhe specializuar me njohuritë përkatëse teknike dhe profesionale të planifikuesit urban.
- Të krijohet strukturat e menaxhimit të zonave të mbrojtura ku përfaqësuesit e NJQV-së së re të jenë aktivë në këtë strukturë dhe të bashkëpunojnë me dikasterin përkatës të specialistëve të zonave të mbrojtura.
- Të mbështetën programe, projekte dhe nisma që promovojnë energjinë e rinovueshme dhe teknikat e përdorimit me efikasitet të energjisë, duke krijuar bashkëpunime të strukturuar me iniciativat që vijnë nga sektori privat dhe shoqëria civile.

## 6. Organizimi i shërbimeve të qeverisjes lokale në zonë

### 6.1 Shërbimet kryesore që ofrohen nga NJQV-të dhe shpërndarja e tyre

Bazuar në ligjin 8652 “mbi organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Vendorë në Shqipëri”, NJQV kryejnë këto funksione kryesore në zonën tyre që lidhen me: i) Infrastrukturën dhe shërbimet publike; ii) shërbimet me karakter social, sportiv dhe kulturor; iii) zhvillimet me karakter ekonomik vendor; dhe, iv) mbrotja e sigurisë civile.

*Në fushën e infrastrukturës dhe të shërbimeve publike*, NJQV janë përgjegjëse për: a) furnizimi me ujë të pijshëm; b) funksionimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të bardha, të ujërave të zeza dhe kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara; c) ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve me karakter vendor, trotuareve dhe shesheve publike; ç) ndriçimi i mjediseve publike; d) funksionimi i transportit publik urban; dh) administrimi i varrezave dhe garantimi i shërbimit të varrimit; e) shërbimi i dekorit; ë) administrimi i parqeve, lulishteve dhe zonave të gjelbëruara publike; f) grumbullimi, largimi dhe përpunimi i mbeturinave; g) planifikimi urban, menaxhimi i tokës dhe strehimi sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

	Peshkopi	Tomina	Maqëllarë	Melan	Kastriot	F. Cidhen	Silove	Kala e Dodes	rec	Dardhe	Lure	Arras	Muhurr	Seliste	Luzni
Uji Pij	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
KUZ	x	x	x	x											
Rruge+Sheshe	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Ndricimi rrugor	x		x												
Transporti Publik	x														
Mirëmbajtja e varrezave	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Dekori	x														
Park-Lulishte	x														
Mg Mbetjeve	x	x	x	x			x					x	x		
Plani Urban, strehimi	x														

Siç shikohet dhe nga tabela NQV-të mbulojnë më shumë shërbimet që lidhen me Ujin e Pijshëm, mirëmbajtjen e Rrugëve, trotuareve dhe shesheve si dhe varrezat (që në të shumtën e rasteve është



shërbim që është deleguar tek këshillat e fshatit në nivelin komunal). Karakteristikë tjetër është që NJQV-të në zonat rurale nuk e mbulojnë një pjesë të madhe të shërbimeve sic janë parqe dhe Lulishtet, Ndricimi Rrugor, dekorin dhe Planifikimin urban dhe strehimin, të cilat janë shërbime që mbulohen nga bashkia Peshkopi. Megjithëse në bashki kujdesen për sipërfaqet e gjelbërta dhe parqe, duhet të theksohet që shumë lulishte mes blloqeve të pallateve janë të dëmtuara dhe në Peshkopi mungojnë parqet dhe këndet e lojrave megjithëse ka ambjente për parqe në zonën e Llixhave.

*Shërbimet me karakter social, kulturor e sportiv*, që mbulojnë a) Ruajtja dhe zhvillimi i vlerave kulturore dhe historike vendore, organizimi I veprimtarive dhe administrimi i institucioneve përkatëse; b) organizimi i veprimtarive sportive, çlodhëse e argëtuese dhe administrimi I institucioneve përkatëse; c) shërbimi social dhe administrimi i institucioneve si çerdhet, azilet, shtëpitë e fëmijëve, etj. Sipas mbulimit të këtij shërbimi nga NJQV jepet në tabelën e mëposhtme:

NJQV	Peshkopi	Tomin	Maqëllarë	Melan	Kastriot	F.Cidhen	Silove	Kala e Dodes	rec	Dardhe	Lure	Arras	Muhurr	Selishte	Luzni
Institucionet Kulturore-Historike	x											x			
Clodhje dhe ambjente sportive	x														
Cerdhe, azilet, shtëpi fëmijesh	x														

Siç shikohet dhe nga tabela vetem Bashkia Peshkopi ka institucione dhe personelin që ofron shërbimet. Kështu në peshkopi është pallati I kulturës “Haki Stërmilli”, Muzeu, Klubi I sportit “Korabi” me ambjentet sportive te tilla si stadium I futbollit, pallati I lojrave me dorë, dhe një rrjet cerdhesh për fëmijë (4) në cdo lagje të qytetit. Vetëm në komunën e Arrasit në fshatin Sinë që është vendlindja e Skënderbeut është muzeu I Kastriotëve.

*Zhvillimi ekonomik vendor*. Ky shërbim lidhet me: a) përgatitja e programeve të zhvillimit ekonomik vendor; b) ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë; c) zhvillimi i biznesit të vogël, si dhe zhvillimi i veprimtarive nxitëse si panaire e reklamanë vende publike; ç) organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor si informacioni, struktura dhe infrastruktura e nevojshme; d) shërbimi veterinar; dh) ruajtja dhe zhvillimi i pyjeve, kullotave e burimeve natyrore me karakter vendor.

	Peshkopi	Tomina	Maqëllarë	Melan	Kastriot	F.Cidhen	Silove	Kala e Dodes	rec	Dardhe	Lure	Arras	Muhurr	Selishte	Luzni
Plane dhe programe	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Tregjet Publike	x														
Panaire, reklama etj	x														
Sherbime mbeshetese	x														
Sherbimi veterinar	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Pyjet dhe kullotat komunale	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x

Siç shikohet nga tabela, hartimi I planeve dhe programeve të zhvillimit ekonomik vendor pothuajse është në çdo NJQV, por këto plane nuk janë specifike vetëm për Zhvillimin ekonomik, por janë pjesë e planeve startegjike të zhvillimit. Gjithashtu Shërbimi veterinar dhe pyjet dhe kullotat në nivel komunal u janë transferuar NJQV. Të gjitha NJQV kanë një person përgjegjës në stafin e tyre që mbulojnë këto shërbime.

Përsa u përket shërbimeve të tjera që lidhen me Tregjet Publike, zhvillimi i biznesit të vogël, si dhe zhvillimi i veprimtarive nxitëse si panaire e reklama në vende publike dhe organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor si informacioni, struktura dhe infrastruktura e nevojshme, ofrohet vetëm nga Bashkia Peshkopia në të cilën janë ambjentet e tregut bujqësorë, tregut industrial dhe tregut javor. Gjithashtu në Peshkopi është edhe zyra e Informacionit Turistik dhe programim zhvillimit që merret me dhënien e informacionit si dhe Bashkia ka hapur faqen e internetit dhe organizon festivalin e Odës dibrane dhe Panairin me “festen e të Vjelave” për promovimin e vlerave dhe produkteve tipike të zonës së Dibrës.

Rendi dhe mbrojtja civile: a) ruajtja e rendit publik për parandalimin e shkeljeve administrative dhe garantimi i zbatimit të akteve të komunës ose bashkisë; b) mbrojtja civile.

	Peshkopi	Tomina	Maqëllarë	Melan	Kastriot	F.Cidhen	Silove	Kala e Dodes	rec	Dardhe	Lure	Arras	Muhurr	Selishte	Luzni
Ruatja e rendit	x	x	x	x											
Mbrojtja civile	x														

Ky shërbim ofrohet nga policia bashkiake/komunale që janë struktura të ngritura pranë NJQV-ve. Bashkia Peshkopi ka një strukturë të organizuar për këtë qëllim me 5 staf, ndërsa Komunitat e Maqallarës, Melanit dhe Tominit kanë nga 2 punonjës që merren dhe me mbledhjen e taksës lokale. Në NJQV-të e tjera ky shërbim mungon.

NJQV-të në zonën e Dibrës karakterizohen nga një model i ngjashëm për ofrimin e këtyre shërbimeve ku komunitat që janë në zonën rurale kanë të njëjtën gamë në dhënien e shërbimeve. Kështu në komunita struktura përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve është zyra e shërbimeve që ka të punësuar individë të cilët në përshkrimin e detyrave mbulojnë shërbime të ndryshme.

Në Bashki situata është më ndryshe pasi shumë departamente janë përgjegjëse për shërbimet, dhe ku zyra e shërbimeve është përgjegjëse kryesore për infrastrukturën dhe shërbimet publike. Skuadra të vecanta merren me pastrimin, gjelbërimin dhe dekorin. Zyra e veterinarisë është më vete dhe merret me kontrollin e ushqimit dhe thertoret (publike dhe private). Shumë shërbime kanë ndërmarrje më vete si për kulturën, sportin dhe kopshtet dhe cerdhet. Tregjet, informimi turistik, QKR dhe taksat lokale janë një departament më vete. Gjithashtu bashkia ka dhe policinë bashkiake që përgjigjet për rendin dhe mbrotjen civile.

#### **Gjetjet:**

- Shumë NJQV në zonat rurale nuk ofrojnë më shumë se 70% të shërbimeve që janë në ligjin e Pushtetit lokal. Shërbimet sociale, sporti, kultura, lulishtet, parqet dhe sheshet, në masën 100% në nivelin e komunave nuk ofrohen fare.
- Shërbimet që lidhen më zhvillimin ekonomik lokal, pothuajse nuk ofrohen fare, vetëm në Peshkopi kemi tregje publike dhe asgjë tjetër në lidhje më mbështetjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.
- Parqet, lulishtet dhe sipërfaqet e gjelbërta mungojnë fare ose janë në gjendje të dëmtuar.
- Transporti publik, është kaotik dhe mungojnë vend parkimet dhe stacionet në vende të posacme.
- Ambjentet sportive në zonat rurale mungojnë krejtësisht. Gjithahstu edhe ambjentet dhe shërbimet që kujdesen për traditën, kulturën sidomos në krahinat të vecanta me rëndësi kulturore mungojnë plotësisht.

#### **Rekomandime:**

- Të bëhen studime dhe projekte për rivitalizimin e qendrës urbane të qytetit të Peshkopisë dhe qendra të tjera në zonën rurale duke ruajtur karakteristikat e zonës.
- Të rehabilitohen lulishtet në qytet dhe të investohet për krijimin e parkut në zonën e Llixhave.
- Të krijohen qendra rekreative dhe sportive në qendrat kryesore rurale.
- Të nxitet programe dhe projekte që të ndërtojnë qendra komunitare dhe rurale që nxisin zhvillimin e komunitetit në aspektin social-kulturor dhe ekonomik.


## 6.2 Organizimi vendor dhe struktura e personelit

Pothuajse të gjitha NJQV paraqesin strukturën e organizimit të administratës në Këshillin vendor. Administratat janë të organizuara mbi bazë zyrash ose seksione, ku cdo zyrë ose seksion mund të ketë disa funksione, dhe personeli I përgjigjet detyrës funksionale të atij pozicioni. Në tabelën e mëposhtme është organizimi I vendorë në zonën e Dibrës.

	Peshkopi	Tomini	Maqellarë	Melan	Kastriot	F. Cidhen	Silove	Kala e Dodes	rec	Dardhe	Lure	Arras	Muhur	Seishte	Luzni
Kabineti kryetarit	7	3	3	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
Burimet Njerzore	3	1	1	1	1										
Kultura, arsim, komunikim.	3	1	1	1	1	1	1					1	1		
Financa dhe buxheti	5	3	3	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
Programim zhvillim	3														
Urbanistika	3														
Shërbimet dhe mjedisi	3	5	5	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3
Insp. Ndertimi	2														
Administrimi I pronave	3														
Të ardhurat lokale	3		2	1									1		
Shëndetsia/bujqësi dhe kontrolli ushqimit	3	1	3	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
Ndihma ekonomike	5	3	3	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
Auditi I brenshem	2														
Policia vendore	8	2	2	1											
Sektorët mbështetës dhe ndihmës	25	2	1	1	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
Shërbimet komunale, Pastrim gjelberim	61														
Cerdhe, konvikte	68														
Drejtorja e Sportit	13														
Drejtorja e Kultures	25														
Gjendja civile	2	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
QKR	2														
<b>Totali</b>	<b>249</b>	<b>22</b>	<b>22</b>	<b>16</b>	<b>16</b>	<b>16</b>	<b>18</b>	<b>15</b>	<b>15</b>	<b>15</b>	<b>15</b>	<b>16</b>	<b>16</b>	<b>15</b>	<b>15</b>

Sic shikohet nga tabela janë gjithsej 481 punonjës që punojnë në administratën e NJQV në zonën e Dibrës, për 15 NJQV. Për bazë janë marrë seksionet dhe drejtoritë në Bashkinë Peshkopi, e cila ka shume seksione pasi mbulon dhe shumë shërbime publike sic janë çerdhet, konviktet, sporti, kultura, muzeu, biblioteka, etj., dhe ku janë të punësuar 249 punonjës ose 51.7% e administratës lokale në nivel zone funksionale.

Në zonat rurale, në seksionin/zyrën e kontrollit ushqimor dhe veterinar që është në bashki, në komuna kemi edhe stafin përgjegjës për bujqësinë, dhe ku janë të punësuar rreth 232 punonjës, ose 38.2% në nivel të zonës funksionale. Shih në figurën më poshtë.



Zyrat dhe godinat e NJQV janë vendosur në qendrat e banuara. Në përgjithësi zyrat janë në kushte optimale për punën e administratës së NJQV, ku më moderne janë zyrat e bashkisë Peshkopi. Specifike për NJQV e zonës së Dibrës është që komuna e Maqellarës nuk ka zyra të saj, ajo I mban ambjentet me qera.

NJQV në Dibër kanë qenë të angazhuara dhe të hapura për të stimuluar dhe mbështetur zhvillimin e kapaciteteve të stafit të tyre. Kështu ata kanë qenë aktivë dhe të hapur me bashkëpunimin me NGO dhe projekte të cilat kanë në fokus zhvillimin e kapaciteteve. Një pozicionim të mirë në zonën e Dibrës kanë me projekte World Vision, AgritraVizion, CNVP, ANTTARC, USAID, dhe disa organizata dhe projekte të Komisionit European me fondet cross-border, dhe SIDA për fonde në zhvillimin rural dhe mjedisit.

### 6.3 Buxhetet e Njësive Vendore

Buxhetet e NJQV-ve në përgjithësi vijnë nga të ardhurat që grumbullohen nga vetë NJQV-të, trasferta nga Ministria e Financave dhe fondi I investimeve që sigurohet për projekte të vecanta nga donatorët, programet dhe qeveria qendrore.

Sipas NJQV-ve për zonën funksionale të Dibrës buxhetet janë si më poshtë”

	Peshkopi	Tomim	Maqëllarë	Melan	Kastriot	F.Cidhen	Sillove	Kala e Dodes	rec	Dardhe	Lure	Arras	Muhur	Selishte	Luzni	Totali
Viti 2013	100	23	32	15	19	10	13	12	6	6	13	13	12	11	10	302
Viti 2014	102	23	33	16	19	10	13	12	6	6	13	13	12	12	10	306
Viti 2015	107	10	15	7	8	4	6	5	2	3	6	6	5	5	4	200
Ta ardhurat 2014	55.8	4.5	3.7	2.5	4.7	3.1	0.5	2.1	2.9	1.8	0.4	3	0.8	1.9	0.4	88.7
Investimet																

Tabela e buxheteve te NJQV (Burimi zyra e thesarit në Dibër)

Sic shihet dhe nga tabela për vitin 2015 është përgjysmuar buxheti I NJQV-ve kjo dhe për faktin e zgjedhjeve të këtij viti. Por në dy vitet e para (2013-14) trendi ka qenë I njëjtë për buxhetet e NJQV-ve pavarësisht se kanë qenë buxhete me qeveri të ndryshme qendrore. Sic shikohet nga tabela komunat Rec, Dardhë, Luzni, F.Cidhën, Selishtë janë që kanë buxhetet më të vogla, dhe buxhetin më të madh e ka bashkia Peshkopi. Nëse e masim për frymë në zonën funksionale të Dibrës është 4000 Lekë për banorë.

Pjesa më e madhe e NJQV që janë të kategorisë së parë (mbi 10,000 banorë), të kategorisë së dytë (mbi 5000 banorë) dhe kategoria e trete (më pak se 5000 banorë).

Buxhetet vjetore dhe të mesme me ligj duhet të hartohen nga NJQV, të cilat në praktikën e tyre I kanë ato, por nuk mund të thuhet se janë të institucionalizuara. Gjithmonë për referencë meret buxheti normal vjetor.

#### 6.4 Strategjitë lokale të zhvillimit

NJQV në zonën e Dibrës kanë zbatuar proceset e hartimit të planeve lokale të zhvillimit për periudhën 2008-2013, në kuadër të programit të mbështetur nga Ambasada Hollandeze dhe SNV për “Forcimin e qeverisjes lokale në qarkun e Dibrës”, dhe të gjitha NJQV përfituan nga procesi I hartimit të planeve strategjike. Ndërsa bashkia Peshkopi ka planin e rishikuar për periudhën 2013-2018, mbështetur nga Ministria e Jashtme Hollandeze dhe zbatuar nga FLAG.

	Peshkopi	Tomim	Maqëllarë	Melan	Kastriot	F.Cidhen	Silove	Kala e Dodes	rec	Dardhe	Lure	Arras	Muhurr	Selishte	Luzni
Planet strategjike 2008-2013	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Rishikim plani. 20013-2018	x														
Bashkëpunim ndër-vendorë															

Tabela e planeve strategjike per NJQV (burimi Këshilli i qarkut Dibër)

Sic shikohet të gjitha NJQV-të kanë plane strategjike, por një pjesë e tyre janë në përfundim. Këto plane janë hartuar më mbështetjen e Programit të Fuqizimit të Qeverisjes Lokale ne qarkun e Dibrës, financuar nga Ministria e Jashtme Hollandeze. Plane ndërmjet Njësive vendore nuk kemi.

## 7. Vizioni i Zonës Funktionale Dibër

Motoja e hartuar nga Forumi i ZF të Dibrës është: *“Ne do ta bëjmë Dibrën një zonë të begatë për të jetuar, punuar dhe vizituar”.*

*“Dibra miqësore”* është sllogani për ZF. Pse miqësorë? Sepse në Dibër thuhet që të jesh miqësor duhet: të kesh, të dish, të presësh e përcjellësh, dhe të shërbesh. Dibra dhe dibranët i plotësojnë këto kushte.

*Vizioni është që në vitin 2030, Dibra dhe dibranët do të kenë një zhvillim të qëndrueshëm, të begatë, të sigurtë, të shëndetshëm dhe të prekshëm nga të gjithë. Banorët e Dibrës nga gjitha anët dhe shtresat do të kenë të siguruar akses të plotë me shërbime publike, mundësi të rritura punësimi dhe kushte cilësore banimi. Atraksionet e shumta natyrore dhe historike do të jenë shfrytëzuar me efikasitet të plotë duke lulëzuar ekonominë agrare, bizneset dhe qendrat turistike.*

Cështjet kyçe kryesore ku bazohet zhvillimi i zonës së Dibrës janë cështjet që lidhen me:

- Zhvillimit *ekonomik*,
- Zhvillimin e *zonës urbane (qytetin e Peshkopisë)*,
- Zhvillimi i *zonës Rurale (fshatrave të Dibrës)*,
- Për një *komunitet të qëndrueshëm* ,dhe,
- Përmirësimin e *mjedisit*.

Dibra do të punojë të mbajë në nivele të ulta papunësinë, duke rritur në një gamë sa më të gjerë numrin e të punësuarve në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, duke stimuluar investimet e mëdha vendase dhe të huaja sidomos në sektorin e pasurive natyrore dhe energjitikës, dhe duke rritur ndërveprimin ekonomik reciprok midis dy rajoneve fqinje dhe ndërkufitare.

Sektorët prioritarë për Zhvillimin ekonomik të zonës së Dibrës mbeten Bujqësia dhe Turizmi. Në Bujqësi prioritet është shtimi i sipërfaqeve të mbjella me pemtari, rritja e numrit të krrerëve të blektorisë dhe përmirësimi i racor duke shtuar sasinë e prodhimit për treg. Rritja e sasisë së prodhimit kërkon që të zhvillohet i gjithë zinxhiri i vlerës së këtij sektori duke stimuluar agro-përpunimin, grumbullimin, dhe promovuar markën “Prodhime Dibrane” në tregun vendas dhe të huaj, nxitja e bashkëpunimit mes fermerëve për të krijuar kooperativa dhe grupe prodhuese si struktura eficiente për Zhvillimin ekonomik agrar si dhe shtimi i investimeve nga NJQV dhe qeveria për infrastrukturën bujqësore (kanale vaditës, rrugë, makineri bujqësore), kontrollin ushqimor (pika grumbullimi dhe kontrolli) dhe lehtësira të tjera.

Turizmi është sektori i dytë prioritar i cili aktualisht sjell të ardhura të konsiderueshme të zonës së Dibrës, nëpërmjet Turizmit Kurativ. Shtimi i sezonit turistik dhe përmirësimi i shërbimit do të shtojnë numrin e pushuesve dhe në këtë sektor Turizmi. Gjithashtu për zonën e Dibrës do të shtohen përpjekjet për nxitjen e zhvillimit të turizmit rural duke shfrytëzuar pasuritë e shumta natyrore. Pa nënvlerësuar cështjet e tjera, këto janë cështjet më kryesore të identifikuara gjatë kësaj faze studimi.



## 8. Projektet kryesore për zhvillimin e Zonës Funktionale

Programi i Zonës Funktionale u bë konkret nëpërmjet identifikimit dhe përgatitjes të një sërë projekt idesh që konsiderohen prioritare për zonën funksionale. Këto projekt ide u diskutuan edhe në forumin e zonës funksionale dhe janë të grupuara si më poshtë:

### 8.1 Projektet me fokus zhvillimin ekonomik të zones funksionale

Projektet me fokus zhvillimin ekonomik të ZF dhe të rëna dakord në forumin e saj janë:

*Projekti 1:*

<b>Titulli i projektit</b>	<i>Certifikimi I prodhimeve me markën “Prodhime Dibre”.</i>
<b>Tipi i projektit</b>	<i>Zhvillim ekonomik</i>
<b>Vendndodhja e projektit</b>	<i>ZF Dibër</i>
<b>Buxheti total i paravlerësuar</b>	<i>765,000 Euro</i>

#### 1. Sfondi dhe analiza e problemit.

Dibra është e njohur për prodhimet e saj në mbarë Shqipërinë si për frutat, prodhimet blektorale, jufkat, patatet, aroret dhe kulinarinë tipike dibrane. Megjithë imazhin pozitiv të prodhimeve dibrane, dalja në treg e prodhuesve dibrane është e vështirë kjo për një sërë faktorësh si infrastruktura e keqe dhe largësia nga tregjet kryesore, fragmentarizimi I prodhimit që çon në sasi të ulëta prodhimi, mungesa e zinxhirit të plotë të produktit, mungesa e markave dhe certifikatave të origjinës që lë shteg për spekulime në treg dhe shitja e produkteve të tjera si produkte dibre, duke bërë që të prishet imazhi pozitiv që kanë prodhimet e dibrës.

Shtimi I investimeve në Dibër nga vetë dibranët ka bërë që të shtohet gama dhe sasia e prodhimit, por nevoja për tregje tani është bërë më emergjente, dhe dalja në tregun vendas (Tiranë, Durrës, etj) kërkon patjetër një marketim më të mirë dhe një normë të lartë sigurie për sa I përket origjinës së prodhimit, gjë që sigurohet nga marka dhe çertifikata e origjinës. Gjithashtu shumë e nevosjhme është dhe krijimi I pikave të grumbullimit, që lehtëson daljen e prodhimit në treg dhe lehtëson prodhuesin duke sjellë më afër tij grumbullimin.

Fragmentarizmi i lartë i tokës dhe prodhimit, shton nevojën e rritjes së bashkëpunimit mes fermerëve, por fryma e bashkëpunimit për të krijuar grupe prodhuesish dhe Shoqata të Bashkimit Bujqësor (SHBB) është e vështirë, pasi kjo kërkon kapacitete, lehtësim të procesit dhe qartësimin e tij.

Janë disa eksperiencia positive në çertifikimin e produkteve dibrane si në formë individuale dhe për grupe prodhuesish, që kanë dhënë rezultat dhe që shtojnë nevojën që kjo eksperiencë të ngrihet në një standart më të lartë duke bërë markimin dhe çertifikimin e gjithë produkteve të zonës së Dibrës, të cilën më mirë se NJQV që do të mbulojë gjithë territorin e Dibrës nuk mund ta bëjë kush. NJQV e Dibrës ka përgjegjësinë institucionale për të aplikuar pranë institucionit përkatës në nivel qëndror për tu pajisur me logon dhe markën “Prodhime Dibrane”, si dhe kapacitetin institucional për të pajisur prodhuesit të cilët do të aplikojnë pranë bashkisë për tu pajisur me këtë certifikatë, duke stimuluar kështu prodhimin dhe kontrolluar sigurinë e origjinës dhe cilësisë së prodhimit.

## 2. Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)

**Objektivi i përgjithshëm:** Rritja e të ardhurave të familjeve dibrane nëpërmjet rritjes së sasisë së prodhimit dhe qasjes në treg me markë të sigurtë dhe të promovuar.

**Objektivi specifik 1:** Sigurimi i çertifikimit të markës “Prodhime Dibrane” nga NJQV e zonës funksionale sipas rregullave dhe procedurave ligjore branda viti 2016.

**Objektivi specifik 2:** Nxitja e shtimit të prodhimit nëpërmjet agregimit të prodhimit dhe krijimit të strukturave si pika grumbullimi, grupe prodhuese dhe shoqëri të bashkuara bujqësore brenda vitit 2019.

## 3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit(maks. 5-6 rreshta)

**Rezultati I pritshëm 1:** Bashkia e Dibrës ka marrë dakordësinë e prodhuesve dibranë për të pasur një logo dhe një markë të përbashkët “Prodhime Dibre”.

**Rezultati I pritshëm 2:** Bashkia e Dibrës ka siguruar markën “Prodhime Dibre” dhe ka të instaluar praktikën e marrjes së saj nga prodhuesit dhe institucionin përkatës në bashki.

**Rezultati I pritshëm 3:** Rreth 4 Pika grumbullimi janë të ngritura për prodhimet bujqësore dhe blektorale në zonën e Dibrës.

**Rezultati I pritshëm 4:** Në zonën e Dibrës janë ngritur 3 SHBB dhe 4 grupe prodhuese.

## 4. Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)

Nr	Aktivitetet	Periudha kohore								
		Viti I			Viti II			Viti III		
	<b>Marka “Prodhime Dibre”</b>									
1	Diskutim dhe dakordësi me prodhuesit									
2	Pregaditja e dosjes së aplikimit, dhe aplikimi.									
3	Marrja e markës									
4	Institucionalizimi I procesit të aplikimit për prodhuesit në bashki. Ngritja e strukturës së Bujqësisë në bashki.									
	<b>Ngritja e pikave grumbulluse dhe grupeve prodhuese</b>									
1	Identifikimi i aktorëve dhe zonave potenciale për të ngritur pika grumbullimi									
2	Mbështetje për krijimin e 4 pikave grumbulluese (2 në Peshkopi, 1 Maqellarë, 1 Kastriot).									
3	Ngritja e 4 grupeve prodhuese të bulmetit, konservim/frutave të thata, punimeve artizanale, shpendët.									

5	Mbështetje për grupet pilote prodhuese me pajisje/krerë, etj.									
	<b>Ngritja e SHBB</b>									
1	Fushatë ndërgjegjësimi me fermerët për ligjin e SHBB									
2	Cikël sesionesh instruktuse për organizimin, funksionimin dhe menaxhimin e SHBB									
3	Krijim i 3 modeleve pilote të SHBB në Dibër									

### 5. Pjekuria e projektit (5-6 lines)

Në zonën e Dibrës janë disa eksperiencë pozitive për krijimin e grupeve prodhuese, dhe për procesin e çertifikimit dhe markimit. Kanë punuar shumë në këtë drejtim AgritraVizion, IDM, ADAD me projekte të EU dhe donatorë të tjerë. Gjithashtu Drejtoria e Bujqësisë ka mbështetur dhe me financime krijimin e disa pikave grumbulluese, sidomos me magazina frigoriferike. Krijimi i markës dhe pikave të grumbullimit ka qenë prioritet i strategjisë së Qarkut, dhe ka dalë si rekomandim dhe nga studimi i FAP. Ka studime të pjeshme dhe normative, por akoma janë projekt-ide, ose projekte të OJF-ve ose bizneseve te veçanta.

### 6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)

Partneri kryesorë në projekt është bashkia e Dibrës, si aktori përgjegjës dhe më i formalizuar. Ky projekt kërkon bashkëpunimin e OJF e cila mund të bëjë menaxhimin e procesit dhe ofrojë ekspertizën e duhur, si dhe Drejtoria e Bujqësisë, Programi danez për bujqësinë nëpërmjet GIZ, IPARD, dhe skemat e subvencionit në Ministrinë e Bujqësisë.

### 7. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)

Kostoja e projektit: 765,000 Euro

Kostoja e marrjes së markës "Prodhime Dibre": 5,000 Euro

Kostoja e pikave të grumbullimit: 240,000 Euro

Kostoja e grupeve prodhuese: 80,000 Euro

Kostoja e SHBB: 240,000 Euro

Kostoja e zhvillimit të kapaciteteve dhe menaxhimit të projektit: 200,000 Euro

## Projekti 2:

<b>Titulli i projektit</b>	<i>Festat Dibrane</i>
<b>Tipi i projektit</b>	<i>Zhvillim ekonomik</i>
<b>Vendndodhja e projektit</b>	<i>Zona Funksionale Dibër</i>
<b>Buxheti total i paravlerësuar</b>	<i>200,000 Euro</i>

### 1. Sfondi dhe analiza e problemit.

Zona e Dibrës është e pasur me resurse natyrore, historike, tradicionale për zhvillimin e Turizmit. Deri më sot shumë pak është bërë për promovimin dhe nxitjen e turizmit, ku mungojnë aktivitetet festive që nxisin dhe promovojnë vlerat kulturore, historike, bukuritë e natyrës dhe turizmin në tërësi.

Janë disa festa dhe evente të rëndësishme tradicionale në Dibër që nxisin zhvillimin e turizmit por ato janë sporadike, të pa-organizuara, jo-profesionale dhe të mbetura në dëshirë dhe inisiativë të disa individëve apo organizatave të cilat janë pjesë e pasionit apo programeve që ato kanë. Përmendim këtu festivalin e “Odës Dibrane” që është event i folklorik më i madhi me pjesëmarrje nga e gjithë treva shqiptare, “Festa e të Vjelave” ku organizohet panairi i prodhimeve dibrane, festat popullore si “Dita e Verës”, “Shën Gjergji”, “Shën Kollu që festohet në Lurë dhe Selishtë”, “Festa e Drinit” etj.

Edhe pse janë të pa-organizuara mirë, pa dekor, të pa promovuara, pa ndonjë strukturim programacioni dhe aktivitetesh, gjatë këtyre festave ka shumë lëvizje dhe ato janë tipike për komunitetin dhe zonën e Dibrës, duke ruajtur vlerat tradicionale që në kohët pagane dhe deri me sot. Edhe nga studimi i FAP për zonën e Dibrës, në pjesën e analizës së zhvillimit të Turizmit, organizimi i eventeve festive është një prioritet i dalë nga diskutimet me grupet fokus dhe me Forumin.

### 2. Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)

**Objektivi i përgjithshëm:** Rritja e të ardhurave të familjeve Dibrane nga Turizmi.

**Objektivi specifik:** Promovimi dhe nxitja e zhvillimit të turizmit në Dibër nëpërmjet mbështetjes dhe organizimit të festave tradicionale dibrane, duke promovuar dhe krijuar programin vjetor të festave duke filluar nga viti 2015 dhe në vazhdim.

### 3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit(maks. 5-6 rreshta)

**Rezultati i pritshëm 1:** Bashkia e Dibrës ka një strukturë të ngritur dhe të institucionalizuar për organizimin e festave.

**Rezultati i pritshëm 2:** Të paktën 8000 vizitorë ndjekin çdo vit festat tradicionale të Dibrës, të organizuara nga Bashkia e cila ka vënë në dispozicion burimet njerëzore të duhura, logjistikën e duhur, marketingun e duhur dhe ka krijuar kushtet që çdo gjë të jetë e programuar me evente të larmishme.

#### 4. Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)

Nr	Aktivitetet	Periudha kohore (muaj)											
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
1	Ngritja e strukturës												
2	Organizimi I ditës së Verës												
3	Organizimi I shëngjergjit në të gjithë dibrën, por Qendra në Arras-Sinë.												
4	Organizimi I festës së Shënkollit në Lurë dhe Selishtë												
5	Organizimi I festës së Drinit në gjithë territorin e lumit, por Qendra në Muhurr.												
6	Organizimi I festës së Maleve/bjeshkëve në cdo territor më bjeshkë, por Qendra të jetë në Kala të Dodës												
8	Organizimi I festës së të vjelave në Peshkopi.												
9	Festivali I Odës Dibrane												

#### 5. Pjekuria e projektit (5-6 lines)

Projekti është në fazën e projek-idesë. Organizimi I festave është pjesë e strukturës dhe traditave të disa njësive vendore, si për shembull Oda Dibrane është pjesë e qendrës së Kulturës “Haki Stërmilli”, Bashkia Peshkopi. Festa e Drinit ka qenë organizuar nga komuna Muhurr dhe Festave e të vjelave inisiativë e shoqatave dhe Drejtorisë së Bujqësisë. Bashkia është përgjegjëse për organizimin e këtyre eventeve dhe do të bashkëpunojë ngushtë me OJF dhe sektorin privat.

#### 6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)

Burimet e financimit do të gjenerohen nga buxheti I bashkisë, si dhe për festa të ndryshme mund të angazhohen dhe aktorë dhe sponsor të ndryshëm si OJF që kanë programe ne Dibër, Drejtoria e Bujqësisë dhe bankat apo biznese që janë të interesuara për sponsorship.

#### 7. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)

Për cdo organizim feste nevojiten 5000 Euro, pra janë 7 festa x 5000Euro = 35,000 Euro. Festivali I Odës Dibrane 15,000 Euro, dhe kosto totale 50,000 Euro për organizimin e festave.

### Projekti 3:

<b>Titulli i projektit</b>	<i>Qendra profesionale "Mjeshtria Dibrane".</i>
<b>Tipi i projektit</b>	<i>Zhvillim ekonomik</i>
<b>Vendndodhja e projektit</b>	<i>Peshkopi, përfitues janë të gjitha NJQV-të e zonës funksionale</i>
<b>Buxheti total i paravlerësuar</b>	<i>1,400,000 Euro</i>

#### 1. Sfondi dhe analiza e problemit

**Problematika:** Akses i ulët në tregun e punës dhe forcë punëtore e pakualifikuar në Zonën Funksionale Diber

Zona funksionale e Dibrës është nga zonat më të varfëra dhe me numrin më të lartë të papunësisë në Shqipëri. Shumica e popullsisë kryesisht në zonën rurale dhe atë urbane trajtohen me ndihmë ekonomike. Popullsia e aftë për punë në treguesin e moshës është në 53% të popullsisë së përgjithshme në zonë.

Në zonën e Dibrës struktura e punësimit bazohet në sektorin e bujqësisë dhe sektori privat janë sektorët kryesorë që mbajnë peshën e punësimit në vitet e fundit, dhe punësimi në këtë sektor vazhdon të dominojë. Të dhënat tregojnë se numrin më të lartë të të punësuarve e kemi në sektorin bujqësor (56%) dhe sektorin privat jo-bujqësor (45%), ndërsa punësimi në sektorin shtetëror ka rënë me 24% në periudhën 2002-2012. Pjesa më e madhe e punësimit është e përqëndruar në zonën e Peshkopisë ku janë tregtia, shërbimet, ndërtimi por edhe në zonën e Maqellarës dhe të Tominit ku janë përqëndruar një sërë shërbimesh dhe disa investime në agropërpunim.

Ndërkohë që diversifikimi dhe rritja ekonomike tentojnë të krijojnë mundësi të reja punësimi, forcës së punës në Diber i mungojnë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme që të jenë në gjendje të përfitojnë nga avantazhet e këtyre mundësive. Sfida më domethënëse mbetet atëherë të ndërmarrësh një rol ndërmjetësues efektiv ndërmjet tregut të punës dhe forcës së punës. Në këtë çështje shkolla profesionale mund të luajë një rol kyç.

Aktualisht është një shkollë e mesme profesionale që aftëson nxënësit në disa degë kryesore si mekanike, elektrike, tekstile, pedagogjike, ekonomike, etj. Megjithëse janë rreth 417 nxënës që ndjekin shkollën e mesme profesionale, kërkesat për degë të tjera që t'i pergjigjen tregut të punës janë të shumta dhe si më emergjentet janë ato që lidhen me bujqësinë, turizmin malor, ndërtimin, kulinarinë, etj. Kërkesa të shumta janë dhe për qendra të formimit profesional me kurse të shkurta dhe të gjata që të rrisin aftësitë në profesione të lira.

Në zonën e Dibrës e përfundojnë shkollën 9-vjecare rreth 1200 nxënës dhe ndjekin shkollën e mesme vetëm 1000 nxënës, pra janë rreth 200 të tjerë që nuk ndjekin shkollën e mesme. Pra nevoja për kurse të formimit profesional është shumë e lartë pasi janë 17% që nuk ndjekin ansjë shkollë.

## **2. Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)**

Objektivi i përgjithshëm i projektit është : “Të kontribuojë në zhvillimin ekonomik dhe social të Zonës Funktionale Dibrë duke mundësuar punësim për popullatën nëpërmjet trajnimeve profesionale.

Objektivi specifik është: Të forcojmë kapacitetet institucionale dhe shërbimeve për trajnime dhe arsimim profesional në mënyrë që të rrisë aksesin në tregun e punës duke përdorur mjete dhe qasje inovative.

## **3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit (maks. 5-6 rreshta)**

Banorët e zonës së Dibrës kanë traditë për karakterin e tyre punëtore dhe zotësi profesionale në administrim, ndërtimtari, bujqësi, etj. Në sistemin arsimor dibran kanë qenë disa shkolla profesionale si shkolla e bujqësore, shkolla artistike, shkolla e ndërtimit dhe disa qendra të formimit profesional.

Rreth 30% e popullsisë së zonës funksionale do të përfitojnë nga aftësimi në shkollën profesionale. Rezultatet e pritshme janë:

1. Hapja dhe funksionimi I një shkolle profesionale të quajtur “Mjeshtria Dibrane” me kapacitetet prej 300 nxënësish
2. Forcimi institucional dhe kapaciteteve manaxheriale të shkollës profesionale “Mjeshtria Dibrane
3. Ofrimi I shërbimeve me cilësi në një mjedis mësimdhënieje bazuar në nevojat e tregut për rreth 300 persona në çdo vit;
4. Sigurimi i qasjeve inovative për të aksesuar tregun e punës;
5. Rritja e vizibilitetit dhe shpërndarja e eksperiencës si një efekt shumëfishues, duke tërhequr edhe nxënës nga zonat e tjera funksionale (rreth 100 nxënës në vit).

## **4. Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)**

Projekti planifikohet të zgjasë rreth 24 muaj, deri sa të përfundojë set up përfundimtar dhe pas 2 vitesh shkolla do të ketë aftësinë të vazhdojë me ofrimin e shërbimeve sipas misionit për të cilin do krijohet. Aktivitetet kryesore listohen si më poshtë:

- Vlerësim nevojash për organizimin dhe funksionimin e shkollës profesionale “Mjeshtria Dibrane”
- Përgatitja e materialeve ligjore, manualeve të funksionimit, rregullave të brendshme (punësim, financiare, menaxhimi operacional, kurrikulat, kurset etj.)
- Zhvillimi I kapaciteteve per personelin dhe mësuesit e shkollës profesionale për menaxhimin organizativ, menaxhim kurrikulash (nëpërmjet trajnimit, këshillimit dhe asistencës)

- Përgatitja e një plani strategjik përfshirë dhe një plan marketingu për shkollën profesionale “Mjeshtria Dibrane”
- Preparation of curricula according to the needs identified
- Sigurimi i trajnimeve / aftësimi të instruktorëve / mësuesve që do të punësohen në qendrën profesionale
- Sigurimi i mjedisit për të mësuar – blerja e infrastrukturës / paisjeve / makinerive për kurset e veçanta
- Krijimi i minimalisht 10 laboratorëve për mësim dhënien duke punuar për secilin nga kurset
- Organizimi i panairove / ekspozitave të punës

#### **5. Pjekuria e projektit (5-6 lines)**

Projekti ideja është diskutuar gjatë në takimet e forumeve. Nevoja për specializimi në profesione të tilla si kuzhinier, ndërtim, mekanik, bujqësi dhe blegtori është elaboruar qartë. NJV mund të përdorë një nga godinat që ka në pronësi për ta kthyer në një shkollë profesionale. Eksperienca nga shkollat e tjera profesionale mund të përdoren si shembuj për ndërtimin e strukturës funksionale.

NJV në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore duhet të përcaktojë godinën që do shërbejë për këtë qëllim. Një aktivitet i rëndësishëm është vlerësimi i kujdesshëm i nevojave për kualifikim dhe nevojave të tregut për forcë pune.

Në bazë të këtyre nevojave duhet të përcaktohen kurset që do të organizohen dhe duhet të krijohen laboratorët e punës për secilin lloj të profesionit për të cilin do përgatiten kurrikulat e nevojshme dhe do përzgjidhen instruktorët / mjeshtrit.

#### **6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)**

Ky projekt mund të financohet nga Ministria e Punës dhe Ceshtjeve Sociale, si dhe donatorë të tjerë si IADSA, EU. Të gjithë këta aktorë kanë fokus dhe interes të veçantë në edukimin dhe kualifikimin e brezit të ri dhe më gjerë, dhe sigurimin e kualifikuar të forces së punës që çon në zhvillim ekonomik.

Projekti do të zbatohet nga NJV e Zonës funksionale në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore dhe Ministrinë përkatëse.

#### **7. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)**

Ngritja e infrastrukturës (rikonstruktion) – 200,000 Euro

Ngritja e laboratorëve të punës- 10 laboratorë X 100,000 Euro = 1,000,000 Euro

Rritja kapacitetesh për punonjësit – 100,000 Euro

Promovim (strategjia, plan marketing, studime fizibiliteteti, panairove pune) – 100,000 Euro

TOTAL: 1,400,000 Euro



#### Projekti 4:

<b>Titulli i projektit</b>	<i>Sipërfaqe te reja me Pemtari në Dibër..</i>
<b>Tipi i projektit</b>	<i>Zhvillim ekonomik</i>
<b>Vendndodhja e projektit</b>	<i>Zona Funksionale Dibër</i>
<b>Buxheti total i paravlerësuar</b>	<i>350,000 Euro</i>

#### 1. Sfondi dhe analiza e problemit.

Zona e Dibërs është një zonë agrare, ku bujqësia dhe blektoria kanë rolin kryesor në punësimin e njerëzve 58.6% e të punësuarve janë në këto sektorë. Dibra gjithashtu është kampione për cilësinë dhe prodhimin e frutave në Shqipëri pasi pozicioni gjeografik, përbërja e tokës dhe tradita e banorëve të zonës në kultivimin e frutave ka ekzistuar.

Aktualisht megjithëse sasia më madhe e produkteve që dalin në treg rreth 67-75% e sasisë në treg janë frutat e mollës, qershisë, kumbullës dhe arroreve, akoma sipërfaqja e mbjellë me frutikulturë është e vogël, rreth 10% e sipërfaqes së tokës së mbjellë. Norma e fitimit në ngastrat e mbjella me frutikulturë është e lartë rreth 1,600,000 Lekë/ha, akoma banorët më shumë sipërfaqe toke mbjellin me foragjere dhe drithëra buke që kanë një normë fitimi prej 40,000 leke/ha dhe zë rreth 82% (50% foragjere dhe 32% drithëra) të sipërfaqes së mbjellë. Sipërfaqja e mbjellë me pemëtari mund të shtohet pasi foragjeret (që zënë 50% të sipërfaqes) që është baza për blektorinë, mund të jetë si kulturë shoqëruese e pemëtarisë.

Megjithëse ka ekzistuar skema e subvencionit të qeverisë dhe që ka mbështetur fermerët për mbjelljen e tokës me pemëtari, akoma nuk është arritur të thyhet koncepti që pemëtaria të jetë primare e bujqësisë në Dibër. Fermerët në Dibër nuk kanë pasur kapacitetin financiar për krijimin e plantacioneve frutore, gjithashtu ato nuk kanë pasur as sigurinë për fidanët që shiten në treg, të cilët përveç se me cmim të lartë nuk u dihet origjina dhe varieteti, dhe në shumë raste nuk kanë dalë fidanë të mirë dhe fermerët i kanë hequr, duke u shkuar dëm investimi. Gjithashtu një problem tjetër është mungesa e njohurive për kulturat e reja vegjetative, për mbjelljen, mbarështrimin, ciklin e kujdesit dhe kualitetin e tokës që është e përshtatshme për secilën kulturë.

Mungesa e frymës së bashkëpunimit mes fermerëve ka qenë pengesë për ndarjen e njohurive, futjen e inovacioneve, përdorimin e mekanikës, dhe në mos agregimin e normës së fitimit si nga prodhimi dhe nga skemat mbështetëse nga subvencionet ose donacionet e ndryshme.

#### 2. Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)

**Objektivi I përgjithshëm:** Shtimi I të ardhurave për familjet fermere ne Dibër nëpërmjet një bujqësie të zhvilluar dhe të mbështetur në sektorin e pemtarisë.

**Objektivi specifik:** Shtimi I sipërfaqes së mbjellë me pemtari me rreth 25% më shumë brenda vitit 2019, duke krijuar infrastrukturën e duhur mbështetëse me fidanë cilësorë, të kontrolluar dhe të çertifikuar.

### 3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit(maks. 5-6 rreshta)

**Rezultati I Pritshëm 1:** Zona e Dibrës ka strategjinë sektoriale të zhvillimit të Bujqësisë, në të cilën janë përcaktuar qartë orientimet dhe prioritetet e zhvillimit, si dhe ka përcaktuar rajonalizimin e tokës bujqësore.

**Rezultati I pritshëm 2:** fermerët dhe specialistët dibranë të frutikulturës kanë marrë njohuri dhe kanë krijuar aftësi profesionale inovative për varietetet dhe teknologjitë e reja të kultivimit të pemtarisë.

**Rezultati I pritshëm 3:** Minimum 4 fidanishte për mollën, kumbullën, qershinë dhe aroret janë ngritur në Dibër nga specialistët dibranë, sipas standartave të vendeve të përparuara europiane.

**Rezultati I pritshëm 4:** 500 ha pemtore të reja janë krijuar me mollë, kumbulla, qershi dhe arrore në zonën e Dibrës.

### 4. Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)

Nr	Aktiviteti	Periudha kohore											
		Viti I			Viti II			Viti III			Viti IV		
	<b>Strategjia sektoriale e bujqësisë/rajonalizimi.</b>												
1	Krijimi I grupit të punës me specialist të Bujqësisë.												
2	Diskutimi me grupet e interesit												
3	Aprovimi nga Bashkia, dhe futja në planin e veprimit.												
4	Promovimi dhe zbatimi												
	<b>Zhvillimi I kapaciteteve</b>												
5	Cikël trajnimesh praktike për fermerët dhe specialistët e rinj.												
6	Vizitë studimore në Itali ose Francë për specialistët e fidanishtes.												
7	Instruktim për specialistët e fidanishteve nga specialist të huaj.												
	<b>Ngritja e 4 fidanishteve me mollë, kumbulla, qershi dhe arrore.</b>												
8	Kontraktimi I 4 specialistëve për ngritjen e fidanishteve sipas varieteteve.												
9	Kontrolli I cilësisë së procesit të punës hapa pas hapi.												
10	Certifikimi I fidanëve												
	<b>Krijimi plantacioneve frutore.</b>												

11	Përcaktimi I rajoneve për llojin e plantacioneve												
12	Furnizimi I fermereve me fidanë												
13	Krijimi I plantacioneve me mollë, qershi, kumbull dhe arvore												
14	Shpërndarja e eksperiencës.												

### 5. Pjekuria e projektit (5-6 lines)

Janë disa projekte dhe eksperiencia nga Organizata të ndyshme që kanë në fokus bujqësinë në Dibër si ADAD që është mbështetur nga FERD (Shoqatë Franceze) në këtë drejtim dhe Ministria e Bujqësisë e cila po finalizon hartën e rajonalizimit të tokës bujqësore në Shqipëri. Projektet e deritanishme kanë qenë më shumë në dhënie të asistencës teknike për fermerët dhe ku janë krijuar disa modele suksesi në zonë të gjitha varietetet e pemtarisë. Projekti i hartuar mbështetet tek kjo eksperiencë e krijuar, dhe kërkon ta shtojë në një dimension më të gjerë dhe më të qëndrueshëm, duke filluar me vlerën e parë të zinxhirit që janë fidanishtet dhe plantacionet, që janë baza për shtimin e sasisë së prodhimit dhe cilësisë.

### 6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)

Aktorë për zbatimin e këtij projekti është Bashkia Peshkopi që është dhe aktori përfitues dhe garantues. Për zbatimin e projektit mund të zgjedhë partner dhe Organizata Jo Fitim Prurëse që kanë në fokus Zhvillimin rural dhe agrar, si dhe Drejtorinë e Bujqësisë në Dibër. Financimet mund të gjenden tek donatorë të ndryshëm dhe ku Bashkia është bashkë-financuese dhe garantuese e projektit.

### 7. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)

Kostoja totale e projektit: 350,000 Euro.

Kostoja e ngritjes së fidanishteve 200,000 Euro. (4 fidanishte me nga 50,000 Euro)

Kostoja e aktiviteteve të tjera 150,000 Euro.

### Projekti 5:

<b>Titulli i projektit</b>	Zhvillimi i turizmit rural në zonën funksionale nëpërmjet ngritjes dhe promovimit të shtëpive pritëse
<b>Tipi i projektit</b>	Zhvillim ekonomik
<b>Vendndodhja e projektit</b>	15 NJV të zonës funksionale
<b>Buxheti total i paravlerësuar</b>	180,000 Euro

#### 1. Sfondi dhe analiza e problemit.

Zona e Dibrës ka potenciale të shumta për zhvillimin e agro-turizmit. Lugina e Dibrës rrethohet nga dy anët nga vargmali Deshat-Korab që është dhe mali më i lartë në Shqipëri, dhe vargmalet e Lurë-Selishtë që janë dhe 21 liqenet akullnajore. I gjithë territori dallohet për monumente të shumta natyrore qofshin këto gjeo-monumente, hidro-monumente apo bio-monumente (41 monumente natyrore), të cilat për vlerat e tyre të veçanta historike, estetike, turistike, biologjike janë një numër i madh objektesh dhe peisazhesh si monumente natyrore, që janë pjesë e parkut natyror Korab-Korritnik dhe parkut kombëtar të Lurës. Në këtë territor ka një florë dhe faunë shumë të pasur ku gjenden më shumë se 138 lloje të rralla bimësh (bima e rrallë autoktone tulipani i Korabit) dhe kafshë të rralla si Tigri I Ballkanit, Dhia e Egër, gjeli I egër dhe shumë shpendë të tjera të egra ku më e famshme është shqiponja e Korabit.

Turizmi rural në Dibër ka shumë mundësi për t'u zhvilluar, ku shumë shpejt mund të hapen rreth 500 shtëpi pritëse në gjithë territorin e Dibrës. Janë disa fshatra malorë që mund të kthehen në fshatra me profil turistik si në Maqellarë, Melan, Tomin, Kastriot, Sllovë, Kala e Dodës, Lurë, Reç, Dardhë, Arras, Muhurr dhe Selishtë. Vetëm në Lurë janë 2 hotele të rregulluara, ndërsa në komunat e tjera janë thjesht disa shtëpi pritëse, të cilat zotërojnë kushte bazike dhe me mungesë në cilësinë e shërbimeve.

Vizitorët e paktë që vizitojnë janë turistët e huaj që vijnë kryesisht nga Evropa Perendimore dhe Qendrore si dhe Amerika e Veriut për periudha të shkurta prej 1-5 ditë. Një numër i konsiderueshëm i vizitorëve, sidomos ata një-ditorë, vijnë nga Tirana dhe Durrësi.

#### 2. Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)

Objektivi I përgjithshëm I projektit është krijimi I një mjedisi mundësues biznesi duke promovuar vlerat turistike të Zonës Funksionale.

Objektivat specifikë të projektit janë:

- Forcimi i Grupit Lokal të Veprimit “Dibra Turistike” për promovimin dhe zhvillimin e turizmit rural nëpërmjet planifikimit strategjik, koordinimit dhe menaxhimit të aktiviteteteve duke qenë në linjë me përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe kulturore;

- Rikonstruksioni dhe vënia në funksionim të plotë e të paktën 10 shtëpive pritëse (nga 500 shtëpi pritëse potenciale) në mënyrë që të pilotohen modelet e para të suksesshme për zhvillimin e turizmit rural si në larmishmërinë e paketave turistive, dhe në cilësi shërbimesh.
- Të forcohen aftësitë dhe kapacitetet pritëse të familjarëve të shtëpive pritëse (50 persona) me njohuri dhe aftësi bazë për ofrimin e shërbimeve (kuzhinë, anglishte bazike, aftësi komunikimi)
- Të zhvillohet një sistem marketingu për turizmin rural nëpërmjet mirëmbajtjes dhe update të website, ofertave promocionale, panairëve, festivaleve dhe eventeve të tjera të veçanta.

### **3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit (maks. 5-6 rreshta)**

Ndërhyrja me këtë projekt planifikohet të realizojë:

- Përgatitjen e një strategjie të qartë ndërhyrjeje për turizmin rural, me fokus promovimin dhe zhvillimin e këtij sektori që do të krijojë mundësi punësimi dhe gjenerim të ardhurash për mbi 500 familje (mbi 2000 persona) në mënyrë direkte dhe në mënyrë indirekte për më shumë se 50% të popullsisë së zonës funksionale.
- Ndërtimi / rikonstruksioni dhe sigurimi i të gjitha shërbimeve të nevojshme për 10 shtëpi pritëse në vargmalin e Deshatit duke patur parasysh që një strategji turizmi ekziston dhe një Grup Lokal Veprimi është aktiv. Këto shtëpi pritëse do bëhen modeli për 500 shtëpitë e tjera potenciale.
- Rritja e të ardhurave të këtyre familjeve me 20%
- Shtimi I numrit të turistëve me 1000 vizitorë në vit (1000vizitorë X300 Euro secili)

Nga ky aktivitet përfitojnë 15 NJV të zonës funksionale.

### **4. Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)**

- Ngritja e 10 shtëpive pritëse model i suksesshëm për familjet e tjera pritëse; Ndërtimi / rikonstruksioni dhe sigurimi i të gjitha shërbimeve të nevojshme për 10 shtëpi pritëse në vargmalin e Deshatit duke patur parasysh që një strategji turizmi ekziston dhe një Grup Lokal Veprimi është aktiv. Këto shtëpi pritëse do bëhen modeli për 500 shtëpitë e tjera potenciale.
- Dhënia e paketave të trajnimeve për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për familjarët e shtëpive pritëse
- Krijimi i paketave turistike të NJV dhe promovimi aktiv i tyre në website të NJV
- Pjesëmarrja në 1 panair turistik (panairi ndërkombëtar)
- Futja e informacionit të vazhdueshëm në website të NJV për promovimin e paketave turistike dhe shtëpive pritëse me qëllim zhvillimi e turizmit rural.

## 5. Pjekuria e projektit (5-6 lines)

Një strategji turizmi për vargmalin e Deshatit është përgatitur. Janë vendosur pak sinjalistika për shtigje turistike. Ka disa inisiativa personale për ngritjen e shtëpive pritëse por mungon koordinimi i veprimeve dhe cilësia në shërbime.

Gjithashtu shembuj pozitive mund të merren nga zona ndërkufitare (pjesa Maqedonase), apo Thethi në Shkodër.

Aktiviteti I parë që duhet të ndërmerret është identifikimi i shtëpive të para me të cilat do punohet për t'i kthyer në shtëpi pritëse dhe që do të shërbejnë si modele për shtëpitë e tjera.

Projekti do të zbatohet në 2 vite, me kushti që vazhdimësia do jetë edhe në vitet në vazhdim e koordinuar nga NJV dhe shoqata “Dibra turistike”

## 6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)

Për sektorin e turizmit ka aktorë që janë të interesuar për të ndërhyrë. NJV mund ta iniciojë me fondete veta. Donatorë të mundshëm janë GIZ, ADA, EU.

NJV është zbatuesi i projektit, në partneritet me LAG “Dibra Turistike” dhe organizata të tjera lokale.

## 7. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)

*Jepni një paravlerësim të buxhetit të nevojshëm për projektin, nëse është e mundur, të ndarë për secilin aktivitet kryesor ( përfshirë aktivitetet përgatitorre nëse nevojiten të tilla).*

**E rëndësishme:** Një vlerësim i kostove totale të projektit.

Projekti parashikon kosto për punë konkrete (investim) dhe rritje kapacitetesh:

- Rikonstrukcion dhe paisje e shtëpive pritëse – 10 shtëpi X 10,000 Euro = 100,000
- Rritja kapacitetesh për familjet pritëse – 50,000 Euro
- Pjesëmarrje në panair ndërkombëtar – 10,000 Euro
- Materiale promovues, plan marketingu – 20,000 Euro

## 8.2 Projektet që promovojnë shërbimet e sektorit publik

Projektet me fokus përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga institucionet publike në territorin e ZF dhe të rëna dakord në forumin e saj janë:

### Projekti 1:

<b>Titulli i projektit</b>	<i>Dibra e Pastër</i>
<b>Tipi i projektit</b>	<i>Shërbime Publike</i>
<b>Vendndodhja e projektit</b>	<i>Zona Funktionale e Dibrës, (Peshkopi, Maqëllarë, Melan, Tomin, Kastriot, Slllove, Kala, Rec, Dardhe, Arras, Muhurr, Fushë Cidhën, Luzni, Lurë dhe Selishtë)</i>
<b>Buxheti total i paravlerësuar</b>	<i>420,000 Euro</i>

#### 1. Sfondi dhe analiza e problemit.

Zona e Dibrës ka në administrim 141 qendra të banuara në fshatra dhe një qytet që është qyteti I Peshkopisë. Në këtë zonë banojnë 16000 familje specifikisht 11500 në zonat rurale dhe 4500 në zonën urbane. Menaxhimi I mbetjeve është një problem shqetësues pasi 76.4% e familjeve nuk kanë akses në këtë shërbim (vetëm në 23.6% të familjeve kanë akses në këtë shërbim, dhe këto janë kryesisht në qytetin e Peshkopisë).

Nevoja për pika grumbullimi është e madhe (nevojiten rreth 400 kosha të rinj), pasi aktualisht janë gjithsej 197 pika grumbullimi (kosha) të cilat nuk e përballojnë grumbullimin e gjithë sasisë që krijohet. Edhe, transporti i mbeturinave bëhet me kamionë dhe traktorë në dy zona, janë gjithsej 6 kamionë (vetëm 3 janë në gjendje pune) dhe 3 traktorë (vetëm 2 janë në gjendje pune) por që nuk mjaftojnë për të mbuluar gjithë territorin e zonës, prandaj nevojiten edhe 2 makina të reja për këtë proces. Fusha e depozitimit është vetëm një në Peshkopi dhe është e ndërtuar në vitin 2003, është 2 km nga qyteti dhe është planifikuar të jetë për një periudhë 25-vjecare me një kapacitet deri në 1000 ton në muaj (33 ton në ditë).

Kjo fushë nuk i përmbush kushtet e një landfill, duke pasur një kapacitet prej 40% më pak të planifikuar se realiteti. Gjithashtu kjo fushë është e mirëmbajtur keq, e parrethuar, pa kanale kullimi, dhe ku mbeturinat në të shumtën e herës digjen, duke qenë një burim ndotje dhe rreziku për banorët dhe fëmijët e qendrave të banuara përreth. Pjesa tjetër e popullsisë I hedhin mbeturinat buzë lumenjve dhe përrenjve duke ndotur mjedisin, dhe krijuar një pamje të shëmtuar për mjedisin.

Mungojnë planet sektoriale të menaxhimit të mbetjeve, dhe aktualisht vetëm 8 NJQV aktuale kanë buxhet për mbetjet, I cili është 25,392,000 ALL dhe arkëtimi nga tarifa është 8,206,040 ALL, që do të thotë se harxhohet reth 1587 ALL për cdo familje dhe arkëtohet nga cdo familje 513 ALL në vit. Kjo do të thotë që qytetarët duhet të paguanë më shumë dhe të mblidhet tarifa e pastrimit. Deri më tani NJQV kanë pasur vetë brigadën e pastrimit në të cilën janë angazhuar 26 persona, të cilët kanë kryer të gjithë këtë proces.

Nevoja për rregullimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve është emergjente dhe kjo ndikon në cilësinë e jetës dhe për një zonë më atraktive për turizëm e cila kërkon një ambient të pastër.

## 2. Objektivi/at specifike të projektit (maks. 4-5 rreshta)

Objektivi I përgjithshëm: Përmirësimi I cilësisë së jetës së banorëve të Dibrës, nëpërmjet përmirësimit të sistemit të menaxhimit të mbetjeve në gjithë zonën duke e bërë Dibrën e pastër, të këndshme për të jetuar për banorët e saj dhe tërheqëse për vizitorët për bukuritë natyrore dhe ambjentin e pastër.

Objektivi specifik: Përmirësimi I sistemit të menaxhimit të mbetjeve në zonën e Dibrës, duke mundësuar mbulimin për të gjithë territorin e saj në administrim, për 141 fshatrat dhe qytetin e Peshkopisë, brenda viteve 2015-2017.

## 3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit(maks. 5-6 rreshta)

**Rezultati I pritshëm 1:** ZF Dibër ka planin e Menaxhimit të mbetjeve, të hartuar me ekspertizë të jashtme dhe me standarte teknike.

**Rezultati I pritshëm 2:** Kapacitete te rritura të stafit të NJQV së Dibrës për procesin e menaxhimit të mbetjeve, të cilët kanë marrë pjesë aktive në procesin e hartimit të planit të menaxhimit mbetjeve, dhe janë aftësuar nga cikli I trajnimeve/instruktimeve për të zotëruar aftësitë e duhura në punën e tyre të përditshme.

**Rezultati I pritshëm 3:** 80% e familjeve në zonën e Dibrës kanë akses në shërbimin e menaxhimit të mbetjeve duke filluar nga sistemi I grumbullimit, transportimit dhe depozitimit të mbetjeve, me infrastrukturën dhe mjetet e duhura.

**Rezultati I pritshëm 4:** Komuniteti I Dibrës është I ndërgjegjësuar për mbajtjen pastër të territorit dhe për rëndësinë dhe detyrimet e tyre për të hedhur në vendin e në kohën e duhur dhe për të paguar detyrimet që dalin për tarifën e pastrimit.

## 4. Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)

Nr	Aktiviteti	Afatet kohore											
		½ e pare				½ e dyte				½ e trete			
1	Hartimi I planit të menaxhimit												
2	Rritje kapacitetesh per stafin e NJQV (trajnime dhe instruktime)												
3	Hartimi I specifikimeve teknike per blerjet e koshave dhe makinave + praktika e blerjes.												
4	Blerja e 400 koshave dhe 2 makinave kontienere.												
5	Vendosja e koshave												
6	Fushatë sencibilizuse për komunitetin për grumbullimin												



	dhe ndarjen e mbetjeve.																	
7	Hartimi dhe njohja e komunitetit me programin e grumbullimit te mbetjeve.																	
8	Rehabilitimi I fushës së mbetjeve.																	

### 5. Pjekuria e projektit (5-6 lines)

Zona Funktionale e Dibrës nuk ka një studim të mirëfilltë fizibiliteti apo plan menaxhimi për menaxhimin e mbetjeve. Ky projekt propozim ka shfrytëzuar nevojën dhe informacionin e grumbulluar nga NJQV aktuale me bazën kryesore të të dhënave që ato disponojnë, duke shfrytëzuar dhe burimet teknike dhe financiare që këto njësi kanë operuar deri më tani. Këto të dhëna janë mbledhur nga studimi i dldp për FAP-Dibër, bazuar në metodologjinë e dldp dhe nga pyetësorët, dhe diskutimet me grupet fokus të 15 NJQV të kësaj zone funksionale. Gjithashtu për shumë standarte teknike mbështetemi në udhëzimet e Ministrisë së Linjës, e cila I ka udhëzuar NJQV me këtë praktikë, e cila aktualisht është përdorur nga Bashkia Peshkopi.

### 6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)

Bashkia e Peshkopisë është përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve. Kjo njësi mobilizon burimet e duhura financiare dhe njerëzore për përmbushjen e këtij shërbimi. Departamenti përgjegjës është departamenti I shërbimeve publike, dhe brigada e menaxhimit të mbetjeve. Bashkia Peshkopi, hyn në partneritet me donatorë të ndryshëm për gjetjen e financimeve të nevojshme. Kostoja e projektit është 420,000 Euro, nga të cilat Bashkia Peshkopi mbulon 50% nga buxheti I të ardhurave në bashki bashkë me tarifën e pastrimit të grumbulluar, dhe kërkon donacion për 50%.

### 7. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)

**Kostoja e totale: 420,000 Euro**

Kostoja operacionale: 200,000 Euro.

Kosto investimi: 150,000 Euro: (Koshat: 80,000 Euro (400\*200euro). Kamionët: 40,000 Euro (2\*20,000). Fusha e dekompozimit: 30,000 Euro.)

Kosto për zhvillim kapacitetesh: 70,000 Euro. (Plani I menaxhimit: 20, 000 Euro. Trajnime dhe instruktme: 10,000 Euro. Sencibilizimi: 40,000 Euro).

## Projekti 2:

<b>Titulli i projektit</b>	<i>Parku rekreativ I Luginës së Shërimit.</i>
<b>Tipi i projektit</b>	<i>Shërbime Publike</i>
<b>Vendndodhja e projektit</b>	<i>Bashkia Peshkopi, Komuna Melan, komuna Tomin</i>
<b>Buxheti total i paravlerësuar</b>	<i>150,000 Euro</i>

### 1. Sfondi dhe analiza e problemit.

Qyteti I Peshkopisë me 20,000 banorë megjithëse shtrihet në një pozicion të favorshëm gjeografik, buzë luginës së përroit të Llixhave, I famshëm për ujërat termale me veti shëruese, rrethuar me kodra të pasura me bukuri monumentale natyrore dhe ku gjenden dhe rrënojat e kishave dhe manastireve të vjetra nga ku ka marrë dhe emrin Peshkopia, *mungojnë hapësirat e gjelbërta dhe parqet rekreative.*

Pushuesit e shumtë që frekuentojnë Llixhat (12,000 pushues në vit), qytetarët e Peshkopisë, të rinjtë dhe të rejtat që janë të apasionuar për të shëtitur, pushuar, luajtur dhe kaluar kohën e lirë në parqe, nuk kanë asnjë mundësi në Peshkopi.

Lugina e përroit të Peshkopisë është shumë e favorshme që të kthehet në një park rekreativ, pasi është afër qytetit dhe ka hapësirat e nevojshme, atraksionet natyrore dhe historike, për t'u kthyer në një park rekreativ. Vendodhja në territorin e parkut natyror Korab-Korritnik dhe bashkimi I NJQV Melan, Tomin dhe Peshkopi krijojnë një mundësi ligjore dhe institucionale për krijimin e këtij parku.

### 2. Objektivi/at specifike të projektit (maks. 4-5 rreshta)

**Objektivi I përgjithshëm:** Përmirësimi I cilësisë së jetesës së banorëve të Peshkopisë duke krijuar ambiente çlodhëse dhe rekreative.

**Objektivi specifik:** Ngritja e parkut rekreativ të Luginës së Shërimit në rrethinat e Peshkopisë, me një sipërfaqe prej 50 ha, me stola dhe parqe, shtigje për të ecur në këmbë, me parkun arkeologjik të rrënojave të kishave, me fusha dhe ambiente sportive si dhe me ambiente të tjera shërbimesh, brenda vitit 2019.

### 3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit(maks. 5-6 rreshta)

**Rezultati I pritshëm 1:** 300 familjet e lagjes Llixha janë të ndërgjegjësuar dhe të angazhuar në prishjen e avllive përgjatë rrugës kryesore dhe krijimin e gardheve të gjelbërta.

**Rezultati I pritshëm 2:** Ambient natyrorë çlodhës I sistemuar dhe I përshtashëm me stola pushimi, 10 ha pyll dhe 8 km shteg për ecje në këmbë.

**Rezultati I pritshëm 3:** Ambiente sportive me fusha mikse futbollit, basketbollit, volejbollit dhe ambiente për ngjitje alpinizmi janë ndërtuar.



### Projekti 3:

<b>Titulli i projektit/programit</b>	<i>Rivitalizimi i fshatrave</i>
<b>Tipi i projektit</b>	<i>Shërbime Publike</i>
<b>Vendndodhja e projektit</b>	<i>Zona Funksionale Dibër (15 NJQV)</i>
<b>Buxheti total i paravlerësuar</b>	<i>2,300,000 Euro</i>

#### 1. Sfondi dhe analiza e problemit.

Zona Funksionale e Dibrës ka në administrim 141 fshatra që kanë qenë pjesë e 14 komunave. Në 20-të vitet e fundit ka ndodhur një largim I madh nga fshatrat drejt qytetit të Peshkopisë dhe zonave të zhvilluara të Tiranës dhe Durrësit ku në vitin 1990 jetonin 86,000 banorë në fshat dhe sot jetojnë 60,000 banorë rreth 43% janë larguar.

Një nga arsyet me të mëdha, (përvec anës ekonomike) të këtij largimi ka qenë dhe *mungesa e shërbimeve në fshat si rrugëve të asfaltuara dhe shesheve* të cilat ndikonin dhe në largësinë e banorëve me shërbimet e tjera bazë si arsim, shëndetësi, tregje, punësim, etj. Familjet që ndodhen në fshat dhe shumë familje të tjera që kanë shtëpitë por nuk qëndrojnë gjatë gjithë sezonit kanë investuar në shtëpitë e tyre dhe kanë krijuar ekonomi të formalizuara në fshat dhe ndërtuar jetesën në shtëpitë e tyre, duke bërë që vitet e fundit të kemi një stabilizim të ikjes nga fshati, por kemi një tendencë të frekuentimit dhe të kthimit të banorëve të larguar.

Krijimi I NJQV së Dibrës si një njësi dhe mos funksionimi I komunave duket që fshati do të mbetet më larg shërbimeve që ofrohen nga pushteti lokal. Kështu një program për rivitalizimin e fshatit, ku të bashkëpunohet ngushtë më komunitetin e fshatit I cili është solid, duhet të rehabilitohen sheshet e qendrave të komunave që kanë qenë qendra krahinore, qendrat e fshatrave të mëdhenj që kanë 1500-2500 banorë, si dhe asfaltimin e rrugëve të fshatrave që janë 1-1.5km nga aksi kryesor I rrugëve të asfaltuara, duke bërë në këtë mënyrë rivitalizimin e fshatit në zonën e Dibrës. Projekti është pjesë e analizës së shërbimeve të NJQV në seksionin për transportin dhe rrugët.

#### 2. Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)

**Objektivi I përgjithshëm:** *Përmirësimi I cilësisë së jetesës për banorët e fshatrave të Dibrës, nëpërmjet rregullimit të kushteve dhe shërbimeve infrastrukturore në fshat.*

**Objektivi specifik:** *Rivitalizimi i fshatrave të Dibrës, duke përmirësuar pamjen arkitekturore të fshatrave me sheshe të sistemuara dhe me vepra arti të paktën për qendrat krahinore që kanë qenë ish-komuna dhe fshatrat e mëdhenj, si dhe me rrugë të asfaltuara të paktën për fshatrat që janë 1-1.5km larg aksit kryesor të rrugës nacionale, brenda vitit 2019.*

### 3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit(maks. 5-6 rreshta)

**Rezultati I pritshëm 1:** Fshatrat e Dibrës (12 qendrat krahinore dhe 8 fshatrat e mëdhenj) janë me sheshe të sistemuara, me vepa arti dhe komuniteti ka kontribuar dhe ka marrë pjesë aktive.

**Rezultati I pritshëm 2:** 10-të Fshatrat e Dibrës që janë 1-1.5km larg akseve rrugore kryesore të asfaltuara, janë me rrugë të asfaltuara dhe të sistemuara.

### 4. Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)

Nr	Aktivitetet	Periudha kohore			
		Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV
1	Hartimi projekteve teknike				
2	Fushatë dialogimi me komunitetin e fshatrave.				
3	Rehabilitimi I shesheve				
4	Asfaltimi I rrugëve				

### 5. Pjekuria e projektit (5-6 lines)

Programi ka në tërësinë e tij disa projekte dhe është në fazën e konceptit. Për pjesën e projekteve të rrugëve, disa komuna kanë projektet e plota teknike të cilat do të dorëzohen në inventarin e NJQV së ardhshme, që të vazhdojnë fazën e aplikimit të mëtejshëm.

### 6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)

NjQV e ardhshme është përgjegjëse për hartimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen. Fondet për rehabilitimin e shesheve mund të gjenerohen një pjesë e madhe edhe nga kontributi I komunitetit ose biznese nga ky komunitet, ndërsa për rrugët ato do të thithen nga fondet e qeveritare si Fondi I Rajoneve apo Fondi I Zhvillimit Shqiptarë. Bashkia do të bashkëpunojë ngushtë me komunitetin dhe biznese që janë të gatshëm të sponsorizojnë sidomos për rehabilitimin e shesheve.

### 7. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)

Kostoja totale e projektit është 2,300,000 Euro. Në këtë kosto janë futur 1,500,000 Euro për asfaltimin e Rrugëve, dhe rreth 800,000 Euro për rehabilitimin e shesheve.

Projekti 4:

<b>Titulli i projektit</b>	<i>Rivitalizimi I shesheve, rrugëve dhe parkingjeve në Peshkopi Peshkopia qyteti I lulebores dhe trëndafilave.</i>
<b>Tipi i projektit</b>	<i>Shërbime Publike</i>
<b>Vendndodhja e projektit</b>	<i>Bashkia Peshkopi</i>
<b>Buxheti total i paravlerësuar</b>	<i>500,000 Euro</i>

### 1. Sfondi dhe analiza e problemit.

Qyteti I Peshkopisë është qendra administrative dhe urbane e Dibrës, ku ndodhin ndërveprimet ekonomike, tregtare, të punësimit dhe të shërbimeve kryesore për të gjithë zonën. Agresiviteti I lartë ekonomik, shoqëror dhe politik I viteve të tranzicionit ka krijuar një kaos në qytet, me ndërtime të shumta pa kriter urbanistik, me rrugë dhe sheshe të zaptuara dhe jashtë funksionit, me trafik të çrregullt dhe mungesë parkingjesh, që krijojnë një pamje të shëmtuar të qytetit.

Cilësia e dobët e shëtitoreve, shesheve, rrugëve, parkingjeve në Peshkopi, në të shumtën e herës është edhe për mungesë të rregullit dhe angazhimit si institucional dhe qytetar për rregullimin e hapësirave publike, sidomos të atyre që janë para ambjenteve të dyqaneve/shërbimeve të vetë qytetarëve dhe atyre ambjenteve që janë nën-administrimin e bashkisë.

Investimet e fundit të KFW për ujësjellësin dhe Bankës Islamike për rregullimin e bulevardit kryesor janë një mundësi e mirë për të rivitalizuar sheshin, rrugët, trotualet dhe transportin urban duke sistemuar parkingjet dhe stacionet e minibuzeve.

### 2. Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)

**Objektivi I përgjithshëm:** Përmirësimi I cilësisë së jetës urbane në Peshkopi.

**Objektivi specifik:** Rivitalizimi I pamjes urbane të Qytetit të Peshkopisë, duke bërë rikonstrukcionin e shesheve, rrugëve, trotuareve, lulishteve, vende parkingjeve, sistemin e transportit urban, brenda vitit 2019.

### 3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit(maks. 5-6 rreshta)

**Rezultati I pritshëm 1:** Komuniteti I biznesit që ushtron aktivitet në dyqanet/baret/qendrat tregtare në krah të rrugëve të qytetit, janë të ndërgjegjësuar dhe kontribuojnë për mbjelljen dhe kujdesin për vazot me lule bore, trëndafila dhe bime të tjera dekorative buzë trotuareve, para objekteve të tyre. Komuniteti I biznesit kontribon që Peshkopia të bëhet dhe identifikohet si qyteti I lule-boreve dhe trëndafilave.

**Rezultati I pritshëm 2:** Peshkopia me shëtitore dhe sheshe të rregulluara. Bulevardi kryesor I cili rregullohet me investimin e Bankës Islamike, zgjatet deri tek Ura e pazarit ku ndërtohet monumenti I harkut të qytetit.

**Rezultati I pritshëm 3:** Peshkopia me stacion urban dhe parkingje te rregulluara.



### Projekti 5:

<b>Titulli i projektit</b>	<i>Rehabilitim dhe asfaltimi I Rrugës Kastriot-Lurë.</i>
<b>Tipi i projektit</b>	<i>Shërbime Publike</i>
<b>Vendndodhja e projektit</b>	<i>NJQV (Kastriot, Fushë-Cidhnës, Arras, Lurë)</i>
<b>Buxheti total i paravlerësuar</b>	<i>4,000,000 Euro</i>

#### 1. Sfondi dhe analiza e problemit.

Infrastruktura rrugore që lidh Parkun kombëtar të Lurës me Peshkopinë (44km) është në gjendje shumë të keqe, rrugë në më shumë se 34 km rurale, dhe vetem 10 km janë të asfaltuara, e vështirë për t'u kaluar në mot të keq (në dimër e bllokuar), që ndikon negativisht në aksesin e banorëve të Lurës, Arrasit, Fushë-Cidhnës dhe Kastriotit me tregjet dhe shërbimet në qytetin e Peshkopisë, dhe në mos-zhvillimin e turizmit malorë dhe historik të kësaj zone, duke e bërë atë një zonë të izoluar.

Ndërtimi I rrugës Peshkopi-Kukës, e cila kalon nëpër Kastriot ka krijuar një mundësi që dhe aksi rrugor Kastriot-Lurë të lidhet me këtë aks duke shkurtuar 13 km të aksit ekzistues që kalon nëpër Muhurr, dhe nga të cilat rreth 10 km janë të asfaltuara dhe në gjendje të mirë. Rehabilitimi kësaj rruge do kërkonte ndërtimin e urës së "Lushës" mbi lumin Drin me gjatësi 78m, dhe asfaltimin e 21km rrugë rurale. Impakti I kësaj rruge është shumë I madh pasi kalon në shumë qendra të banuara, dhe ka rëndësi për zhvillimin e turizmit të një prej zonave me më shumë resurse natyrore si parku I Lurës, kanioni I Setës dhe vlerat historike që lidhen me vendlindjen e Skënderbeut, kalaja e Kastriotëve etj.

#### 2. Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)

**Objektivi I përgjithshëm:** Përmirësimi I jetesës së banorëve të Lurës, Arrasit, Fushë-Cidhnës, Kastriotit duke krijuar kushte të mira të infrastrukturës rrugore që e lidhin këto zonë me tregjet dhe qendrat e zhvilluara urbane te Peshkopisë, Shqipërisë dhe më gjerë.

**Objektivi specifik:** Rehabilitimi dhe asfaltimi I aksit rrugor Kastriot-Lurë prej 21 km, brenda vitit 2018.

#### 3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit(maks. 5-6 rreshta)

**Rezultati I pritshëm 1:** 21Km rrugë rurale të rehabilituara dhe të asfaltuara në aksin rrugor Kastriot-Lurë.

**Rezultati I pritshëm 2:** Rreth 20,000 banorë të Lurës, Arrasit, Fushë-Cidhnës dhe Kastriotit do të kenë akses të shpejtë dhe cilësor me tregjet, shërbimet me qendrën urbane te Peshkopisë, e cila do të jetë larg nga Lura vetëm 31km rrugë e asfaltuar.

**Rezultati I pritshëm 3:** 40% e të ardhurave të banorëve të kësaj zone shtohen nga aksesin në treg I prodhimeve të tyre dhe nga ku parku I Lurës dhe vendlindja e Skënderbeut vizitohen nga 4000 pushues në vit.



#### 4. Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)

Nr	Aktiviteti	Afatet kohore																				
		½ e pare					½ e dyte					½ e trete					½ e kater					
1	Aprovimi i projektit	■																				
2	Kontraktimi i firmës zbatuese	■	■	■																		
3	Fillimi i punimeve				■																	
4	Sistemime dhe gërmime dheu				■	■	■	■	■													
5	Veprat e artit							■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
6	Shtrimi I shtresës së çakullit.									■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
7	Shtrimi i shtresës së stabilizantit																			■	■	■
8	Shtrimi i shtresës së parë të asfaltit.																					■
9	Shtrimi i shtresës së dytë të asfaltit																					■
10	Vendosja e sinjalistikës																					■

#### 5. Pjekuria e projektit (5-6 lines)

Projekti i rrugës Kastriot-Lurë është një nga projektet prioritare të dalë nga strategjia rajonale e zhvillimit të Qarkut të Dibrës. Ekziston një projekt teknik për rrugën dhe për urën e Lushës mbi lumin Drin. Projekti I urës së Lushës mbi lumin Drin është në fazën e kontraktimit me fondet e FZSH, ku gjithashtu është edhe projekti teknik I rrugës I cili ka qenë në listën e pritjes së rrugëve rajonale me rëndësi për zhvillimin e turizmit për t'u financuar nga FZSH.

#### 6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)

NJQV e Dibrës është struktura përgjegjëse që ka në inventarin e saj për shfrytëzim dhe mirëmbajtje të këtij aksi rrugor. Fondet aktualisht për rehabilitimin dhe asfaltimin e kësaj rruge janë jashtë mundësie financiare të NJQV, prandaj ata do të kërkohen nga donatorë të tjerë ku më potenciali është Fondi i Zhvillimit Shqiptarë (FZSH) dhe ndonjë donator i huaj.

#### 7. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)

Kostoja e projektit është 4,000,000 Euro. Në këtë kosto është e përfshirë edhe ura e Lushës mbi lumin Drin që ka një kosto rreth 500,000 Euro.

### 8.3 Projektet e shpejta - Quick start

Forumi I ZF Dibër propozoi dhe një set projektesh që mund të zbatohen menjëherë dhe që kanë një impact më të shpejtë në ZF. Këto projekte të identifikuar janë;

*Projekti 1:*

<b>Titulli i projektit</b>	Binjakëzimi I Bashkisë Dibër më komunën e Meranos, Bolzano, Itali.
<b>Tipi i projektit</b>	<i>Projekte që mobilizohen shpejt</i>
<b>Vendndodhja e projektit</b>	<i>ZF Dibër</i>
<b>Buxheti total i paravlerësuar</b>	<i>15,000 Euro</i>

#### 1. Sfondi dhe analiza e problemit.

Binjakëzimi I qeverisjes vendore është si një mjet që nxit zhvillimin e zonave funksionale ose të një territori të një njësie vendore, pasi mundëson njohjen dhe shkëmbimin e eksperiencave të mira dhe të suksesshme që kanë dhënë rezultat në secilën njësi ose zonë. Në zonën e Dibrës, përfaqësues të NJQV kanë bërë shumë shkëmbime dhe marrje eksperiencash nga njësi të ndryshme të Europës, por një binjakëzim I mirëfilltë ka munguar, në formën të institucionalizuar dhe funksionale nuk kemi deri tani (është një marrëveshje binjakëzim I bashkisë Peshkopi me një komunë në Danimarkë, por vetëm në letër, pa aktivitet konkret).

Binjakëzimi si mjet që nxit zhvillimin, jo vetëm në aspektin e nënpunësve të qeverisjes por dhe në aspektin e gjerë social, ekonomik dhe qeverisës mungon për zonën e Dibrës. Zona e Dibrës ka një pejzash shumë të bukur malor, të larmishëm me luginën e lumit Drin I Zi, dhe me vargmalet e Lurë-Selishtë dhe Deshat-Korab në të dy anët, pak a shumë e ngjashme me territorin e komunës së Meranos në Itali, që është një nga zonat më të pasura në Europë. Gjithashtu zona e Meranos si dhe zona e Dibrës janë të shquara për prodhimin e mollëve dhe frutave, duke qenë kampione në nivel Europian. Një numër I madh banorësh të Dibrës kanë emigruar dhe jetojnë në këtë komunë me familjet e tyre, duke qenë një element shumë I rëndësishëm që stimulon marrjen e një hapi për të mundësuar procedurën dhe procesin e arritjes së një bashkëpunimi dhe binjakëzimi me komunën e Meranos. Ky binjakëzim, do ta nxiste zonën e Dibrës që shumë modele zhvillimi të kësaj komune të jenë të mundura të replikohen dhe në zonën e Dibrës.

#### 2. Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)

**Objektivi i përgjithshëm:** Të ngrihet në nivel më të lartë qeverisja e mirë në zonën e Dibrës, duke stimuluar bashkëpunimin me vende te EU .

**Objektivi specifik:** Të punohet për sigurimin e binjakëzimit mes bashkisë së Dibrës dhe komunës së Meranos në Itali, si një process i gjerë bashkëpunimi mes aktorëve të dy njëjësive si administrata e qeverisjes vendore, shoqëria civile dhe sidomos sektori privat dhe në vecanti fermerët dhe bizneset e turizmit, brenda viti 2016.

#### 3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit(maks. 5-6 rreshta)

**Rezultati I pritshëm 1:** Dialogu mes përfaqësuesve të dy NJQV (komuna e Meranos dhe Bashkia Dibër) është dinamik dhe rezultativ, mbështetur në kanale të sigurta negociimi dhe institucionale.

**Rezultati I pritshëm 2:** Marrëveshja e binjakëzimit e nënshkruar dhe funksionale, me principe dhe objektiva të pranuar dhe me program aktivitetesh të përcaktuara, dhe institucion përgjegjës me detyrë për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

#### 4. Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)

Nr	Plani aktiviteteve	Periudha kohore			
		4-mujori I parë		4-mujori dytë	
	Pozicionim dhe negociim me komunën e Meranos				
1	Kontakte me shoqatat e emigrantëve. Marrja e mbështetjes së tyre				
2	Kontakte me Shoqatat e fermerëve të Meranos.				
3	Kontakte me përfaqësuesit institucional të Komunës së Meranos				
4	Takim me autoritetet diplomatike të shtetit Shqiptarë në Itali				
5	Takim I organizuar I një grupi të aktorëve të Dibrës në Merano				
6	Takim I organizuar I një grupi nga Merano në Dibër				
7	Hartimi I draftit dhe pikave të marrëveshjes së binjakëzimit, në përputhje me standartet profesionale dhe ligjore.				
8	Nënshkrimi I marrëveshjes				

#### 5. Pjekuria e projektit (5-6 lines)

Bazuar në ligjin e funksionimit të Pushtetit lokal, lidhja e marrëveshjes me organizma të huaja dhe vendase në formën e binjakëzimit janë funksione ligjore të NJQV. Ka disa eksperiencë pozitive në Shqipëri të këtyre marrëveshjeve, si dhe një praktikë e finalizuar e bashkisë Peshkopisë më një komunë në Danimarkë. Ngjashmëritë gjeografike, orientimi bujqësor në frutikulturë dhe sidomos tek molla, dhe komuniteti i madh dibran që jeton dhe punon në Merano, e bëjnë këtë marrëveshje funksionale.

#### 6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)

Aktori kryesor është Bashkia e ardhshme e Dibrës, e cila ka kompetencat dhe përgjegjësinë për realizimin e kësaj marrëveshjeje. Bashkëpunëtorë të ngushtë do të jetë Shoqata e Dibranëve të Meranos, dhe konsullata shqiptare në Itali, si dhe përfaqësuesi I ambasadës Italiane në Shqipëri.

#### 7. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)

Kostot totale të projekti janë rreth 15,000 Euro që do të mbulohen nga fondet e Bashkisë.

## Projekti 2:

<b>Titulli i projektit</b>	<i>Dixhitalizimi I shërbimeve të NJV në zonën funksionale.</i>
<b>Tipi i projektit</b>	<i>Projekte që mobilizohen shpejt</i>
<b>Vendndodhja e projektit</b>	<i>NJV e zonës funksionale</i>
<b>Buxheti total i paravlerësuar</b>	<i>100,000 Euro</i>

### 1. Sfondi dhe analiza e problemit.

Bazuar në ligjin 8652 “mbi organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Vendorë në Shqipëri”, NJQV kryejnë këto funksione kryesore në zonën tyre që lidhen me: i) Infrastrukturën dhe shërbimet publike; ii) shërbimet me karakter social, sportiv dhe kulturor; iii) zhvillimet me karakter ekonomik vendor; dhe, iv) mbrotja e sigurisë civile.

Me mbulimin me shërbime të të gjithë territorit të zonës funksionale, përgjegjësia e NJV do të rritet për të siguruar shërbime konkrete dhe në kohë reale për qytetarët e njësisë së madhe. Aktualisht ekziston zyra e informimit të qytetarëve por akses i informacionit do bëhet shumë më i vështirë për banorët e zonave të largëta të NJV aktuale. Dixhitalizimi I informacionit aktualisht mungon fare në Bashkinë Peshkopi dhe njësitë e tjera vendore, dhe ky projekt synon këtë lloj ndërhyrjeje për ta sjellë njësinë vendore më afër qytetarëve dhe për t'i dhënë mundësinë stafit të NJV të marrë vendime korrekte dhe eficiente.

Duke parë kompleksitetin e detyrave, NJQV-së I nevojitet një sistem që të unifikojë ofrimin e shërbimeve në kohë reale.

Projekti synon zhvillimin / implementimin e një sistemi **GDi Localis** që ofron zgjidhje GIS të bazuar në WEB të konfigurueshme, të përshtatura për Cloud, të zhvilluara posaçërisht për përmirësimin dhe mbështetjen e proceseve dhe operacioneve të E-Government. Ky sistem ndihmon në kapërcimin e shumë vështirësive në veprimtarinë e qeverisjes vendore, duke mbajtur kostot e implementimit në nivele optimale. Zgjidhjet GDi LOCALIS mbulojnë një gamë të gjerë të veprimtarive Qeveri - Qeveri dhe Qeveri – Qytetar, përfshirë menaxhimin e lejeve, planifikimin urban, menaxhimi i hapësirave të gjelbra, ndriçimi publik, shërbimet publike, forum për pjesëmarrjen e qytetarëve, menaxhimin e rrugëve, dhe shumë të tjera.

### 2. Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)

Objektivat e këtij projekti janë:

- Të përmirësohet shpejtësia dhe cilësia e shërbimeve të ofruara nga NJV e zonës funksionale për qytetarët dhe duke rritur kënaqësinë e tyre.
- Të rritet transparenca e aktiviteteve të administratës së NJV-së duke zvogëluar pakënaqësitë dhe numrin e ankesave të publikut si dhe rritjen e cilësisë dhe shpejtësinë.
- Përmirësimi i kushteve të funksionimit të punonjësve të administratës së NJV-së duke ju krijuar mundësinë për të punuar më shpejt, lehtë, me më shumë efikasitet, me organizim më të mirë dhe duke nxitur në këtë mënyrë motivimin.

### **3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit (maks. 5-6 rreshta)**

Ngritja dhe vënia në funksionim i sistemit on line do sigurojë shërbime cilësore dhe në kohë reale për të gjithë qytetarët e zonës funksionale pra përfitues do të jenë 82,668 banorët e zonës funksionale. Projekti do të zbatohet nga NJV e madhe, dhe përfitues janë të 15 NJV ekzistuese. Instalimi dhe implementimi i këtij sistemi do të ofrojë:

- Përshpejton procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje;
- Ofron shërbim publik më kompetent për publikun;
- Zbulon lehtësisht fitimet dhe të ardhurat;
- Vendos një ndërveprim të hapur dhe transparent me qytetarët;
- Rrit efikasitetin në funksionimin e infrastrukturës publike të qeverisjes vendore;
- Ndjek shpenzimet në mënyrë transparente dhe planifikon mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra dhe rrugëve.
- Përshpejton procesin e zbulimit të defekteve ose keqfunksionimeve në infrastrukturë.

### **4. Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)**

Aktivitetet e projektit synojnë në:

- Identifikimi i nevojave / features që do të përcaktohen në sistemin online
- Implementimi i programit
- Trajnimi i personelit të administratës së NJV-së
- Udatimi me informacionet përkatëse dhe bërja funksionale e sistemit duke e bërë pjesë të praktikës së funksionimit për NJV

### **5. Pjekuria e projektit (5-6 lines)**

Projekti është një projekt ide. Mund të aplikohet branda vitit me kohëzgjatje 3 muaj për ngritjen dhe vënien në funksionim.

Ky sistem është aplikuar në shumë qytete të tjera jashtë Shqipërisë.

Gdi Localis është produkt i ESRIT dhe mund të përshtatet sipas nevojave specifike të NJV, bazuar në veçoritë dhe kërkesat specifike të saj

### **6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)**

Ky është një projekt i shpejtë. Projekti do të zbatohet nga NJV e zonës funksionale. Njësia vendore mund ta blejë me burimet e veta sistemin. Donatorë i mundshëm është European Union.

### **7. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)**

Blerje dhe vënie në funksionim i sistemit – 30,000 Euro

Krijimi i features të reja sipas karakteristikës së NJV – 20,000 Euro

Licensa përdorimi – 20,000 Euro

Blerje kompjuterash – 10,000 Euro

Trajnime – 10,000 Euro

Mirembajtje – 10,000 Euro

### Projekti 3:

<b>Titulli i projektit</b>	<i>Riorganizimi I QEK (Qendra e Edukimit dhe Komunikimit).</i>
<b>Tipi i projektit</b>	<i>Projekte që mobilizohen shpejt</i>
<b>Vendndodhja e projektit</b>	<i>Bashkia Peshkopi</i>
<b>Buxheti total i paravlerësuar</b>	<i>Vendos shumën</i>

#### 1. Sfondi dhe analiza e problemit.

QEK (Qendra e Edukimit dhe Komunikimit) është një nga ambjentet dhe institucionet më të bukura dhe interesante në Peshkopi. Kjo qendër është krijuar nga mbështetja e DANIDA-s si qendër që do të shërbejë komunitetin për Zhvillimin social, duke krijuar ambjentin e përshtatshëm për edukimin, komunikimin e grupeve të ndryshme, zhvillimin e medias lokale, nxitjen e dialogut të pushtetit lokal me komunitetin, etj. Grupi kryesor i synuar në këtë qendër janë të rinjtë, gratë, intelektualët, shoqëria civile dhe grupet komunitare. Qendra ja ka arritur të përmbushë misionin e saj jo vetëm me mbështetjen e DANIDA-s por edhe pas saj, pasi kishte hapësira për gjenerim të ardhurash sidomos nga dhënia me qera e ambjenteve të saj për aktivitete të ndryshme.

Buxhetet e kufizuara të bashkisë, pengesat ligjore sidomos në aspektin e taksave dhe konkurrenca në rritje nga sektori privat, kanë bërë që QEK ta humbasë vitalitetin e funksionit të tij duke ju reduktuar hapësirat për gjenerim të ardhurash sidomos nga qeratat, mos funksionimin e Bordit drejtues, shkurtimi i stafit, dhënia me qera e një pjesë të ambjenteve të cilat nuk gjeneruan vlerë të shtuar në aktivizimin e qendrës, dhe një shkëputje dhe izolimin nga grupet e interesit duke e ulur numrin e aktiviteteve dhe duke u kthyer një institucion që rëndon në buxhetin e bashkisë, dhe pa sjellë ndonjë përfitim social apo ekonomik.

Riorganizimi I QEK, duke vënë në funksion organet drejtuese dhe duke u hapur me grupet e interesit dhe tentuar të fusin ide dhe mjete inovative të thjeshta do të bënin QEK një qendër të rëndësishme për zonën Funksionale të Dibrës dhe komunitetin Dibran.

#### 2. Objektivi/at specifikë të projektit (maks. 4-5 rreshta)

**Objektivi i përgjithshëm;** Krijimi i mundësive për demokratizimin e shoqërisë dibrane, duke krijuar hapësirën dhe lehtësirat e nevojshme për komunitetin dibran, rininë, gratë, shoqërinë civile, median, që të ushtrojnë misionin e tyre.

**Objektivi specifik:** Riorganizimi I QEK, me një platformë, program, organe drejtuese, sistem menaxherial dhe riorganizim të hapësirave të objektit në funksion të nismave dhe iniciativave të grupeve të interesit (rininë, gruan, shoqërinë civile, media, grupet komunitare) të cilat kanë dalë nga një proces i hapur dialogues ndërmjet tyre, brenda vitit 2015.

#### 3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit(maks. 5-6 rreshta)

**Rezultati i pritshëm 1:** QEK ka zgjedhur organet drejtuese dhe ka hartuar programin 1-vjeçar të aktiviteteve me pjesëmarrjen aktive të grupeve të interesit.

**Rezultati i pritshëm 2:** Grupet Komunitare, OJF, Rinia, Gratë, media zhvillojnë aktivitetet në QEK dhe kanë hapësirat e duhura.

#### 4. Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)

Nr	Aktivitetet	Periudha kohore		
		1/3 viti	1/3 vitit	1/3 vitit
1	Zgjedhja e organeve drejtuse			
2	Hartimi i planit vjetor me pjesëmarrjen e grupeve të interesit			
3	Akomodimi i OJF (që nuk kanë zyra dhe kanë nga një vend pune) dhe medias në ambjentet e QEK			
4	Hapja e kurseve artistike në QEK			
5	Aktivitete rinore (individuale, grupe te vogla, grupe të mesme dhe grupe të mëdha) organizohen cdo javë në QEK			
6	Aktivitete për shoqërinë civile, debate publike, konferenca shkencore dhe studime të ndryshme, takime me intelektuale, promovime librash, ngjarje historike, figura të shquara etj, mbahen në ambjentet e QEK			
7	Konkurse, ekspozita dhe panairë			
8	Fond konkurues për aktivitete të vënë në dispozicion nga Bashkia.			

#### 5. Pjekuria e projektit (5-6 lines)

Qendra është eksperiencë Daneze nga DANIDA. Gjithashtu ajo ka punuar dhe me SNV dhe programin CARDS. Modelet dhe udhëzimet janë aktuale, si dhe hapësirat e duhura si dhe njerëz që kanë punuar dhe punojnë për qendrën.

#### 6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)

Burimet e Financimit do të jepen nga Bashkia, pasi aktualisht ajo mbulon pagat e personelit dhe shpenzimet për mirëmbajtjen dhe funksionimin e godinës, pasi Qendra është pjesë organike e bashkisë. Për shumë aktivitete dhe për një projekt mund të gjenden dhe donatorë të ndryshëm që kanë në fokus demokratizimin, pjesëmarrjen qytetare dhe çështjet sociale.

#### 7. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)

Kostoja e projektit: 15,000 Euro

## 9. Analiza dhe rekomandimet për organizimin e NJësive të reja Vendore

### 9.1 Organizimi vendor dhe struktura e personelit

Zona Funktionale e Dibrës aktualisht ka 15 NJQV (Njësi të Qeverisjes Vendore) nga të cilat 14 janë komuna dhe 1 Bashki, që është bashki qendër qarku për Dibrën. Organizimi dhe funksionet e strukturës së NJQV përcaktohet nga ligji 8652 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale”, dhe ku përcaktohen qartë organet vendimarrëse që janë këshillat vendore dhe struktura administrative që emërohet nga kryetari që zgjidhet nga populli.

NJQV	Peshkopi	Tomnin	Maqëllarë	Melan	Kastriot	F.Cidhen	Silove	Kala e Dodes	rec	Dardhe	Lure	Arras	Muhurr	Selishte	Luzni	Totali
Këshillat Vendore	17	15	15	13	15	13	13	13	13	13	13	13	13	13	13	205

Pothuajse të gjitha NJQV paraqesin strukturën e organizimit të administratës në Këshillin vendor. Administratat janë të organizuara mbi bazë zyrash ose seksione, ku cdo zyrë ose seksion mund të ketë disa funksione, dhe personeli i përgjigjet detyrës funksionale të atij pozicioni. Në tabelën e mëposhtme është organizimi i vendorë në zonën e Dibrës. Në tabelë janë dhënë zyrat/seksionet për 15-të NJQV-të në zonën e Dibrës.


	Peshkopi	Tomnin	Maqëllarë	Melan	Kastriot	F.Cidhen	Silove	Kala e Dodes	rec	Dardhe	Lure	Arras	Muhurr	Selishte	Luzni
Kabineti kryetarit	7	3	3	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
Burimet Njerzore	3	1	1	1	1										
Kultura, arsim, komunikim.	3	1	1	1	1	1	1					1	1		
Financa dhe buxheti	5	3	3	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
Programim zhvillim	3														
Urbanistika	3														
Shërbimet dhe mjedisi	3	5	5	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3
Insp. Ndertimi	2														
Administrimi I pronave	3														
Të ardhurat lokale	3		2	1									1		
Shëndetsia/bujqësi dhe kontrolli ushqimit	3	1	3	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1



Ndihma ekonomike	5	3	3	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
Auditi I brenshem	2														
Policia vendore	8	2	2	1											
Sektorët mbështetës dhe ndihmës	25	2	1	1	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
Shërbimet komunale, Pastrim gjelberim	61														
Cerdhe, konvikte	68														
Drejtoria e Sportit	13														
Drejtoria e Kultures	25														
Gjendja civile	2	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
QKR	2														
<b>Totali</b>	<b>249</b>	<b>22</b>	<b>22</b>	<b>16</b>	<b>16</b>	<b>16</b>	<b>18</b>	<b>15</b>	<b>15</b>	<b>15</b>	<b>15</b>	<b>16</b>	<b>16</b>	<b>15</b>	<b>15</b>

Sic shikohet nga tabela janë gjithsej 481 punonjës që punojnë në administratën e NJQV në zonën e Dibrës, për 15 NJQV. Për bazë janë marrë seksionet dhe drejtoritë në Bashkinë Peshkopi, e cila ka shume seksione pasi mbulon dhe shumë shërbime publike sic janë çerdhet, konviktet, sporti, kultura, muzeu, biblioteka, etj., dhe ku janë të punësuar 249 punonjës ose 51.7% e administratës lokale në nivel zone funksionale. Në zonat rurale (në nivel komune) struktra pothuajse është e njëjtë, vetëm ndryshon numri I punonjësve sipas madhësisë së Njesisë, dhe janë dhë në ato zyra që jepen në tabelë.

Në zonat rurale, në seksionin/zyrën e kontrollit ushqimor dhe veterinar që është në bashki, në komuna kemi edhe stafin përgjegjës për bujqësinë, dhe ku janë të punësuar rreth 232 punonjës, ose 38.2% në nivel të zonës funksionale. Shih në figurën më poshtë.



Zyrat dhe godinat e NJQV janë vendosur në qendrat e banuara. Në përgjithësi zyrat janë në kushte optimale për punën e administratës së NJQV, ku më moderne janë zyrat e bashkisë

Peshkopi. Specifike për NJQV e zonës së Dibrës është që komuna e Maqellarës nuk ka zyra të saj, ajo I mban ambjentet me qera.

NJQV në Dibër kanë qenë të angazhuara dhe të hapura për të stimuluar dhe mbështetur zhvillimin e kapaciteteve të stafit të tyre. Kështu ata kanë qenë aktivë dhe të hapur me bashkëpunimin me NGO dhe projekte të cilat kanë në fokus zhvillimin e kapaciteteve. Një pozicionim të mirë në zonën e Dibrës kanë me projekte Eorld Vision, AgritraVizion, CNVP, ANTTARC, USAID, dhe disa organizata dhe projekte të Komisionit European me fondet cross-border, dhe SIDA për fonde në zhvillimin rural dhe mjedisit.

## **9.2 Menaxhimi i shërbimeve publike në Njësitë Aktuale Vendore.**

### **- Sistemi i ujit të pijshëm:**

Sistemi i ujit të pijshëm dhe KUZ është problematik në Dibër pasi ky shërbim nuk mbulon një pjesë të konsiderueshme të popullsisë 83.5 për KUZ dhe 39% me ujin e pijshëm. Cilësi e dobët e shërbimit, si në kohën e furnizimit më ujë ashtu dhe në shërbimin ndaj klientit. Mesatarisht në Dibër nuk ka më shumë se 4-8 orë ujë në ditë. Humbje të larta në rrjet, përshkak të amortizimit të tubacione, cilësisë së dobët së mirëmbajtjes, sistemit të gabuar të menaxhimit-shpërndarjes, dhe ndërhyrjeve ilegale në rrjet sidomos në periudhën e verës. Mungesa e matësve në shumicën e lidhjeve dhe dëmtimi I atyre matësve në pikat që janë vendosur, tregon për një keq-administrim të këtij procesi nga strukturat e NJQV dhe Ndërmarjes së ujësjellësit në Peshkopi. \

Mungesa e Investimeve, apo investime të gabuara ka bërë që të kemi zona që nuk kanë ujësjellës, ose të shkojmë në zgjidhje komunitare me linja ujësjellësish në baze lagje dhe fshati pa përdorur kriteret teknike. Ka pasur raste të investimeve të gabuara si pasojë e zgjidhjeve teknike dhe menaxheriale të gabuara sic është rasti I ujësjellësit të Peshkopisë me burimet ujore nga lumi Drin dhe I ujësjellësit të Maqellarës me sistem pompimi po nga Lumi Drin, investime të cilat dështuan. Konfliktualiteti I lartë social dhe për pronësinë është bërë pengesë për investime dhe për realizimin e disa ujësjellësve, ku më I madhi është mos-funksionimi I ujësjellësit të Luznisë (I ndërtuar më 1997-1998) që është 15km dhe u shërben banorëve të 3 NJQV. Mungesa e aftësisë për zgjidhjen e konflikteve sociale, ligjore dhe të pronësisë ka bërë që shumë projekte apo investime të dështojnë apo mos fillojnë.

Menaxhimi I ujit të pijshëm është bërë nga NJQV dhe Ndërmarja e Ujësjellësit në Peshkopi. Komunitat kanë nga 1 ose 2 persona që meren me menaxhimin e ujit të pijshëm, kryesisht për aspektin teknik dhe në supervizimin e orarit të ujit. Në shumë raste ky shërbim nga komunitat është deleguar ky shërbim edhe tek këshillat e fshatrave. Ndërmarja e ujësjellësit të Peshkopisë ka rreth 28 persona të punësuar, kryesisht administradë shë staf teknik. Si të gjithë ndërmarjet edhe kjo ndërmarje ka statusin e SHA, dhe mnaxhohet nga Asambleja e ëprbërë me perfaqësues nga 6 NJQV. Gjithsej në sektorin e ujit të pijshëm janë të punësuar rreth 48 punonjës për zonën funksionale të Dibrës.

**- Rrugët dhe transporti publik:**

Zona e Dibrës ka një akses të vështirë e të kufizuar në rrjetet infrastrukturore kryesore të vendit përfshirë Kryeqytetin, Portet e Aeroportin. Megjithëse jo shumë km për të udhëtuar për në Dibër të duhen jo më pak se 5 orë udhëtim për të arritur në Peshkopi. Mungojnë investimet serioze në këtë aks rrugor, segmentet rrugore që kanë filluar ose përfunduar janë jo të projektuara mirë dhe jo në standarte teknike. Projekti në vijim i ndërtimit të rrugës së Arbrit i hap një mundësi shumë të rëndësishme zhvillimit të zonës në lidhje me aksesin shumë të shpejtë në tregjet kombëtare dhe rajonale.

Pjesa qendrore e ZF Dibër (Peshkopia dhe komunat përreth) komunikojnë me një rrjet rrugor të asfaltuar së fundmi dhe relativisht në gjendje të mirë. Ky rrjet i shërben edhe prodhimtarisë bujqësore në zonë e transportit të produkteve. Asfaltimi i rrugës drejt Kukësit hap edhe perspektivën e zhvillimit të turizmit malor rreth malit të Korabit.

Rrugët rajonale dhe lokale rurale (nga 25-40km) nuk janë në nivelin e duhur, sidomos rrugët që lidhin Peshkopinë me zonën turistike të Lurës, Recit, Selishtës, Zall-Dardhës, Arrasit duke krijuar kështu zona periferike të largëta, të pazhvilluara, të vështira për tu mbuluar me shërbime dhe të pa-kontrolluara nga dëmtuesit e pyjeve dhe florës e faunës në përgjithësi.

Transporti publik në zonën e Dibrës me Tiranën bëhet vetëm me furgonë, sistem i rregulluar sipas standarteve, kushteve dhe procedurave të vendosura në Ministria e Linjës. Në çdo orar nga ora 5:30 deri në orën 15:00 mund të lëvizësh në këtë itinerar.

Kushtet e transportit publik janë të pranueshme, por për transportin brenda zonës funksionale të Dibres paraqitet vështirësi në lëvizjen në Lurë që mungon fare (Lurë-Tiranë lëviz nga Kurbneshi), dhe ke mundësi lëvizje dy herë në ditë (vetëm 1 herë vajtje – ardhje) për komunat Rec, Zall-Dardhë, Kala e Dodës, Sllövë, Selishtë, Arras. Kapaciteti teknik dhe financiar për mirëmbajtje dhe investim në sistemin e rrugëve lokale është i dobët dhe i pa-përballueshëm nga buxhetet e Njësisve Qeverisjes Vendore, kjo ndikon në gjendjen e keqe të këtyre rrugëve.

Rrugët rajonale janë në inventarin e Ndërmarrjes së Rrugëve Rurale që është në varësi të Këshillit të Qarku Dibër. Në varësi të kësaj ndërmarrje për zonën e Dibrës janë gjithsej 72 km nga të cilat 3 km të asfaltuara dhe 69 km të pa-asfaltuara. Ndërmarrja e Rrugëve për zonën e Dibrës ka një buxhet prej 7.2 milion Leke, (afërsisht 100 mijë leke per km) dhe janë të punësuar 36 punëtorë (1 punëtorë për 2km). Mbikqyren nga një supervisor i cili mbikqyrur 30 punëtorë. Mirëmbajtja është përgjithësisht e nivelit të mbajtjes së rrugëve të hapura në gjendja të kalueshme. Gjithashtu zhvillohet edhe mirëmbajtje periodike (p.sh riveshje e shtresave , riparime në vepra arti, apo vetëm pastrim kanalesh , tombinosh , hedhje cakulli) etj.

	Të asfaltuara/Km	Pa-asfaltuara/Km	Buxheti ne vit në AL
Rrugë Nacionale	60	49	40,000,000
Rrugë Rajonale	3	69	7,200,000
Rruge lokale	82	486	12,000,000
Totali	145	594	59,200,00

Siç shihet dhe nga tabela, janë gjithsej 739 km rrugë në NJQV e Dibrës (145 km me asfalt dhe 594 km pa-asfalt). Përsa I përket menaxhimit të rrugëve për të 3 kategoritë e rrugëve, janë ndërmrjet përkatëse dhe sektorët e shërbimeve në NJQV përgjegjëse për mirëmbajtjen e tyre. Janë rreth 59, 200,000 Lekë që harxhohen për mirëmbajtjen e rrugëve në zonën e Dibrës. Por vetëm për rrugët lokale dhe rajonale janë 21, 200,000 lekë ndërsa 40,000,000leke janë për rrugët nacionale që janë në varësi të Drejtorisë së përgjithshme të rrugëve dhe menaxhohen nga drejtoria rajonale e rrugëve nacionale. Rrugët rajonale dhe lokale për mirëmbajtjen dhe pastrimin nga bora kontraktohen kompani të specializuara të cilat kanë makineritë e duhura për të bërë këtë punë ose për të bërë ndërhyrjen në rehabilitimin e tyre, si dhe kanë dhe personelin që varen nga sektori I shërbimeve në NJQV dhe Drejtoria e Rrugëve Rurale, që është në varësi të Këshillit të Qarkut, ku vetëm për Zonën

#### - **Menaxhimi I mbetjeve:**

Menaxhimi I mbetjeve në zonën e Dibrës kryhet në 8 NJQV por menaxhimin e mirëfilltë e kryen vetëm në Bashkinë e Peshkopisë, dhe ku një numër I konsiderueshëm I familjeve në Dibër nuk e marrin këtë shërbim, vetëm 23.6% e familjeve kanë akses në mbledhjen e mbeturinave. Sasia e mbeturinave në zonën e Dibrës është 14160 Ton mbetje urbane dhe 2976 Ton mbetje inerte, ose 2.4 kg mbeturina në ditë për cdo familje. Cilësia e ulët e nivelit të shërbimit të pastrimit në Dibër është për faktin që mungojnë koshat në shumë pika, cilësi e dobët e koshave dhe në ato pika që janë, dhe makineritë që përdoren për transport nuk janë për këte shërbim. Janë gjithsej 197 kosha/pika grumbullimi (1m3) dhe 8 kamione dhe 2 traktore per transportin e mbetjeve.

Depozitimi i mbeturinave është një problem i madh pasi nuk ka vende të posaçme dhe me standarte për fushat e depozitimit të mbetjeve, ku vetëm bashkia e Peshkopisë ka një Fushe depozitimi jo me kriteret teknike dhe ku depozitohen dhe mbeturinat e 3 njësive të tjera, dhe ku mbeturinat digjen duke ndotur ajrin dhe ujërat që dalin nga kjo fushë ndotin përroit e Dohoshishtit. Në komunat e tjera ato hidhen buzë përrenjve dhe lumenjve, jashtë cdo standarti dhe kriteri. Fusha e depozitimit është ndërtuar në 2003 dhe ka qenë planifikuar për një kapacitet mujor prej 33Ton mbeturina dhe aktualisht depozitohen më shumë se 50 ton (45 ton vetem Peshkopia) mbeturina në muaj.

Menaxhimi mbetjeve bëhet nga vetë NJQV të cilat kanë angazhuar brigadeta dhe personel që janë në strukturën e NJQV dhe janë gjithsej 61 persona. Në 8 Komunitat që ofrojnë këtë shërbim është i punësuar vetëm 1 person, i cili është përgjegjës për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve. Në bashkinë Peshkopi është një brigadë e posaçme që merret me këtë proces. Janë gjithsej 61 të punësuar nga të cilët 10 janë në administratë, 6 për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve, 4 janë në fushën e depozitimit, 22 janë në pastrimin dhe fshirjen e rrugëve, 14 janë në gjelbërim dhe dekor. Pra sic shikohet janë 51 persona të punësuar për 20,000 banorë.

Kostoja e mbledhur nga tarifa e pastrimit mbulon vetëm 32.3% të buxhetit që harxhohet nga NJQV-të për këtë shërbim. Të gjitha NJQV harxhojnë pjesën më të madhe nga të ardhurat e tyre për të mbuluar këtë shërbim. Buxheti i harxhuar është 25,392,000 ALL dhe arkëtimi nga tarifa është 8,206,040 ALL.

Kostoja e shpenzimit për një banorë është rreth 1587 ALL për çdo familje dhe arkëtohet nga çdo familje 513 ALL në vit. Ndërsa në bashkinë Peshkopi që mbulon 100% të familjeve kostoja është 3925 ALL.

### **9.3 Procesi konsultimi/diskutimi me administratën e Njësive Vendore kryesore**

Pas kryerjes së dy analizave më sipër (deskwork nga informacioni i mbledhur deri tani), u organizua një workshop me përfaqësues nga:

- Administrata e Njësive Vendore qendër dhe e administratave të Njësive kryesore aktuale.
- Përfaqësues në nivel drejtuesi teknik të Kompanive Private apo Publike që kryejnë në terren shërbimet kryesore publike

Me to u diskutuan gjetjet e analizave, sqarohen çështje të paqarta dhe diskutohen rekomandime të mundshme për organizimin e administratës dhe shërbimeve në njësinë e re vendore.

### **9.4 Identifikimi i rekomandimeve për strukturën organizativetë njësisë së re administrative**

Analiza nisët nga organograma e njësisë aktuale vendore qendër e ZF duke vënë në pah ndryshimet e propozuara në organizimin e Njësive së Re.

Rekomandimet përfshijnë krijimin, bashkimin, shkrirjen e departamenteve të njësisë re për t'iu përgjigjur funksioneve që do të mbulojë Njësia e re dhe në veçanti nevojave për t'iu përgjigjur zbatimit të FAP (p.sh një rol më aktiv në çështje të zhvillimit ekonomik).

Struktura e re e FAP do të mbështetet në strukturat ekzistuese të NJQV, duke marrë për bazë bashkinë e Peshkopisë dhe duke e plotësuar me strukturën tipike të komunave, duke integruar strukturat e mëparshme dhe duke ju përgjigjur funksioneve.

Kështu në konceptin makro, FAP do të ketë një organizim në departamente, që lidhen me funksionet bazë kryesore dhe menaxherë që përbëjnë strukturën menaxhuese të FAP ose NJQV së ardhshme. Departamentet lidhen me menaxhimin financiar, shërbimet, planifikimin hapsinor dhe menaxhimin e tokës, zhvillimin ekonomik, zhvillimin social dhe edukimin.

Çdo departament ka disa sektorë, që lidhen me funksionet dhe një numër të konsiderueshëm personeli të specializuar dhe në përmbushje të funksionit të sektorit dhe detyrave të përcaktuara për postin dhe pozicionin që mbajnë. Çdo sektorë lidhet me seksionet ekzistuese në bashkinë e Peshkopisë dhe ka të shtuara funksione për sektorë që kanë qenë karakteristikë e komunave dhe territorit ruralë.

Në FAP ose NJQV e ardhshme do të shtohen disa departamente që i përgjigjen integritit të funksioneve të njësisë së një e tërë. Kështu propozojmë të ngrihet departamenti I zhvillimit ekonomik që lidhet me Bujqësinë, kontrollin e ushqimit/veterinar, si dhe turizmin. Një

strukturim do të marrin dhe shumë departamente të tjera të cilat lidhen jo vetëm me çështjet por edhe me funksionet ekzistuese për të harmonizuar kordinimin dhe administrimin më të mirë të njësisë së ardhshme si brenda strukturës dhe me aktorët e tjerë. Në shumë departamente megjithëse janë të njëjtat sektorë duhet të shtohet numri I punonjësve për shkak të shtimit të gamës së shërbimit në një territor më të madh dhe numrit të objekteve.

Një kujdes i vecantë do ti kushtohet zhvillimit social I cili integron disa drejtori dhe shërbime ekzistuese që lidhen me asistencën sociale, kulturën dhe sportin, jo vetem si çështje sociale por dhe si zhvillimin I vitalitetit të jetes sociale në zonën e FAP të Dibrës.

Risi e re e strukturës administrative është menaxheri I Bashkisë I cili ka disa sektorë të rëndësishëm që lidhen si me jetën e komunitetit në gjithë Zonën, por dhe me mbarëvatjen e administrimit të NJQV dhe me marrëdhëniet me të tretët dhe thithjen e fondeve. Një strukturë e posacme do të jetë Njësia e projekteve që do të merret me hartimin e projekteve dhe ndjekjen e cklit të projekteve dhe programeve. Gjithahstu këtu është dhe njësia e kordinimit më administratorët e komunave. Në këtë strukturë do të jenë disa sektorë që lidhen si me monitorim dhe auditin, sigurinë publike/policia bashkiake, zyra e informimit me publikun, IT dhe statistika, të cilat kanë funksione të pavarura dhe në shërbim të gjithë qeverisjes lokale. Gjithahstu nga kjo strukturë do të menaxhohet dhe funksionet e deleguara që janë QKR+QKL dhe Gjendja civile. Më shumë shiko në skemën menaxheriale.

## **9.5 Integrimi i shërbimeve publike kryesore në Njësinë e Re si një nga fushat kryesore të zbatimit të FAP dhe ndikimin që këto kanë në organizimin e Njesisë së re Vendore**

*Departamenti i Shërbimeve* do të jetë i vecantë. Në këtë departament sugjerohet të ketë disa sektorë që lidhen me disa shërbime publike bazë, si sektori I Menaxhimit të Mbetjeve, sektori I Ujit të Pijshëm, sektori I shërbimeve komunale dhe sektori I Rrugëve.

Cdo sektor ka detyrat dhe funksionet e tij që përcaktohen mbi bazë të natyrës së shërbimit, dhe stafin përkatës që ka të ëprcaktuara detyrat dhe profilin e punës. Struktura menaxhuse do të ketë menaxherin/përgjegjës të sektorit, stafin administrativ dhe stfin teknik që përbëhet nga specialistë të shërbimit përkatës.

Në ZF të Dibrës, sektori I Menaxhimit të mbetjeve, do të jetë ëprgijgjës për menaxhimin e gjithë ciklit të menaxhimit të mbetjeve duke filluar me pastrimin, grumbullimin, trasportimin dhe depozitim në fushën ekzistuese. Në të ardhmen, sugjerohet të ndërtohet një fushë e re në përroin e Kabe, afër Kubenit, dhe cikli I menaxhimit të zbatojë standartin ekzistues të bashkisë Peshkopisë, dhe strukturën e njëjtë menaxheriale duke shtuar dhe asetet e 8 komunave që kryejnë pjesërisht këtë shërbim. Të hartohet plani I menaxhimit të mbetjeve, dhe të fillojë puna me strukturën ekzistuese duke e mbajtur pastrimin me brigadën e pastrimit dhe me mjetet që ka bashkia në dispozicion. Të hartohet një program paraprak ku të shtohet shërbimi dhe në zonën

rurale, fillimisht duke hartuar një program javor, dhe të mbahet një staf ekzistues prej 51 personash.

*Menaxhimi I ujit të pijshëm* të ketë si organ përgjegjës strukturën e sektorit të KUZ, ku të ketë të integruar ndërmrjen e Ujësjellësit të peshkopisë dhe ujësjellësat në komunat përkatëse, ku të integrojnë personlin ekzistues dhe praktikën e krijuar me një praktikë të re pune. Kjo strukturë si hap të parë të bëjë inventarizimin e ujësjellësve ekzistues, të aseteve si dhe të bëjë një vlerësim të situatës aktuale për cdo lagje, fshat, dhe qendër urbane. Të hartojë një plan veprimi të shkurtër në kohë, dhe të programojë menaxhimin e punës duke pasur parasysh linjat dhe mënyrën aktuale të menaxhimit të ujit. Sugjerohet që të ndahet puna e stafit teknik në pjesën e ujësjellësve dhe pjesën e linjave të fshatrave si dy nën/sectorë, dhe të ketë një praktikë për pjesën e trajtimit kimik të ujit. Sektori do të ketë pjesën menaxheriale, administrative dhe stafin teknik. Nga situata aktuale më integrimin e shërbimit duhet të jenë reth 48 punonjës në këtë sektorë.

*Sektori I rrugëve*, që do të jetë nën administrimin e NJQV së ardhshme, do të vazhdojë të përdorë të njëjtën praktikë që kanë bërë NJQV aktuale, duke u përgjigjur për mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe investimeve në to. Duhet të pritët se çfarë do të ndodhë me rrugët rajonale që janë në varësi të Qarkut, por sugjerojmë që ato të jenë në varësi të NJQV së ardhshme, pasi lidhet direkt me interesin e komunitetit të tij. Këhstu që buxheti aktual, asetet dhe personeli duhet të jetë I plotë për këtë sektorë. Sugjerojmë që ky sektorë të dnahet në Rrugë të asfaltuara, dhe në rrugë më zhavor pasi dhe procesi I mirëmbajtjes do të jetë I ndryshëm. Sektori duhet të ketë stafin menaxherial, administrativ dhe stafin teknik dhe punëtorët që të paktën duhet të jenë 100-150 punëtorë (1 punëtorë për 4 km rrugë).

*Sektori I shërbimeve komunale*, kryesisht ky sektorë do të merret me shërbimet për sistemin e kanalizimeve (të bardha dhe të zeza), pusetave, ndricimi rrugor, mirëmbajtjen e banesave etj. Sugjerohët që ky sektorë edhe mund të shkrihet me sektorë të tjerë duke ju ëprcaktuar funksione shtesë si tek menaxhimi mbetjeve, sektori I ujësjellësit, apo sektori I bazës ekonomike tek shkollat.

*Sektori I pyjeve, parqeve, dhe sipërfaqeve të gjelbërta* është një sektor më vete që do të merret me çështjet e mjedisit të gjelbërt si ëpr pyjet e larta dhe ato komunale, me administrimin e zonave të mbrojtura, parqet rekreative dhe sipërfaqet e gjelbërta. Ky sektorë do të bazohet në funksionet e deritanishme të komunave për pyjet dhe bahskisë për sipërfaqet e gjelbërta. Ai do të jetë koherent me ndryshimet që kanë ndodhur për administrimin e zonave të mbrojtura dhe parqeve. Sektorë do të ketë stafin menaxherial, stafin administrativ dhe stafin teknik, ku përfshihen specialistët e fushës dhe brigada e gjelbrimit që katualisht është nën/bashkinë e Peshkopisë (14 persona), dhe do të duhen rreth 20 persona për këtë sektorë.

## **9.6 Rekomandime rreth burimeve njerëzore/specialiteteve të punonjësve që nevojiten për përmbushjen e këtyre funksioneve**

*Organizimi I qeverisjes lokale me departamente, sektorë dhe zyra:* Organizimi I NJQV së ardhshme duhet të jetë në nivel deparatamentesh dhe sektorësh. Kjo kërkon profile dhe funksione të detajuara të cdo departamenti që lidhen me çështjen, dhe sektorëve që lidhen me funksionin specifik. Mbi bazë të funksioneve të këtyre strukturave duhet të përcaktohen para-praktisht detyrat e personelit për cdo funksion. Drejtuesit do të jenë në profile menaxheri për departamentet, drejtoresh për sektorët dhe përgjegjës për nen-sektoret apo zyrat.

*Burimet njerëzore të nivele të ndryshme sipas pozicionit të punës:* Burimet njerëzore që nevojiten për këtë funksion, sugjerohet që të kemi një ndarje të qartë të pjesës menaxheriale, pjesës administrative, pjesës teknike (nivel I lartë, I mesëm, dhe I ulët), pjesa konsultative. Për organizimin e ri sugjerohet të shfrytëzohet eksperiencat e deritanishme, të vihet në dukje ndryshimi që ndodh, të integrohet ky ndryshim dhe të punohet me ekspertë të jashtëm për zhvillimin organizativ dhe institucional të strukturës së re administrative, duke u bazuar në normat, standartet, praktikat ekzistuese dhe kuadrin ligjor, që të hartohen manuallet dhe formatet praktikë të funksionimit të punës. Një element shumë i rëndësishëm është pjesa e konsultimit të kryetarit, i cili duhet të delgojë kompetenca menaxheriale tek menaxheret dhe të ketë një sistem monitorimi dhe kontrolli të qartë, që duhet të ngrihet dhe të ketë një grup këshilltarësh funksional të brendshëm dhe të jashtëm.

*Numri I punonjësve për NJQV e ardhshme do të jetë 464 punonjës:* NJQV e ardhshme do të ketë 6 menaxherë departamentesh, dhe një menaxher bashkie që luan rolin e administratorit dhe ka disa sektorë në varësi të tij, që janë në pozicione drejtorësh dhe përgjigjen që nga Burimet Njerëzore, IT, Njësia e Projekteve, Arkiva, Auditi I brendshëm, Kordinimit me komunat, Siguria/policia vendore, dhe shërbimet mbështetëse/logjistika. Menaxheret e departamenteve do të kenë nën varësi drejtorët e sektorëve, që aktualisht janë seksione/zyra sipas profilit të punës. Gjithashtu, çdo sektor ka nën varësi stafin teknik me përshkrime detyrash dhe aftësi sipas profileve përkatëse (stafi teknik për logjistike, mirëmbajtje, operim, siguri, shërbimin e pastrimit, gjelberimin, bazën ekonomike në shkollë, mirëmbajtjen e rrugëve, ujësjellësit, shërbimet komunale, cerdhet dhe kopshtet, konviktet, dhe deri tek stafte profesionale që merren me kulturën, artin, sportin etj)

Sipas strukturës të paraqitur në figurë, parashikohet të jetë një staf prej 38 personash staf I larte menaxherial në nivel menaxherësh, drejtoresh dhe administratore, rreth 160 persona në nivel teknik të lartë, 66 persona në nivel të mesëm zyrtarë, dhe 200 persona të tjerë do të jenë në sektorët mbështetës teknik, profesional dhe logjistike. Pra NJQV e ardhshme mendohet të ketë një staf prej 464 punonjësish.



